


DITURIA ISLAME



REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 429 • GUSHT 2026

DASHURIA NDAJ PROFETIT (A.S.):
EMOCION APO PASIM?

RUAJTJA E TRASHËGIMISË PROFETIKE
NË EPOKËN HIPERMODERNE

GJUHA E URREJTJES DHE
KULTURA E DURIMIT

NGA DASHURIA TE PASIMI



“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, për atë që shpreson në Allahun dhe në Ditën e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun.”

EL-AHZAB, 21

HYRJE

Ky numër i revistës Dituria Islame vjen në muajin Rebiul Evel me një dosje të veçantë kushtuar lidhjes së besimtarit me Muhamedin a.s. Nëpërmjet shkrimeve të përzgjedhura trajtohen dashuria ndaj tij, përgjegjësia për jetësimin e Sunetit dhe rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë profetike përballë sfidave të kohës sonë. Sepse dashuria e vërtetë ndaj Pejgamberit a.s. nuk mbetet vetëm ndjenjë dhe përkujtim, por shndërrohet në njohje, bindje, pasim dhe moral të jetuar.



dituriaislame.com



EDITORIAL

- 4 Fuqia e shëmbëlltyrës përballë (pa)fuqisë së fjalës

FETARE

- 5 Dashuria ndaj Pejgamberit a.s.,
emocion apo pasim
Rushit Musallari
- 10 Nga gëzimi për lindjen e Muhamedit a.s.
te përgjegjësia për ta jetësuar Sunetin e tij
Isa Tërshani
- 13 Ruajtja e trashëgimisë profetike
në epokën hipermoderne (1)
Evzal Sinani
- 16 Rebiul-Eveli – muaji i reflektimit, i dashurisë
dhe i ripërtëritjes së përkushtimit në pasimin
e Muhamedit a.s.
Miftar Ajdini
- 20 A kanë përgjegjësi besimtarët
në përhapjen e ateizmit?
Mr. Adnan Shala
- 24 Shtyllat kryesore të një martese
të suksesshme sipas Islamit
Nehat Shehu
- 29 Tabiinët – bashkëndërtuesit e hallkës
së dytë të medhhebit hanefi
Dr. Muhamed Stublla
- 33 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (10)
Hazir D. Selmani
- 37 Embrioni dhe të drejtat e tij në legjislacionin islam
Labinot Ademi

EDUKIM DHE FAMILJE

- 40 Roli i nënës dhe i bashkëshortes
nën shënjestrën e relativizmit modern
Nada Dosti
- 44 Komunikimi toksik dhe gjuha
e urrejtjes në rrjetet sociale
Enis Reçica
- 47 Gjuha e urrejtjes dhe kultura e durimit
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi
- 51 (Zh)bërja e autoriteteve
Imer Topanica

KULTURË


- 55 Ruajtja e identitetit fetar në epokën
e globalizimit dhe transformimeve kulturore
Aid Nasufaj
- 59 Arti i përkthimit
Ejup Ramadani

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 62 Mësimdhënia e hadithit në periudhën e fundit
të medreseve në Perandorinë Osmane
Blerton Bahtiri
- 66 Shtypi islam shqiptar në gjysmën
e dytë të shekullit XX
MA. Fatlun Nika

AKTIVITETE

- 70 Myftiu Tërnavë u nderua me mirënjohje
nga Asambleja e Shtetit të Nju Jorkut



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 429 • viti 40 • GUSHT 2026
• Safer / Rebiul Evvel 1448
• Çmimi 2 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



Fuqia e shëmbëlltyrës përballë (pa)fuqisë së fjalës

*“Ju e kishit
shembullin më të
lartë në të
Dërguarin e
Allahut,
(kuptohet) ai që
shpreson në
shpërblimin e
Allahut në botën
tjetër, ai që atë
shpresë e shoqëron
duke e përmendur
shumë shpesh
Allahun.”*

(El Ahzab, 21)

Një ndër dukuritë më paradoksale të kohës sonë është etja e pashpjegueshme e shumë njerëzve për të folur në emër të Islamit, madje edhe për t’u paraqitur si predikues të kësaj feje hyjnore, pa u vlerësuar nga ndonjë autoritet kredibil nëse të njëjtit posedojnë dijen, pjekurinë, urtësinë dhe afinitetin për të bartur një amanet kaq të rëndë mbi supet e tyre. Një prirje e tillë nuk përbën vetëm një devijim nga etika e dijes islame, por zbulon edhe një keqkuptim të thellë të vetë misionit të fesë. Sepse misioni islam nuk fillon me fjalën, por me shembullin; nuk ndërtohet mbi pretendimin për të përfaqësuar Islamin, por mbi përkushtimin për ta jetësuar atë e për ta ofruar modelin e mirëfilltë para të tjerëve.

Në fakt, gjëja më e çmuar që prezantoi vetë i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. ishte shëmbëlltyra që ai ofroi, vepra madhore që la, madje jo vetëm për epokën në të cilën jetoi, por për të gjitha kohërat dhe gjithë njerëzit gjer në amshim. Këtë fenomen të papërsëritshëm të shembullit nga Muhamedi a.s. në formë të përkryer e konstatoi Zoti në Kuran, kur Ai tha: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, (kuptohet) ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.” (El Ahzab, 21). Ai dëshmoi se si njeriu duhet ta jetojë jetën me fisnikëri e nder, ashtu siç e demonstroi në formë të mahnitshme durimin në sprova, thjeshtësinë në jetë, sakrificën e vetëflijimin në beteja, drejtësinë në gjykime, mëshirën në familje, qëndrueshmërinë e konsekuencën në parimet hyjnore dhe modelin më kapital që e dha në lidhjen e tij me Allahun, në çdo gjendje e rrethanë. Prandaj, njerëzit e pranuan Islamin, ndonjëherë, edhe pa dëgjuar asnjë fjalë prej tij. Lexojeni me kujdes rrëfimin e Abdullah ibën Selamit, Zoti pastë qenë i kënaqur me të, i cili, kur rrëfen takimin e parë me të Dërguarin e Allahut, tha: “Kur i Dërguari i Allahut a.s. mbërriti në Medinë, njerëzit u dyndën drejt tij dhe thoshin: “Ka ardhur i Dërguari i Allahut! Ka ardhur i Dërguari i Allahut!” Edhe unë dola me turmën për ta parë. Kur e vështrova mirë fytyrën e tij, e kuptova se ajo nuk ishte fytyrë e një gënjeshtari.” (Sunen et Tirmidhi, 2485). Pra, në shikim të parë njihej, dallohej dhe demonstronte njeriun me tipare të mahnitshme, që s’lejonte as armikun të mbetej indiferent karshi tij. Ai pushtonte zemrat e të tjerëve me modestinë e karakterin e tij, para se ta bënte këtë me fjalët e mesazhet e tij. Natyrisht, Abdullah ibën Selami r.a. e pranoi Islamin, siç bënë mijëra të tjerë para e pas tij, veçse, më tepër se pranimi i tij i Islamit, do të duhej të na bënte përshtypje arsyeja që e joshi atë drejt kësaj feje. Mirëpo, të mos harrojmë edhe një gjë: i Dërguari ynë a.s., pos që arriti ta dëshmonte shëmbëlltyrën me tiparet e virtytet e tij si Pejgamber i Zotit e përmbyllës i misionit profetik në tokë, përtej kësaj ai formoi gjithashtu një brez shoqëror që mbeti model tejhistorik, i papërsëritshëm, andaj prej tyre u përhap Islami dhe e mori dhenë.

Sot, ndoshta edhe mund të gjesh një besimtar mysliman që vërtet virtytshmëria e tij mbetet joshëse për shumë njerëz që të afrohen tek Islami, por ai po mbetet një individ ose, në rastin më të mirë, mund të jenë edhe disa të tillë, që janë të shpërndarë gjithandej nëpër vise myslimane e jomyslimane. Pra, ndryshe nga brezi i parë, ne këtë e kemi bërë kulmin e aspiratës sonë, individin shëmbëlltyrë, por nuk po arrijmë të formojmë një shoqëri të tërë, që si komunitet të shndërrohet në shëmbëlltyrë që tërheq në mënyrë magnetike të tjerët te gjiri i Islamit. Ndërkaq, vetëm me të parën, ne do të mbetemi në qarkun e ndikimit nga të tjerët e kurrë nuk do të krijojmë një qark të ri të ndikimit të të tjerët. Ndoshta më së miri e tha ideologu perëndimor Albert S., kur u shpreh se: “Shembulli nuk është mënyra kryesore për të ndikuar te të tjerët; është e vetmja mënyrë.”

Pra, duket e kotë ngarendja jonë kah perfeksionimi i oratorisë e elokuencës në predikimin e Islamit, me gjithë peshën e madhe që ka edhe kjo e të cilën mbase edhe po e arrijmë, për sa kohë që ne kemi huq hapin për të formuar brezin shëmbëlltyrë, i cili do të mbetej i denjë që të ndiqej nga të tjerët në çdo hap të jetës. Pa e kuptuar mirëfilli se thellësia e hendekut tonë mes veprës e fjalëve tona e përcakton edhe nivelin e ndikimit tonë tek ata, s’mund të hapërojmë në rrugën e mëkëmbësisë në tokë. Kështu që, ajo që ne jemi sot dhe që ne e bëjmë flet aq fuqishëm, saqë të tjerët do ta humbasin durimin ta dëgjojnë më pas atë që ne themi.

Mr. Driton Arifi

Dashuria ndaj Pejgamberit a.s., emocion apo pasim

Rushit Musallari

Me fillimin e shpalljes profetike, gjuhët dhe penat e myslimanëve kanë shprehur dashurinë e tyre të pastër për Pejgamberin a.s. në vargje dhe në prozë, me një stil të lartë dhe një finesë të hollë, që, me kalimin e kohës, janë bërë himne, pjesë të pandashme të fetarizmit të myslimanëve, të kulturës dhe të traditës së tyre anembanë botës islame. Dashuria për Pejgamberin a.s. është imperativ i besimit në profetësinë dhe mesazhin e tij, pa marrë parasysh nëse është emocion që buron nga studimi i biografisë, karakteristikave dhe virtyteve të Pejgamberit a.s., apo është dashuri racionale, ku i jepet përparësi urdhrit dhe ndalimit të tij, duke mishëruar kështu pasimin dhe ndjekjen e tij. Dashuria e myslimanit ndaj të Dërguarit të Allahut a.s.

duhet të jetë e ekuilibruar mes pasimit dhe emocionit, pasi zhveshja e pasimit nga emocionit e kthen atë në një ritual të ftohtë, ndërsa zhveshja e emocionit nga pasimi e kthen atë në një pretendim.

Dashuria për Muhamedin a.s. arrihet duke e njohur atë, duke e pranuar si pejgamber dhe duke e pasuar në ligjësim, sepse ai a.s. është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij, është besniku i shpalljes së Tij dhe është krijesa më e mirë e Allahut xh.sh. Pejgamberi a.s. është ura lidhëse mes Allahut xh.sh. dhe robërve të Tij; ai u dërgua me fenë e vërtetë dhe rrugën e drejtë. Allahu xh.sh. e dërgoi Muhamedin a.s. si mëshirë për të gjitha krijesat, e bëri imam të të përkushtuarve dhe argument për të gjitha krijesat.

Dashuria për Pejgamberin a.s., duhet të jetë e ekuilibruar mes pasimit dhe emocionit.



Dashuria ndaj Muhamedit a.s., përveçse është dashuri emocionale, mbi të gjitha është dashuri racionale, pasi Allahu xh.sh., nëpërmjet tij, i orientoi njerëzit drejt së vërtetës dhe drejt rrugës më të qartë. Nëpërmjet Muhamedit a.s., Allahu xh.sh. ua çeli sytë të verbërve, ua zbuti zemrat e ngurta dhe ua hapi veshët e shurdhërve. Allahu xh.sh. e ka bërë detyrë bindjen, mbrojtjen, ndihmën dhe respektin ndaj Muhamedit a.s. Allahu xh.sh. ka lënë të hapur vetëm një rrugë që të çon në Xhenet dhe ajo është rruga e Muhamedit a.s. Dyert e Xhenetit do të hapen vetëm për atë që ndjek rrugën e Muhamedit a.s. Allahu xh.sh. ia hapi zemrën Muhamedit a.s. me Islamin, e lartësoi emrin e Muhamedit a.s., duke ia bashkëngjitur emrit të Tij: *“Lâ ilâhe il-lall-llâh, Muhammedun Resûlull-llâh”*, dhe ia largoi mundimet dhe peshën që kishte mbi supe.

Kushdo që pason Muhamedin a.s. është i udhëzuar dhe ka shpëtuar. Allahu xh.sh. e ka kushtëzuar lumturinë e të dy botëve me pasimin e rrugës së Muhamedit a.s., ndërsa e ka bërë fatkeq në të dy botët çdo person që e kundërshton rrugën e tij a.s. Ata që ndjekin rrugën e Muhamedit a.s. janë të sigurt, të shpëtuar, krenarë, nuk kanë nevojë për asgjë, janë të mbrojtur, janë të përkrahur dhe kalojnë jetë të mirë si në dynja, ashtu edhe në Ahiret.

Në mënyrë që dashuria për Pejgamberin a.s. të jetë e ekuilibrar mes dashurisë racionale, e cila obligon pasimin, dhe dashurisë emocionale, e cila obligon drithërimin e shpirtit dhe të zemrës, duhen pasur parasysh disa aspekte që përcaktojnë edhe nivelin dhe raportin e drejtë të kësaj dashurie.

BESIMI I VËRTETË NË MUHAMEDIN A.S. DHE VËRTETIMI I ÇDO GJËJE QË AI KA KUMTUAR DHE KA THËNË

Besimi në të Dërguarin e Allahut a.s. do të thotë: vërtetimi i profetësisë së tij, bindja e sigurt se Allahu xh.sh. e ka dërguar atë a.s. për xhinët dhe njerëzit, si dhe vërtetimi i të gjitha fjalëve që ai a.s. ka thënë. Ky vërtetim duhet të konkretizohet me zemër, me gjuhë dhe me gjymtyrë. Ky është besimi i plotë në Muhamedin a.s. Allahu xh.sh. thotë: *“Prandaj besoni në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në dritën (Kuranin), që ju kemi zbritur. Allahu e di mirë çdo gjë që bëni ju.”* (Et Tegabun, 9). Allahu xh.sh. po ashtu thotë:

Pasimi i
Pejgamberit
a.s., është
treguesi më i
fortë i
dashurisë së
vërtetë ndaj tij.

“Ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij (Muhamedin), se Ai do t’ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Tij, do t’ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t’ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (El Hadid, 28).

BINDJA NDAJ PEJGAMBERIT A.S. DHE KUJDESI PËR TË MOS E KUNDËRSHTUAR ATË

Ashtu siç është detyrë besimi në Muhamedin a.s. dhe vërtetimi i profetësisë së tij, po ashtu është detyrë edhe bindja ndaj tij a.s. Bindja ndaj Pejgamberit a.s. buron nga bindja ndaj Allahut. Allahu xh.sh. thotë: *“O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos ia ktheni shpinën, ndërkohë që e dëgjoni (të vërtetën).”* (El Enfal, 20). Allahu xh.sh. thotë: *“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”* (El Hashër, 7).

Veprimi në kundërshtim me rrugën e Pejgamberit a.s. është devijim dhe largim nga rruga e drejtë. Allahu xh.sh. thotë: *“Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”* (El Ahzab, 36).

Ebu Hurejra r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Kush më bindet mua, i është bindur Allahut dhe kush më kundërshton mua, e ka kundërshtuar Allahun.”* (Buhariu, 7137; Muslimi, 1835).

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Të gjithë njerëzit do të hyjnë në Xhenet, përveç atij që refuzon.”* Të pranishmit i thanë: *“O i Dërguari i Allahut! Cili është ai që refuzon?”* I Dërguari i Allahut a.s. tha: *“Kush më bindet mua, do të hyjë në Xhenet dhe kush më kundërshton, ka refuzuar.”* (Buhariu, 7280).

PASIMI DHE NDJEKJA E TIJ A.S. SI MODEL NË TË GJITHA ÇËSHTJET

Pasimi dhe ndjekja e tij janë treguesit më të fortë të dashurisë së vërtetë dhe konkrete ndaj Pejgamberit a.s. Kurani e ka kushtëzuar dashurinë ndaj Allahut xh.sh. me ndjekjen e Pejgamberit a.s. Allahu xh.sh. thotë: *“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’”* (Ali Imran, 31). Allahu xh.sh. thotë: *“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu*

dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (El Ahzab, 21).

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kush nuk e pranon rrugën time, nuk është prej meje.” (Buhariu, 5063; Muslimi, 1401).


DASHURIA RACIONALE DHE EMOCIONALE PËR MUHAMEDIN A.S. DUHET TË JETË DASHURIA MË SUBLIME PËR MYSLIMANIN

Muslimani e përmbush besimin e tij atëherë kur dashuria ndaj Pejgamberit a.s. është më sublimja në zemrën dhe në mendjen e tij. Allahu xh.sh. thotë: *“Thuaj: Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”* (Et Tevbe, 24).

Enesi r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Asnjëri prej jush nuk e ka të plotë besimin, derisa të jem më i dashur për të sesa fëmijët, prindërit dhe të gjithë njerëzit.” (Buhariu, 15; Muslimi, 24).

Umeri r.a. i tha të Dërguarit të Allahut a.s.: “O i Dërguari i Allahut! Unë të dua më shumë se çdo gjë, përveç vetes sime.” I Dërguari i Allahut a.s. i tha: “Jo, për Atë që mban shpirtin tim në Dorën e Tij! Nuk e ke të plotë besimin, derisa të më duash më shumë se veten tënde.” Umeri r.a., pasi reflektoi, i tha: “Për Zotin, tani ti je më i dashur për mua se vetja ime.” I Dërguari i Allahut a.s. tha: “Tani po (të është plotësuar besimi).” (Buhariu, 6632).

Pasimi i Pejgamberit a.s., i shoqëruar me dashuri emocionale, është shkak për të fituar shoqërinë e të Dërguarit të Allahut a.s. në Xhenet dhe kjo vlen si për ata që patën fatin ta shihnin dhe ta besonin, ashtu edhe për të gjithë ata që e kanë besuar dhe do ta besojnë deri në Ditën e Kiametit. Një person e pyeti të Dërguarin e Allahut a.s. se kur do të bëhet Kiameti. I Dërguari i Allahut a.s. i tha: “Çfarë ke përgatitur për atë ditë?” Ai iu përgjigj: “O i Dërguari i Allahut! Nuk kam përgatitur ndonjë agjërim, namaz apo zekat të shumtë (vullnetar), por unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij.” I Dërguari i Allahut a.s. i tha: “Njeriu do të jetë me atë që do.” (Buhariu, 6168; Muslimi, 2640). Enesi r.a. thotë: “Pas mirësisë së pranimit të Islamit, gjëja që na ka gëzuar më shumë ka qenë kjo fjalë e të Dërguarit të Allahut a.s.: ‘Njeriu do të jetë me atë që do.’ Unë e dua Allahun, e dua të Dërguarin e Tij, e dua Ebu Bekrin dhe Umerin.” (Buhariu, 3688; Muslimi, 2639). Po ashtu, edhe ne e duam Allahun, e duam të Dërguarin e Tij, e duam Ebu Bekrin, e duam Umerin, i duam të gjithë sahabët, tabiinët, dijetarët dhe të gjithë myslimanët. Me një



dashuri të tillë e adhurojmë Allahun dhe shpresojmë të fitojmë kënaqësinë e Tij.

Ibën Mesudi r.a. tregon se një person e pyeti të Dërguarin e Allahut a.s.: “O i Dërguari i Allahut! Çfarë mund të thuash për një person, i cili i do disa të tjerë, por nuk jeton në kohën e tyre?” I Dërguari i Allahut a.s. tha: “Njeriu do të jetë me atë që do.” (Buhariu, 3688; Muslimi, 2639).

Dashuria emocionale i jep shpirt pasimit dhe e gjallëron zemrën me shijimin e besimit. Abas ibën Abdulmutalibi r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “E ka provuar shijen e besimit ai person, i cili është i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin si të Dërguar.” (Muslimi, 34).

Enes ibën Maliku r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kush i ka tri gjëra, e ka shijuar vërtet besimin: Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të dashur për të se çdo gjë tjetër.” (Buhariu).

Kur myslimani e shijon besimin, ai shkrihet në dashurinë ndaj modelit dhe shembullit që ia mundësoi shijimin e këtij besimi, Muhamedit a.s. Kjo dashuri e motivon myslimanin që ta jetësojë shembullin e Pejgamberit a.s. dhe t'i përmbahet edhe më shumë rrugës së tij. Për një dashuri të tillë, myslimani sakrifikon çdo gjë. Ebu Hurejra r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Ata që më duan më shumë nga pjesëtarët e ymetit tim janë disa njerëz, të cilët do të vijnë pas meje. Këta do të sakrifikonin familjen dhe pasurinë e tyre vetëm që të më shihnin." (Muslimi, 2832; Ahmedi, v. 5, f. 170).

RESPEKTIMI, PËRNDERIMI DHE MBROJTJA E PEJGAMBERIT A.S.

Respektimi dhe përnderimi i Pejgamberit a.s. është detyrë madhore imanore; madje, grada e përnderimit dhe e madhështimit të Pejgamberit a.s. është më e lartë se grada e dashurisë, pasi jo çdo person që dashuron e madhëron atë që do. Imam Halimi ka thënë: "Dihet se të drejtat e të Dërguarit të Allahut a.s. janë më të larta, më të mëdha, më të nderuara, më të domosdoshme dhe më të detyrueshme për ne sesa të drejtat e zotërinjve ndaj skllëvërve të tyre dhe të prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Allahu xh.sh. na shpëtoi nëpërmjet Pejgamberit a.s.


Dashuria e vërtetë për Muhamedin a.s., nuk është vetëm ndjenjë, por besim, bindje dhe ndjekje e rrugës së tij.

nga Xhehenemi në Ahiret, ashtu siç na ruajti, po nëpërmjet Pejgamberit a.s., jetët, trupat, nderin, pasurinë, familjet dhe fëmijët tanë në këtë botë. Allahu na udhëzoi nëpërmjet tij drejt asaj që, nëse i bindemi Pejgamberit a.s., na çon në xhenetet e begata. Atëherë, cila mirësi mund t'u afrohet këtyre mirësive dhe cilat dhunti mund t'u gjenden pranë këtyre dhuntive, shkak i të cilave është Pejgamberi a.s.?

Allahu xh.sh. na e ka bërë detyrë bindjen ndaj tij, na ka kërcënuar me ndëshkim në Xhehenem për mosbindje ndaj tij dhe na ka premtuar Xhenetin për ndjekjen e tij. Atëherë, cili rang mund të jetë i ngjashëm me rangun e Pejgamberit a.s. dhe cila shkallë mund të barazohet në lartësi me këtë shkallë? Është obligim për ne që ta duam, ta nderojmë, ta madhësojmë dhe ta respektojmë atë më shumë sesa skllavi zotërinë e tij dhe sesa fëmija prindin e tij. Në lidhje me këtë temë, Kurani është i mbushur me ajete dhe urdhëresa të Allahut xh.sh."¹

Allahu xh.sh. thotë: "Ta besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhamedin)." (El Fet'h, 9).

Mbrojtja e Pejgamberit a.s. nuk bëhet me emocion, por me arsye të shëndoshë, gjë që arrihet duke studiuar me hollësi Kuranin, Sunetin dhe biografinë e tij të ndershme.



Nderimi, respekti dhe madhështimi i Pejgamberit a.s. nga sahabët, tabiinët, dijetarët dhe myslimanët, në përgjithësi, është i papërshtatshëm. Abdullah ibën Amër ibën Asi r.a. ka thënë: “Askush nuk ishte më i dashur dhe më i nderuar në sytë e mi sesa i Dërguari i Allahut a.s. Unë nuk mund ta ngopja shikimin tim për shkak të madhështimit që ndieja për të. Nëse do të më kërkohej ta përshkruaja atë, nuk do të mundja, sepse unë nuk i kisha ngopur sytë me fytyrën e tij.” (Muslimi, 121).

PËRSHËNDETJA ME SALAVATE DHE SELAME PËR PEJGAMBERIN A.S.

Një nga manifestimet më praktike dhe emocionale të dashurisë ndaj Pejgamberit a.s. është nderimi që myslimani i bën vetes së vet duke dërguar salavate dhe selame për Pejgamberin a.s. Kështu, ai zbaton një ligj hyjnor të përgjithshëm, duke pasur privilegjin të jetë nga ata që luten për Pejgamberin a.s. dhe dërgojnë salavate e selame për të, duke fituar të mirat e dynjasë dhe të Ahiretit. Allahu xh.sh. thotë: “*Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melaqet e Tij luten për të. O ju që keni besuar, lutuni për të dhe përshëndeteni me selam.*” (El Ahzab, 56).

Ebu Hurejra r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kush dërgon një salavat për mua, Allahu e mëshiron dhjetë herë.” (Muslimi, 408).

Enes ibën Maliku r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Nëse përmendem në prani të dikujt, ai le të dërgojë salavate për mua, sepse kush dërgon një herë salavate për mua, Allahu e mëshiron dhjetë herë.” (Nesaiu, *Es Sunenu'l Kubra*, 9806).

Ebu Burdeh ibën Nijari r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kushdo prej ymetit tim, i cili dërgon salavate për mua me sinqeritet nga zemra, Allahu e mëshiron dhjetë herë, e lartëson dhjetë gradë, i shkruan dhjetë sevape dhe i fshin dhjetë të liga.” (Nesaiu, *Es Sunenu'l Kubra*, 9809).

Ibën Mesudi r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Allahu ka engjëj shëtitës, të cilët m'i përcjellin selamet e ymetit tim.” (Nesaiu, *Es Sunenu'l Muxhtebâ*, 1281).

Hasen ibën Aliu r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Dërgoni salavate për mua, kudo që të jeni, sepse salavati juaj më arrin.” (Taberaniu, *El Muxhemu'l Kebîr*, 2729).

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Njeriu më i afërt me mua në Ditën e Kiametit është ai, i cili më ka dërguar më shumë salavate.” (Tirmidhiu, 484).

Salavatet dhe selamet për të Dërguarin e Allahut a.s. bëhen në shumë raste, si: gjatë hyrjes dhe daljes nga

xhamia, pas mbarimit të ezanit, kur bëhet ikameti, kur bëhet dua (lutje), pas teshehudit të fundit, në namazin e xhenazes, në mëngjes dhe në mbrëmje, në ditën e xhuma, kur një grup shpërndahet, në hytbe, kur shkruhet dhe përmendet emri i tij a.s., në fund të duasë së vitrit, mes tekbirove të ditëve të Bajramit, në Safa dhe Merve gjatë haxhit, kur qëndrohet te varri i tij a.s., në raste stresi dhe sprovash, kur kërkohet falja e Allahut xh.sh., pas pendimit nga mëkatet etj.

MATURIA NË DASHURINË NDAJ PEJGAMBERIT A.S.

Nga myslimani kërkohet ta dojë Pejgamberin a.s. me maturi, pa kaluar në ekstremizëm dhe pa e neglizhuar pozitën e tij: Muhamedi a.s. është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Ai është më i miri i të dërguarve dhe i lajmëtarëve të Allahut. Ai është zotëria i të gjithë njerëzve, merituesi i vendit të lavdëruar dhe ndërmjetësuesi në Ditën e Kiametit. Megjithatë Pejgamberi a.s. është njeriu i përzgjedhur dhe njeriu i përsosur, ai nuk ka mundësi që t'i sjellë dëm apo dobi materiale as vetes, as të tjerëve, në ato gjëra që janë e drejtë ekskluzive e Allahut xh.sh., i Cili thotë: “*Thuaj: Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet.*” (El Enam, 50).

Gjithashtu, Pejgamberi a.s. nuk duhet trajtuar si të ishte një njeri i rëndomtë apo të trajtohet pa etikë e me vrazhdësi, pa ndjeshmëri dhe pa dashuri. Pejgamberi a.s. është zotëria i mbarë krijesave në këtë botë dhe në Ahiret. Virtytet, vlerat, tiparet specifike dhe karakteristikat e Pejgamberit a.s. janë më se të njohura dhe mjafton t'u referohesh librave të Sunetit dhe librave që janë specifike për këtë çështje, mevludeve, kasideve etj., për të kuptuar pozitën dhe madhështinë e Pejgamberit tonë të dashur a.s.

Poeti popullor ka thënë:

Njeri asht Muhamedi,

po s'asht si tjetërkush

Si rubini ndër gurë,

shndrit e s'e mrrin kush.

I lutemi Allahut që fjala jonë e fundit të jetë fjala e dashurisë së madhe dhe e pasimit të sinqertë: “Esh-hedu en lâ ilâhe il-lall-llâh ue esh-hedu enne Muhammeden resûlull-llâh – Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Tij”.

1 Husejn ibën Hasen Halimi, El Mihâxhu fî Shuabi'l Îmân, (Damask, Darul Fikr, 1979), v. 2, f. 124-126.

عدد مذاكرة الذاكرون
وغفل عن ذكره الغافلون

Nga gëzimi për lindjen e Muhamedit a.s. te përgjegjësia për ta jetësuar Sunetin e tij

Isa Tërshani

Përkujtimi i lindjes së Muhamedit a.s. nuk duhet të mbetet thjesht një manifestim simbolik apo emocional, por duhet të shndërrohet në një përgjegjësi të vazhdueshme për ta jetësuar modelin e tij profetik në çdo dimension të jetës sonë.

Në historinë e njerëzimit ka ngjarje që kanë ndryshuar rrjedhën e qytetërimeve. Megjithatë, asnjë ngjarje nuk ka pasur ndikim më të thellë dhe më të qëndrueshëm sesa lindja e Muhamedit a.s. Ajo nuk ishte thjesht lindja e një njeriu të jashtëzakonshëm, por ardhja në botë e të Dërguarit të fundit të Allahut xh.sh., përmes të cilit u plotësua zinxhiri i shpalljeve hyjnore dhe u përmbyll misioni profetik. Kurani e përshkruan qartë rëndësinë e këtij misioni me fjalët: “E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (El Enbija, 107).

Ky ajet na tregon qartë se peygamberia e Muhamedit a.s. nuk ka kufizim në kohë dhe hapësirë të caktuar, por do të zgjasë deri në Kiamet (Ditën e Gjykimit), ndërsa misioni i peygamberëve të tjerë ka qenë i kufizuar në një periudhë të caktuar kohore. Kurani dhe ligji i tij janë të përjetshëm, ngase nuk ka

peygamber pas Muhamedit a.s. e as libër të shenjtë pas Kuranit famëlartë. Muhamedi a.s. është i fundit nga radha e peygamberëve, dhe po ashtu Kurani është libri i fundit i shpallur prej Allahut xh.sh.¹ Prandaj, lindja e tij përfaqëson dhuratën më të madhe hyjnore që i është bërë njerëzimit.

Nëse e lexojmë historinë, bota në të cilën lindi Peygamberi a.s. ishte e zhytur në errësirën e paditurisë, padrejtësisë dhe degradimit moral. Idhujtaria kishte zëvendësuar besimin e pastër, padrejtësia ishte bërë normë, ndërsa dinjiteti i njeriut shpesh mohohej. Në një realitet të tillë, lindja e Muhamedit a.s. ishte agimi i një epoke të re, ku drita e shpalljes do ta udhëhiqte njerëzimin drejt njohjes së Krijuesit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

Andaj, përkujtimi i lindjes së Muhamedit a.s. ka qenë ndër shekuj një rast i veçantë për besimtarët myslimanë që të shprehin gëzimin,



dashurinë dhe respektin ndaj njeriut që Allahu xh.sh. e dërgoi si mëshirë për botët. Ky gëzim nuk buron thjesht nga një ngjarje historike, por nga vetëdija se, me ardhjen e tij, njerëzimi mori dritën e besimit dhe modelin më të përsosur të jetës njerëzore. Megjithatë, gëzimi dhe dashuria e sinqertë për Pejgamberin a.s. nuk mund të mbeten vetëm në emocionet e një dite, në tubime përkujtimore apo në fjalë lavdërimi. Ajo duhet të shndërron në një përgjegjësi të vazhdueshme për ta njohur, kuptuar dhe jetësuar Sunetin e tij në çdo dimension të jetës. Në të kundërtën, rrezikojmë që përkujtimi të mbetet vetëm një traditë kulturore, pa ndikim të vërtetë në karakterin dhe sjelljen tonë.

Të nderuar lexues, jetojmë në një kohë kur njerëzimi përballet me krizë vlerash, individualizëm dhe polarizim; modeli profetik mbetet një burim i pashtershëm frymëzimi për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më njerëzore. Mësimet dhe porositë e Pejgamberit a.s. e zhvendosin fokusin nga ceremonia te transformimi i brendshëm. Prandaj, përkujtimi i lindjes së Muhamedit a.s. duhet të jetë një moment vetëreflektimi. Ngase Muhamedi a.s. na mësoi sinqeritetin në fjalë, drejtësinë në vendime, mëshirën ndaj të dobët, ndershmërinë në tregti, respektin ndaj familjes, fqinjit dhe shoqërisë, e shumë të tjera.

DASHURIA NDAJ PEJGAMBERIT A.S. – KËRKESË E BESIMIT

Dashuria ndaj Muhamedit a.s. është një nga shtyllat themelore të besimit islam. Pika më e lartë që duhet të arrihet në fazat e dashurisë njerëzore është dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut a.s. Asnjë njeri nuk mund të mendohet se e meriton më shumë dashurinë njerëzore sesa Ai, sepse Allahu xh.sh. ua ka shfaqur robërve të Tij mirësitë e Kuranit dhe të Islamit përmes zemrës së pastër të Pejgamberit a.s.² Kurani e lidh dashurinë ndaj Allahut të Madhëruar me pasimin e Pejgamberit a.s. Në Kuran Allahu thotë: *“Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Shumëfalës dhe Mëshirues i Madh.”* (Ali Imran, 31).

Ky ajet vendos një parim themelor: dashuria ndaj Allahut xh.sh. nuk është një pretendim abstrakt, por manifestohet përmes pasimit të Pejgamberit a.s. Kështu, dashuria ndaj Allahut xh.sh. merr formë praktike nëpërmjet ndjekjes së shembullit profetik; ajo zbret nga sfera e ndjenjës në realitetin

Dashuria e vërtetë ndaj Allahut nuk është një pretendim abstrakt, por një udhëtim praktik që merr jetë vetëm përmes pasimit të shembullit profetik në moral, adhurim dhe sjellje.

e jetës. Lidhja ndërmjet dashurisë për Allahun e Madhëruar dhe pasimit të Pejgamberit a.s. është e pandashme. Allahu xh.sh. është qëllimi, ndërsa Pejgamberi a.s. është modeli praktik. Ta duash Allahun xh.sh. do të thotë ta pranosh udhëzimin e Tij, ndërsa ta pasosh Pejgamberin a.s. do të thotë ta jetësosh këtë dashuri.

Pra, dashuria e vërtetë për Allahun xh.sh. prodhon bindje. Kjo bindje konkretizohet në ndjekjen e shembullit të Pejgamberit a.s.: në moral, në adhurim dhe në sjellje shoqërore. Nëse Allahu xh.sh. është qëllimi suprem, atëherë Pejgamberi a.s. është rruga drejt Tij. Nuk mund të ndahet qëllimi nga rruga.

Po ashtu, Allahu thotë: *“Ju e kishit shembullin më të mirë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.”* (El Ahzab, 21).

Pejgamberi a.s. nuk ishte vetëm bartës i shpalljes, por edhe modeli praktik i saj. Ai është shembulli që e bën të kuptueshëm dhe të zbatueshëm mesazhin hyjnor në jetën e përditshme. Kur u pyet bashkëshortja e tij, Aisheja r.a., për moralin e tij, ajo u përgjigj: *“Moral i tij ishte Kurani.”*³ Kjo dëshmi tregon se ai ishte mishërimi i vlerave hyjnore në jetën e përditshme. Madje, vetë Pejgamberi a.s. e bëri të qartë se dashuria ndaj tij është pjesë e përsosjes së besimit. Ai ka thënë: *“Nuk ka*

*besuar asnjëri prej jush, derisa tek ai të jem më i dashur sesa prindi, fëmija i tij dhe mbarë njerëzimi.”*⁴

Ky hadith nuk kërkon një dashuri të bazuar vetëm në emocion, por një dashuri që ndikon në zgjedhjet, bindjet dhe sjelljen e besimtarit. Në një hadith tjetër, Muhamedi a.s. ka thënë: *“Kush e ringjall Sunetin tim, më ka dashur mua; e kush më do mua, do të jetë me mua në Xhenet.”*⁵ Ky premtim tregon lidhjen e pandashme ndërmjet dashurisë për Pejgamberin a.s. dhe angazhimit për ruajtjen dhe praktikimin e Sunetit të tij.

TË KALOJMË NGA EMOCIONET E RASTIT TE KULTURA E PËRHERSHME E SUNETIT

Në jetën e çdo besimtari ka çaste që zgjojnë emocione të veçanta shpirtërore, si: muaji Ramazan me dhjetë netët e bekuara dhe Natën e Kadrit, dhjetëditëshi i parë i dhulhixhes dhe përkujtimi i lindjes së Muhamedit a.s. Këto janë raste kur zemrat zbuten, xhamitë mbushen me besimtarë dhe fjalët për dashurinë ndaj Allahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij dëgjohen



më shpesh se zakonisht. Këto janë momente me vlerë të madhe, sepse e rigjallërojnë lidhjen e njeriut me fenë dhe e forcojnë ndjenjën e përkatësisë ndaj ymetit.

Megjithatë, sfida e vërtetë nuk është të përjetojmë emocione të forta vetëm në raste të caktuara apo ditë të veçanta, por t'i shndërrojmë ato në një mënyrë të qëndrueshme jetese. Islami nuk synon të ndërtojë besimtarë që preken vetëm nga atmosfera e një ceremonie apo e një ligjërate, por njerëz që e mishërojnë besimin në çdo ditë të jetës së tyre. Pikërisht këtu qëndron dallimi ndërmjet emocioneve të rastit dhe kulturës së përhershme të Sunetit.

Një nga gabimet e zakonshme është kufizimi i dashurisë ndaj Pejgamberit a.s. vetëm në lavdërime, poezi apo përkujtime festive. Edhe pse këto e kanë vlerën e tyre, nuk përbëjnë thelbin e dashurisë së sinqertë ndaj Pejgamberit a.s. Dashuria e vërtetë manifestohet në jetësimin e porosive të tij, si: ndershmëri në fjalë dhe në vepra, drejtësi në marrëdhënie me të tjerët, mëshirë ndaj njerëzve, falje ndaj atyre që gabojnë, respekt për familjen dhe fqinjët, përkushtim në adhurim dhe moral të lartë në jetën publike dhe private. Allahu i Madhëruar thotë: “Ju e kishit shembullin më të mirë në të Dërguarin e Allahut...” (El Ahzab, 21).

Ky ajet nuk e paraqet Pejgamberin a.s. si model vetëm për raste të veçanta, por si shembull të përhershëm për të gjithë ata që synojnë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Suneti është modeli i jetës që Muhamedi a.s. ua la porosi besimtarëve. Andaj, problemet me të cilat përballet shoqëria jonë, si: mungesa e besueshmërisë, gjuha fyese, padrejtësia, dobësimi i lidhjeve familjare dhe mungesa e përgjegjësisë, nuk zgjidhen vetëm me emocione kalimtare. Ato kërkojnë

një edukim të vazhdueshëm me moralin profetik. Muhamedi a.s. ka thënë: “Jam dërguar për ta përsosur moralin e lartë.”⁶ Ky hadith na kujton se misioni i Pejgamberit a.s. nuk kufizohej vetëm në mësimin e riteve të adhurimit, por synonte formimin e njeriut me karakter të lartë. Suneti – tradita e Muhamedit a.s. – është shkolla ku mësohen ndershmëria, drejtësia, durimi, mëshira, përlulesia dhe përgjegjësia. Kur këto vlera bëhen pjesë e kulturës së përditshme, ato ndikojnë jo vetëm tek individ, por edhe te familja, institucionet dhe shoqëria në tërësi.

PËRFUNDIMI

Shoqëria jonë ka nevojë për një transformim të thellë: nga emocionet e rastit te kultura e përhershme e jetësimit të Sunetit. Nuk mjafton vetëm të prekemi nga fjalët për Muhamedin a.s., por duhet ta bëjmë moralin e tij pjesë të identitetit tonë. Nuk mjafton ta duam atë vetëm me zemër, por duhet ta ndjekim me vepra. Kur tradita e tij bëhet kulturë e familjes, e shkollës, e xhamisë dhe e institucioneve, atëherë shfaqen frytet e saj: drejtësia zë vendin e padrejtësisë, mëshira zbut zemrat, ndershmëria forcon besimin ndërmjet njerëzve dhe përgjegjësia bëhet themel i jetës shoqërore.

Sa më shumë t'i afrohemi shembullit të Pejgamberit a.s., aq më shumë i afrohemi kënaqësisë së Allahut. Kjo është domethënia e vërtetë e dashurisë: një dashuri që nuk mbetet vetëm në zemër dhe në fjalë, por shndërrohet në bindje, në moral dhe në vepra të mira.

Abdullah ibën Mesudi r.a. transmeton se erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O Pejgamber i Zotit! Kur do të bëhet Kiameti?” Pejgamberi a.s. ia ktheu: “Pse pyet për të? Çfarë ke përgatitur ti për të?” Personi iu përgjigj: “Vallahi, o i Dërguar i Zotit, nuk kam bërë ndonjë punë të madhe, as namaz (shtesë), as agjërim (shtesë), por diçka e kam me gjithë zemër. Unë e dua Zotin dhe të dua ty.” Pejgamberi a.s. i tha: “Njeriu do të jetë me atë që e do.”⁷

Prandaj, vetëm përmes dashurisë së sinqertë për të dhe ndjekjes së rrugës së tij mund të shpresojmë të jemi ndër ata që do të jenë në shoqërinë e tij.

E lusim Allahun e Madhëruar që t'i ndriçojë zemrat tona me dashurinë ndaj Tij dhe dashurinë ndaj Muhamedit a.s. Amin.

1 Naim ef. Tërnavë, *Besimi islam shtyllat dhe veçoritë I*, Prishtinë, 2020, f. 207.

2 Osman Nuri Topbash, *Qytetërimi i virtyteve*, Shkodër, 2010, f. 223.

3 Muhamed Nasirudin el Albani, *El Xhamiu es Sagjir ve Zijadetu I*, botimi i tretë, Bejrut, 1988, nr. 4811.

4 *Sahihu i Buhariut I*, Harfî, Prishtinë, 2024, Buhariu, 15.

5 *Sunen et Tirmidhi*, Mektebetu el Mearife li Neshri ve et Evzi, botimi i tretë, Riad, 2008, nr. 2678.

6 Muhamed Nasirudin el Albani, *El Xhamiu es Sagjir ve Zijadetu I*, botimi i tretë, Bejrut, 1988, nr. 2349.

7 Buhariu, 6168.

Ruajtja e trashëgimisë profetike në epokën hipermoderne (1)

TË JETOSH ME KUJTIMIN E TIJ A.S.

Evzal Sinani

LINDJA E MUHAMEDIT A.S. MES TË QENIT PIKËNISJE E GJALLËRISË DHE NGJARJES GLORIFIKUESE SIMBOLIKE

Loji i parë dhe kryesor i komentimit të Kuranit, zbulimit të kuptimeve që bartin fjalët e përzgjedhura nga Allahu xh.sh., është komentimi që Kurani i bën vetes, duke sqaruar, specifikuar apo detajuar gjëra që, në vende të caktuara, i lë të përgjithshme për shkak të kontekstit apo ndonjë urtësie tjetër. Prandaj, mëshirën e përmendur në ajetin që urdhëron: “*Thuaj: Me mirësinë e Allahut dhe me mëshirën e Tij, me këto le të gëzohen...*” (Junus, 58), e kuptojmë të jetë vetë prania e Muhamedit a.s., në bazë të ajetit tjetër: “*Ne ty të kemi dërguar vetëm si mëshirë për të gjitha botët.*” (El Enbija, 107).

Për t'i përkujtuar “Ditët e Allahut”¹, për t'u gëzuar me mëshirën e botëve, për t'i çuar salam Muhamedit a.s. në ditën e lindjes së tij – meqë ai ka epërsi mbi të gjithë të dërguarit e tjerë, përfshirë Isain a.s.² dhe Jahjanë a.s.,³ për të cilët do të çohet salam në ditën kur kanë lindur – dhe për ta mbajtur të gjallë praninë e modelit të tij profetik në jetën e besimtarëve, ulematë kanë lejuar, madje edhe kanë preferuar, përkujtimin dhe festimin e ditës së lindjes së vulës së profetëve, Muhamedit a.s.

Për t'i përmbushur të gjitha këto, historikisht, anekënd botës islame nuk është lejuar neglizhimi i 12 rebiul evvelit, duke kaluar, në periudha të ndryshme, edhe në stadin e detyrimit moral, por jo juridik. Ashtu si në shumë praktika të tjera, në mos në të gjitha, si pasojë e rënies dhe zbehjes së praktikës së për-

Festimi i lindjes së Profetit Muhamed a.s. shërben si detyrim moral për të mbajtur gjallë modelin e tij profetik përballë sfidave shpirtërore të modernitetit.



gjithshme fetare te myslimanët, edhe shënimi i një dite që përmban në vete mesazhe kaq të fuqishme dhe motive të forta për gjallërimin e modelit të figurës së vetme që ka arritur përsosmërinë njerëzore, ka kaluar në një manifestim simbolik që nuk gjen dot shtytësin për t'u shndërruar në katalizator të gjallërimit të jetës dhe veprës së tij në zemrën e myslimanit.

Është paradoksale të vëresh se, edhe pse janë shtuar elemente me qëllim përafrimi, janë holluar performimet artistike dhe është profesionalizuar portretizimi, megjithatë ndikimi i dëshiruar nga organizimet është larg së synuarës. Kjo assesi nuk e zbeh rëndësinë e organizimeve qëllimira dhe të strukturuar saktë për këtë qëllim, por është një tregues i fuqishëm se, krahas tyre, duhet të trajtohen shkaqet që kanë sjellë në thatësinë shpirtërore te myslimani që vepron në këtë epokë të modernitetit fluid, të hipermodernitetit, ku çdo gjë ndryshon dhe vjetrohet me shpejtësi rrufeje.

A MUND TË JETË AKTUAL NJË MODEL 14-SHEKULLOR NË EPOKËN E NDRYSHIMEVE TË SHPEJTA?

Për dallim nga mrekullitë e të dërguarve paraprakë, që kanë qenë mrekulli shqisore, muxhizja kryesore e Muhamedit a.s., Kurani, është mrekulli logjike që u mbijeton ndryshimeve dhe dallimeve ndërmjet epokave të ndryshme. Duke qenë se buron nga Krijuesi i njeriut, i cili e njeh natyrën njerëzore në plotësi, dhe duke marrë parasysh natyrën e teksteve dhe metodave të përkryera të përgjithësimit, specifikimit, tematikave të trajtuara dhe përbërjes së ligjërimit, Kurani i tejkalon pengesat lokale dhe kohore për të qenë, padiskutueshëm, i vlefshëm për çdo kohë dhe çdo vend. Për ta ruajtur këtë universalitet, Kurani doemos duhej ta linte specifikimin e shumë detajeve Muhamedit a.s., ndërsa çështjet që preken nga ndryshimet kohore, lokale apo kulturore, dijetarëve, të cilët do t'i nxirrnin ligjet specifike mbi parimet e përgjithshme të vendosura nga vetë Kurani.

Meqë Kurani, pa lënë hapësirë për dyshim dhe në shumë vende, në forma të ndryshme, tregon domosdoshmërinë e ndjekjes së modelit të Muhamedit a.s. në veprim, edhe vetë ndjekja e këtij shembulli do të jetë e paprekur nga pengesat kohore dhe ndryshimet lokale. Në këtë kontekst, Allahu xh.sh. thotë: *"Ju në të Dërguarin e Allahut keni shembullin më të mirë..."* (El Ahzab, 21), madje e kushtëzon rrugën për arritjen e dashurisë së Allahut xh.sh. me ndjekjen e Muhamedit a.s., kur thotë: *"Thuaj: Në qoftë se e doni*

Zbatimi i Sunetit si mrekulli e gjallë dhe mbrojtja e modelit profetik janë mburoja kryesore e myslimanit ndaj krizës shpirtërore, islamofobisë mediatike dhe presioneve ideologjike të hipermodernitetit.

Allahun, më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë!" (Ali Imran, 31).

Allahu Fuqiplotë i ka dhënë ymetit të Muhamedit a.s. dy siguri se nuk do të dënohet, ashtu siç janë dënuar popujt e mëparshëm, të përmendura në suren El Enfal: *"Allahu nuk i dënon ata për aq kohë sa je ti në mesin e tyre dhe Allahu nuk i dënon për aq kohë sa ata i kërkojnë falje Atij."* (El Enfal, 33). Është i mirënjohur komentimi i këtij ajeti me tefsirin se, nga dy siguritë, tani na ka mbetur vetëm njëra, ajo e istigfarit. Megjithatë, dr. Muhamed Ratib en Nabulsi, në një nga ligjëratat e tij në lagjen Tabërbur të Amanit, në vitin 2016, tha se siguria e parë nuk ka përfunduar me vetë shpërnguljen e Muhamedit a.s. në botën tjetër, ashtu siç kuptohet nga shprehja e ajetit, por vazhdon të mbetet e vlefshme për aq kohë sa zbatimi i Sunetit të tij, veprave dhe udhëzimeve të tij mbeten të gjalla në jetën tonë. Ky interpretim i bukur dhe i pranueshëm i ajetit ia forcon lidhjen emocionale ymetit me imamim e tij, fjalët e fundit të të cilit ishin: *"Umeti im, umeti im!"*

Kjo që u tha na bën të kuptojmë se ndjekja e Muhamedit a.s. dhe modeli i tij janë aktualë edhe sot dhe gjithmonë, të vlefshëm për çdo shoqëri, për çdo vend dhe për çdo kohë. Nga myslimanët kërkohet përkushtimi dhe angazhimi për ta kuptuar drejt mënyrën e zbatimit të këtij modeli, si dhe puna e strukturuar për edukimin e komunitetit të tyre mbi rëndësinë dhe peshën e madhe jetike të tij. Megjithatë, ky përkushtim sot nuk ndeshet me një terren neutral. Përkundrazi, ai përballet me sfida të shumta e të ndryshme,

që i dalin përpara myslimanit si valët e një deti të tërbuar dhe erërat e furishme që, siç thotë Mutenebbiu, nuk fryjnë gjithmonë sipas dëshirës së anijeve.

RUAJTJA E TRASHËGIMISË PROFETIKE NË EPOKËN E HIPERMODERNITETIT DHE TEKNOLOGJISË DIGJITALE

Sfidat e shumta, që do t'i ndajmë në këtë trajtim në të jashtme dhe të brendshme, përfaqësojnë pengesën kryesore që ka bërë që kujtimi i jetës dhe veprës së Muhamedit a.s. të mos jetë katalizator i zhvillimit dhe praktikës fetare te myslimanët sot. Zhvillimet e mëdha të këtij moderniteti fluid nuk e kanë lënë terrenin neutral që ideologjitë të zhvillohen dhe të mbizotërojnë e drejta, ajo që përshatet me natyrën njerëzore dhe ia ofron njeriut zgjidhjen, por kanë ardhur paralelisht me sfidat dhe sulmet e gjithanshme, pothuajse nga të gjithë, të drejtuara ndaj të gjithëve.

Islami, kjo fe me potencialin, por edhe me rritjen më të madhe ndër të gjitha fetë dhe ideologjitë e tjera, në këtë



aspekt ka pranuar shigjetat më të mëdha dhe sulmet më të strukturuar e më të shpeshta. Janë themeluar disiplina shkencore me qëllim studimin e çdo gjëje që ka të bëjë me Islamit dhe myslimanët, me të vetmin synim që të frenohet vrulli paqësor i Islamit dhe të sundohen myslimanët. Lexuesi i *Orientalizmit* të Edward Said-it është i informuar mirë për këtë praktikë. Prandaj, në sfidat e jashtme do t'i përfshijmë sulmet ndaj Islamit, që vazhdojnë në mënyrë të strukturuar, në forma gjeniale, prej më shumë se dy shekujsh dhe që pengojnë edhe sot zbatimin e modelit profetik të myslimanët, nën ombrellën e islamofobisë, e cila tashmë është bërë një fenomen i pranuar dhe i pamohueshëm.

ISLAMOFOBIA E SISTEMATIZUAR DHE SULMET NDAJ TRASHËGIMISË PROFETIKE

- **Deformimi mediatik dhe algoritmik i imazhit të Muhamedit a.s.**

Studimet bashkëkohore mbi islamofobinë, si ato të institucioneve si *Bridge Initiative*⁴ në Georgetown apo qendrave kërkimore në Evropë⁵ tregojnë se figura e Muhamedit a.s. është shpifur dhe sulmuar më shumë se e çdo figure tjetër historike. Deformimi mediatik dhe algoritmik i imazhit të Muhamedit a.s. është metoda e parë se si zbatohet sot kjo strategji. Mediat kryesore dhe algoritmet e internetit promovojnë narrativa ku Islami barazohet me dhunën, prapambetjen apo shtypjen. Nxirren nga konteksti thënie dhe veprime të Muhamedit a.s. dhe krijohen përmbajtje me të vetmin qëllim shpërfytyrimin e mësimave islame dhe mesazheve të Muhamedit a.s. Kjo masë e shtuar e linçimit dhe targetimit krijon një kompleks inferioriteti të myslimanët, veçanërisht të rinia në Perëndim apo në mjedise të sekularizuara, duke i bërë ata të ndihen në dyshim ose në faj

për trashëgiminë e tyre, gjë që i shtyn drejt distancimit nga praktika e Sunetit ose drejt praktikimit të tij me ndjenjë faji.

SKEPTICIZMI I PROGRAMUAR DHE SULMET INTELEKTUALE NDAJ AUTENTICITETIT

Në epokën hipermoderne, sulmet nuk janë më thjesht me fyerje primitive, por janë zhvendosur nën petkun e “shkencës”, “objektivitetit” apo “historizmit”. Sot ka një industri të tërë podkastesh, artikujsh dhe librash që përpiqen të dekonstruktojnë shkencën e hadithit dhe të sires. Ata përpiqen ta paraqesin Sunetin si një shpikje politike të shekujve më vonë dhe jo si një trashëgimi reale të Muhamedit a.s. Si pasojë e këtyre lëvizjeve, vërehet edhe indoktrinimi i disa imamëve shqiptarë, të cilët, të ndikuar nga këto tentativa që synojnë ta thyjnë besimin akademik të myslimanëve në hadith dhe Sunet, përqafuan rryma të devijuara, sipas konsensusit të myslimanëve, si pseudo-kuranizmi e të ngjashme.

PRESIONI SOCIAL, IZOLIMI DHE CENSURA E PADUKSHME

Hipermoderniteti ka krijuar një set të ri vlerash globale, si individualizmi ekstrem, relativizmi moral dhe liria absolute pa përgjegjësi. Kushdo që devijon prej tyre etiketohet menjëherë. Nëse një mysliman mbron hapur parimet profetike mbi familjen, moralin, modestinë ose jetën shoqërore, ai rrezikon të sulmohet në rrjetet sociale, të izolohet apo, në rastet më të dhimbshme, edhe të humbë pozicione pune apo akademike në emër të “progresizmit”.

Edhe platformat e mëdha digjitale ushtrojnë një lloj censure të sofistikuar. Ndërsa gjuha e urrejtjes ndaj myslimanëve shpesh tolerohet nën ombrellën e “lirisë së shprehjes”, faqet apo llogaritë që shpjegojnë fenë në mënyrë akademike ose që mbrojnë të drejtat e myslimanëve shpesh përballen me kufizim të padukshëm të shikueshmërisë ose me fshirje.

Këto sulme të strukturuar ndaj Islamit në përgjithësi dhe figurës së Muhamedit a.s. në veçanti krijojnë të myslimanët një presion të madh që i vendos ata në vetëmbrojtje ose në izolim dhe kufizon masën e gjerë të besimtarëve, duke krijuar huti e luhajtje rreth bindjeve të tyre dhe duke zbehur detyrimin e zbatimit të modelit profetik, vetëm e vetëm për t'u përshtatur dhe për të mos u veçuar nga të tjerët. Kjo, e kombinuar me sfidat e brendshme, kompletën listën e arsyeve që e kanë shndërruar figurën e Muhamedit a.s. në jetën e ndjekësit të tij në një figurë simbolike. Gjë që nga atakuesit e figurës së Muhamedit a.s. është synuar, ndërsa nga injorantët myslimanë është përthithur si e mirëqenë!

1 Ibrahim, 5.

2 Merjem, 33.

3 Merjem, 15.

4 The Bridge Initiative, “The Islamophobia Industry”, Georgetown University. (parë për herë të fundit më 13.07.2026). <https://bridge.georgetown.edu/>.

5 Enes Bayraktılı dhe Farid Hafez, red., *European Islamophobia Report*, (Vienna: Leopold Weiss Institute, 2022), 15.

Rebiul-Eveli – muaji i reflektimit, i dashurisë dhe i ripërtëritjes së përkushtimit në pasimin e Muhamedit a.s.

Miftar Ajdini

NJË MUAJ QË NA RIKTHEN TE NJERIU MË I DASHUR PËR BESIMTARËT

Ka muaj që kalojnë në jetën tonë vetëm si pjesë e kalendarit, pa lënë gjurmë të veçanta në mendjen dhe zemrën tonë. Por ka edhe muaj që, sa herë rikthehen, zgjojnë kujtime të mëdha, mesazhe të thella dhe na ftojnë të rishqyrtojmë marrëdhënien tonë me Allahun e Madhërishëm dhe me të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s. Njëri prej këtyre muajve është rebiul evveli.

Për besimtarin, ky muaj nuk është thjesht një emërtim në kalendarin hënor. Ai është një mundësi për reflektim, për vetëllogaritje dhe për ripërtëritjen e dashurisë ndaj njeriut që Allahu e zgjodhi si vulë të pejgamberëve, mëshirë për botët dhe udhërrëfyes të

njerëzimit. Allahu i Madhërishëm thotë: “Ne nuk të kemi dërguar ty, përveçse si mëshirë për botët.” (El Enbija, 107).

Ky ajet fisnik përmbledh në pak fjalë gjithë madhështinë e misionit pejgamberik. Muhamedi a.s. nuk u dërgua vetëm për një popull, për një rajon apo për një periudhë të caktuar historike. Ai u dërgua për mbarë njerëzimin, me një mesazh që i kapërcen kufijtë e kohës dhe të vendit: mesazhin e tevhidit, të drejtësisë, të mëshirës, të moralit të lartë dhe të dinjitetit njerëzor.

Historia njerëzore ka njohur mbretër që sunduan me forcë, filozofë që ndikuan me mendimet e tyre dhe reformatorë që lanë gjurmë në shoqëri. Mirëpo, rrallëherë ajo ka njohur një njeri tek i cili janë bashkuar në mënyrë kaq të përkryer besimi, morali,

Dashuria ndaj Muhamedit a.s., nuk dësh-mohet me emocione kalimtare, por me pasimin e Sunetit të tij.



urtësia, drejtësia, dhembshuria dhe udhëheqja, sa te Muhamedi a.s. Pikërisht për këtë arsye, njohja e tij nuk është vetëm çështje historie, por domosdoshmëri për çdo besimtar që dëshiron ta jetojë fenë e tij me vetëdije.

Prandaj, rebiul evveli nuk duhet të mbetet vetëm një kujtim historik. Ai duhet të shndërrohet në një ndalesë shpirtërore, gjatë së cilës secili prej nesh t'ia shtrojë vetes disa pyetje thelbësore: Sa e njoh të Dërguarin e Allahut a.s.? Sa e dua atë? Dhe, mbi të gjitha, sa e pasoj në jetën time të përditshme?

LINDJA E MUHAMEDIT A.S. – FILLIMI I NJË EPOKE TË RE

Lindja e Muhamedit a.s. shënoi fillimin e një epoke të re në historinë e njerëzimit. Ai erdhi në jetë në Mekë, në një shoqëri ku idhujtaria e kishte errësuar besimin, padrejtësia e kishte zbehur ndjenjën e së drejtës dhe zakonet fisnore shpesh mbizotëronin mbi vlerat njerëzore.

Megjithatë, Allahu i Plotfuqishëm deshi që pikërisht në atë mjedis të lindte njeriu që do ta ndryshonte rrjedhën e historisë. Me ardhjen e tij filloi epoka e Shpalljes së fundit, epoka e tevhidit të pastër, e drejtësisë dhe e ngritjes së dinjitetit njerëzor.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Është Ai që e dërgoi të Dërguarin e Vet me udhëzim dhe fenë e së vërtetës, për ta bërë atë të triumfojë mbi çdo fe tjetër...”* (Et Tevbe, 33).

Muhamedi a.s. nuk erdhi me pasuri, me ushtri të mëdha apo me pushtet tokësor. Forca e tij nuk qëndronte në mjetet materiale, por në Shpalljen hyjnore që mbante dhe në karakterin e tij të jashtëzakonshëm. Ai i ndryshoi zemrat para se ta ndryshonte shoqërinë, sepse çdo ndryshim i qëndrueshëm fillon nga brendësia e njeriut.

Edhe para se t'i zbriste Shpallja, banorët e Mekës e njihnin me nofkën El Emin – i besueshmi. Madje, edhe kundërshtarët më të ashpër nuk mund ta mohonin ndershmërinë, besnikërinë dhe sinqeritetin e tij.

Prandaj, jeta e Muhamedit a.s. na mëson se besimtari është thirrës me sjelljen e tij po aq sa me fjalën e tij. Ai e përhap dritën e Islamit jo vetëm me atë që thotë, por edhe me mënyrën se si sillet me familjen, me fqinjin, me bashkëpunëtorin dhe me çdo njeri që e rrethon.

DASHURIA NDAJ MUHAMEDIT A.S. – THEMELI I BESIMIT

Një nga pyetjet më të rëndësishme që na sjell rebiul evveli është: Çfarë do të thotë ta duash Muhamedin a.s.?

Rebiul evveli
është ftesë për
ta njohur më
mirë të Dër-
guarin a.s., për
ta dashur më
shumë dhe për
ta jetuar shem-
bullin e tij.

Në kulturën islame, dashuria ndaj të Dërguarit a.s. nuk është vetëm një emocion i çastit dhe as një shprehje që përsëritet me gjuhë. Ajo është një lidhje e thellë shpirtërore, e cila dëshmohet përmes bindjes, pasimit dhe përkushtimit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Thuaj: ‘Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua; Allahu do t’ju dojë dhe do t’jua falë mëkatet tuaja.’”* (Ali Imran, 31).

Ky ajet vendos një parim themelor: dashuria e vërtetë ndaj Allahut nuk mund të ndahet nga pasimi i të Dërguarit të Tij a.s. Nuk mjafton që besimtari ta shprehë me fjalë dashurinë e tij; ajo duhet të pasqyrohet në mënyrën se si jeton, si mendon dhe si vepron.

I Dërguari a.s. ka thënë: “Askush prej jush nuk do të besojë plotësisht derisa unë të jem

më i dashur për të sesa prindi i tij, fëmija i tij dhe të gjithë njerëzit.” (Buhariu dhe Muslimi).

Ky hadith nuk flet për dashuri sentimentale, por për dashuri që e vendos udhëzimin pejgamberik mbi dëshirat personale. Sa herë që besimtari gjendet përballë një zgjedhjeje, ai përpiket ta pyesë veten: Çfarë do të ishte më e dashur për Allahun? Si do të vepronte i Dërguari i Tij a.s. në këtë rast?

Kjo është arsyeja pse dashuria ndaj Muhamedit a.s. nuk mbetet kurrë vetëm ndjenjë e fshehur në zemër. Ajo shndërrohet në mënyrë jetese, në moral, në drejtësi, në durim dhe në përkushtim ndaj urdhrave të Allahut. Sa më shumë të forcohet kjo dashuri, aq më shumë besimtari përpiket ta bëjë Muhamedin a.s. modelin e çdo hapi të jetës së tij. Pikërisht këtu fillon kuptimi i vërtetë i pasimit të Sunetit.

REBIUL EVVELI – MUAJI I RINGJALLJES SË SUNETIT

Nëse rebiul evveli e zgjon në zemrat tona dashurinë për Muhamedin a.s., atëherë kjo dashuri duhet të marrë formë konkrete në jetën tonë. Historia e tij nuk është shkruar vetëm për t'u lexuar, por për t'u jetuar. Ai a.s. nuk është një figurë që i përket vetëm së kaluarës dhe që admirohet nga larg; ai është udhërrëfyesi i gjallë i çdo besimtari deri në Ditën e Kiametit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Vërtet, ju e keni në të Dërguarin e Allahut shembullin më të mirë për këdo që shpreson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe e përmend Allahun shumë.”* (El Ahzab, 21).

Ky ajet është themeli mbi të cilin ndërtohet koncepti islam i pasimit. Besimtari nuk pyet vetëm: Çfarë ka thënë i Dërguari a.s.?, por edhe: Si ka jetuar ai? Si është sjellë me njerëzit? Si i ka marrë vendimet? Si ka falur? Si ka duruar? Si ka dashur?

Në jetën e tij gjejmë përgjigje për çdo dimension të ekzistencës njerëzore: për jetën familjare dhe shoqërore, për adhurimin dhe punën, për paqen dhe konfliktin, për gëzimin dhe sprovën. Pikërisht kjo e bën Sunetin udhërrëfyes të përhershëm dhe jo vetëm trashëgimi historike.

Suneti nuk është thjesht përmbledhje dispozitash juridike; ai është shpjegimi praktik i Kuranit. Nuk është rastësi që, kur Aisheja r.a. u pyet për moralin e të Dërguarit a.s., ajo u përgjigj me fjalët e njohura: “Morali i tij ishte Kurani.” (Muslimi).

Sa madhështore është kjo dëshmi! Kurani nuk ishte për Muhamedin a.s. vetëm një Libër që lexohej, por një realitet që jetohej. Çdo urdhër hyjnor mishërohej në sjelljen e tij dhe çdo ndalim pasqyrohej në largimin e tij prej tij. Prandaj, kush dëshiron ta kuptojë Kuranin në praktikë, le ta shikojë jetën e Muhamedit a.s.

DASHURIA PROVOHET ME PASIM

Në kohën tonë flitet shpesh për dashurinë ndaj të Dërguarit a.s. Kjo është shenjë e mirë, sepse zemra e besimtarit nuk mund të jetë e zbrazët nga dashuria për të. Megjithatë, Islami na mëson se dashuria nuk matet vetëm me fjalë, me emocione apo me manifestime të jashtme. Ajo provohet me bindje dhe pasim.

Hasan el Basriu ka thënë: “Disa njerëz pretenduan se e donin Allahun, prandaj Allahu i sprovoi me këtë ajet: ‘Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua...’”

Ky koment i njërit prej dijetarëve më të mëdhenj të brezit të tabiinëve na kujton se dashuria e singertë ka gjithmonë një dëshmi. Ajo provohet pikërisht atëherë kur Suneti përplasat me dëshirat tona, me zakonet tona ose me interesat tona personale.

Nuk është e vështirë ta admirosh mëshirën e Muhamedit a.s.; sfida është ta ndjekësh shembullin e tij kur egoja kërkon hakmarrje, kur krenaria kërkon të mbizotërojë ose kur zemra priret drejt padrejtësisë.

Prandaj, rebiul evveli duhet të na shtyjë ta pyesim veten me singritet: Çfarë do të ndryshoj në jetën time për hir të pasimit të të Dërguarit të Allahut a.s.?

Nderimi më i
madh për
Pejgamberin
ﷺ është ta
bëjmë moralin
dhe udhëzimin
e tij pjesë të
jetës sonë të
përditshme.

NJOHJA E SIRES - NJË NEVOJË E ÇDO BESIMTARI

Është paradoksale që shumë njerëz e njohin me hollësi jetën e figurave historike, sportistëve, artistëve apo personaliteteve bashkëkohore, ndërsa dinë shumë pak për jetën e njeriut që Allahu e zgjodhi si vulë të pejgamberëve.

Si mund ta duash vërtet dikë që nuk e njeh?

Leximi i sires nuk është ushtrim historik apo interes kulturor. Ai është shkollë besimi, durimi, urtësie dhe edukimi. Në faqet e saj mësojmë se si ndërtohen familjet mbi mëshirën dhe respektin, si edukohen brezat me dashuri dhe përgjegjësi, si përballohen sprovat me durim dhe si fitohet pa u bërë kurrë zullumqar.

Në siren e Muhamedit a.s. shohim prijësin që ishte i drejtë, gjykatësin që ishte i paanshëm, bashkëshortin që ishte i dhembshur, prindin që ishte i butë, fqinjin që ishte i kujdesshëm dhe adhuresin që ishte më mirënjohësi ndaj Zotit të tij.

Prandaj, rebiul evveli mund të bëhet fillimi i një tradite të bukur në familjet tona: të lexohet çdo ditë një pjesë nga jeta e Muhamedit a.s., që emri i tij të mos mbetet vetëm në salavate, por të jetë i pranishëm edhe në edukimin e fëmijëve, në bisedat familjare dhe në vendimet e përditshme.



TA RINGJALLIM SUNETIN NË JETËN TONË

Shpeshherë, kur përmendet ringjallja e Sunetit, mendja shkon vetëm te disa praktika individuale të adhurimit. Megjithatë, Suneti është shumë më i gjerë se kaq.

Ai ringjallet kur tregtari është i sinqertë në shitblerje;

Kur punëtori e kryen detyrën me ndërgjegje;

Kur mësuesi është i drejtë me nxënësit e tij;

Kur prindi i edukon fëmijët me urtësi dhe butësi;

Kur bashkëshortët respektojnë dhe nderojnë njëri-tjetrin;

Kur i forti nuk e shtyp të dobëtin;

Kur besimtari e ruan gjuhën nga përgojimi dhe zemrën nga urrejtja.

Muhamedi a.s. nuk ndërtoi vetëm xhami; ai ndërtoi njerëz. Dhe kur ndërtohen njerëzit, ndërtohen familjet. Kur ndërtohen familjet, ndërtohet edhe shoqëria.

Pikërisht për këtë arsye, pasimi i Sunetit nuk është kthim pas në histori, por ecje përpara me dritën e udhëzimit pejgamberik. Ai nuk e pengon zhvillimin e njeriut; përkundrazi, e orienton atë drejt një qytetërimi ku dija, drejtësia, mëshira dhe morali ecin së bashku.

ÇFARË NA MËSON REBIUL EVVELI SOT?

Rebiul evveli nuk është vetëm kujtesë e një ngjarjeje të madhe historike. Ai është ftesë që, çdo vit, ta rivlerësojmë marrëdhënien tonë me njeriun që Allahu e zgjodhi si udhërrëfyes të njerëzimit.

Jetojmë në një kohë kur njerëzimi ka bërë përparime të jashtëzakonshme në shkencë, teknologji dhe komunikim, por njëkohësisht po përballet me kriza të thella morale e shpirtërore. Dhuna, padrejtësia, egoizmi, përçarjet dhe mungesa e besimit kanë lënë gjurmë në familje, në shoqëri dhe në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve.

Pikërisht në një kohë të tillë, mesazhi i Muhamedit a.s. shfaqet me gjithë freskinë dhe aktualitetin e tij. Bota ka nevojë për drejtësinë e tij, për mëshirën e tij, për ndershmërinë e tij, për respektin e tij ndaj dinjitetit njerëzor dhe për besnikërinë e tij ndaj së vërtetës. Vlerat që ai i solli nuk i përkasin vetëm shekullit të shtatë; ato janë vlera që i japin kuptim çdo kohe dhe çdo shoqërie.

Rebiul evveli na kujton se identiteti ynë islam nuk ndërtohet mbi emocione kalimtare apo mbi kujtime ceremoniale. Ai ndërtohet mbi një lidhje të gjallë e të përhershme me Kuranin dhe me Sunetin, mbi përpjekjen e vazhdueshme për ta përmirësuar veten dhe për ta bërë moralin pejgamberik pjesë të karakterit tonë.

Ibën Kajim el Xheuzije ka thënë: “Lumturia e njeriut qëndron në përputhjen e zemrës së tij me atë që solli i Dërguari i Allahut a.s.”

Sa më shumë që t’i afrohemi udhëzimit të Muhamedit a.s., aq më shumë do të gjejmë qetësi në zemrat tona, harmoni në familjet tona dhe siguri në rrugën tonë drejt Allahut. Pasimi i tij nuk e kufizon njeriun; ai e çliron nga robëria e epsheve, e paragjykimeve dhe e padrejtësisë.

Në të vërtetë, nderimi më i madh që mund t’i bëjmë të Dërguarit të Allahut a.s. nuk është që vetëm ta kujtojmë në ditë të caktuara, por që ta bëjmë shembullin e tij pjesë të jetës sonë të përditshme. Dashuria për të nuk dëshmohet vetëm me fjalë të bukura, por me ndershmëri në tregti, me drejtësi në vendime, me butësi në familje, me sinqeritet në adhurim dhe me mëshirë ndaj çdo krijese.

PËRMBYLLJE

Le ta shndërrojmë, pra, rebiul evvelin në fillim të një ndryshimi të sinqertë dhe jo vetëm në një muaj emocionesh kalimtare. Le të jetë ky muaj pikënisje për ta njohur më mirë të Dërguarin a.s., për ta dashur më shumë dhe, mbi të gjitha, për ta pasuar me më shumë përkushtim. Sepse nderimi më i madh që mund t’i bëjmë atij nuk është vetëm ta përmendim shpesh emrin e tij, por ta mbajmë gjallë udhëzimin e tij në jetën tonë.

Nëse, në përfundim të këtij muaji, kemi lexuar më shumë nga jeta e Muhamedit a.s., kemi shtuar salavatet mbi të, kemi përmirësuar një sjellje, kemi falur dikë që na ka lënduar, kemi ndihmuar një nevojtar ose kemi lënë një ves të keq për hir të Allahut dhe në pasim të të Dërguarit të Tij a.s., atëherë rebiul evveli ka lënë gjurmën që duhet të lërë në zemrat tona.

Por, nëse ai kalon vetëm si një datë në kalendar, si një ceremoni apo si një kujtim i bukur pa ndikim në jetën tonë, atëherë e kemi humbur mesazhin e tij më të çmuar.

Lusim Allahun e Madhërishëm që ta mbushë zemrën tonë me dashuri të sinqertë për të Dërguarin e Tij a.s., ta bëjë atë më të dashur për ne se çdo gjë tjetër, të na mundësojë ta njohim Sunetin e tij, ta pasojmë me përkushtim dhe të na bashkojë me të në Xhenetin Firdevs.

O Allah! Dërgo salavate, paqe dhe bekime mbi robin dhe të Dërguarin Tënd, Muhamedin a.s., mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. Amin!

Burimet kryesore

Kurani fisnik.

Sahihu i Buhariut.

Sahihu i Muslimit.

Tefsiri i Ibni Kethirit.

Zadul Me’ad.

Er Rehikul Mahtum.

Esh Shifa bi ta’rif hukukil Mustafa.

Shënim: Referencat e ajeteve dhe haditheve janë marrë nga burimet autentike islame, ndërsa reflektimet dhe shpjegimet janë mbështetur në veprat e dijetarëve klasikë të ehli sunetit.

A kanë përgjegjësi besimtarët në përhapjen e ateizmit?

Mr. Adnan Shala

Ateizëm praktik nënkuptojmë largimin nga feja jo për shkak të argumenteve filozofike, por për shkak të përvojave negative me përfaqësuesit e saj.

Një myezin, zëri i të cilit ishte jashtëzakonisht i pakëndshëm, filloi të thërriste ezanin në një vend të banuar nga jomyslimanët. Myslimanët u shqetësuan, duke menduar se zëri i tij mund të shkaktonte trazira dhe pakënaqësi. Një ditë, një jomysliman erdhi me një rrobë shumë të çmuar në dorë dhe pyeti: “Ku është ai myezini që këndon ezanin, ai njeri i bekuar? Ju lutem, ma tregoni. Ezani i tij më solli qetësi dhe lehtësim. Kam një borxh mirënjohjeje ndaj tij dhe dëshiroj t’ia shpreh duke ia dhuruar këto dhurata.” Myslimanët mbetën të habitur dhe i thanë: “Si është e mundur? Si mund të gjejë njeriu qetësi në një zë kaq të shëmtuar?” Atëherë jomyslimani u

shpjegoi: “Unë kam një vajzë shumë të bukur. Prej kohësh ajo kishte vendosur ta përqafonte Islamin. Çfarëdo që bëra për ta larguar nga ky mendim, nuk pata sukses. Mirëpo, pak ditë më parë, ajo dëgjoi zërin e këtij njeriu dhe më pyeti: “Çfarë është kjo? Nuk kam dëgjuar kurrë një zë kaq të pakëndshëm.” Unë i thashë: “Ky është ezani. Është thirrja me të cilën mysliimanët ftohen në adhurim.” Ajo nuk më besoi dhe pyeti edhe disa njerëz të tjerë. Kur të gjithë i dhanë të njëjtën përgjigje, hoqi dorë nga vendimi për t’u bërë mysliimane. Kështu, unë u lehtësova. Pikërisht për këtë arsye erdha t’i sjell këto dhurata.” (Mevlana Xhelaluddin Rumi)¹



Debati modern ndërmjet teizmit dhe ateizmit shpesh paraqitet si një betejë metafizike: a ekziston Zoti, a është universi produkt i krijimit apo i rastësisë, a janë shkenca dhe feja në konflikt? Këto janë pyetje thelbësore, por ato nuk e shterojnë tërësinë e fenomenit të mosbesimit. Një dimension po aq i rëndësishëm, i cili shpesh anashkalohet në debatet apologjetike, është ai i ateizmit praktik, i cili lind jo nga refuzimi filozofik i Zotit, por nga refuzimi i mënyrës se si besimtarët e kanë përfaqësuar Atë në jetën e përditshme. Pra, me një fjalë, me ateizëm praktik nënkuptojmë largimin nga feja jo për shkak të argumenteve filozofike, por për shkak të përvojave negative me përfaqësuesit e saj.

Nëse ateizmi do të ishte thjesht produkt i argumenteve filozofike, atëherë çdo lexues i Nietzsche-s ose i Dawkins-it do të bëhej ateist, ndërsa çdo lexues i Gazaliut apo i Plantingës do të bëhej besimtar. Megjithatë, realiteti është më kompleks: njerëzit i ndryshojnë bindjet jo vetëm për shkak të logjikës, por edhe për shkak të përvojave personale, krizave morale dhe mënyrës se si ata e përjetojnë religjionin në jetën e tyre. Pikërisht në këtë pikë lind pyetja: a është e mundur që një pjesë e ateizmit të jetë një reagim kundër përfaqësimit njerëzor të fesë dhe jo kundër vetë thelbit të saj?

Ateizmi praktik në shoqëritë fetare nuk është shpesh një refuzim filozofik i Zotit, por një krizë besimi ndaj atyre që pretendojnë ta përfaqësojnë Atë. Përgjigjja islame ndaj kësaj sfide kërkon një vetëkritikë të thellë dhe një rikthim të dëshmia e gjallë e besimit nëpërmjet moralit, sinqeritetit dhe përshtatjes me kohën. Kjo qasje mbështetet në një dallim themelor që e gjejmë në vetë burimet islame: Islami është i përsosur, ndërsa myslimanët nuk janë. Shpallja është hyjnore, por mënyra se si ajo kuptohet dhe jetohet mbetet njerëzore dhe e ekspozuar ndaj gabimeve.

HENDEKU NDËRMJET SHPALLJES DHE PËRFAQËSIMIT

Kurani e paralajmëron këtë rrezik. Ai nuk polemizon vetëm me mohuesit; në shumë raste, kritikën më të ashpër i drejtohen vetë besimtarëve. Një nga ajetet më tronditëse në këtë drejtim është: “O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni!” (Saf, 2-3). Ky ajet nuk u drejtohet ateistëve apo idhujtarëve, por atyre që besojnë dhe që, me jetën e

tyre, mohojnë atë që predikojnë. Ai nënvizon se problemi në Islam nuk është vetëm ajo që njeriu beson, por edhe mënyra se si ai e dëshmon atë besim.

Për këtë arsye, Kurani e përshkruan ymetin islam jo thjesht si një bashkësi besimtarësh, por si një bashkësi “dëshmitare mbi njerëzit”.² Fjala shehadet (dëshmi) nuk kufizohet vetëm në shqiptimin e dëshmisë së besimit; ajo nënkupton një dëshmi të vazhdueshme përmes jetës, karakterit dhe moralit. Myslimani është thirrur ta bëjë Allahun të njohur përmes drejtësisë, mëshirës dhe besnikërisë së tij. Ky parim nuk mbetet vetëm një ideal teologjik, por gjen mbështetje edhe në studimet bashkëkohore, të cilat tregojnë se mënyra se si besimtarët e mishërojnë fenë ndikon drejtpërdrejt në perceptimin që të tjerët krijojnë për të.

Kjo ide mbështetet edhe nga studimet bashkëkohore mbi fenomenin e ateizmit. Yaşar Ünal, duke analizuar shkaqet e asaj që ai e quan “ateizëm praktik”, arrin në përfundimin se shumë njerëz largohen nga feja jo pasi kanë rrëzuar filozofikisht argumentet për ekzistencën e Zotit, por sepse nuk arrijnë t'i pajtojnë idealet morale të religjionit me realitetin që shohin te një pjesë e besimtarëve.³ Në këtë rast, problemi nuk është

metafizik, por etik. Individidi nuk pyet më: “A ekziston Zoti?”, por: “Nëse kjo është feja, pse duhet ta besoj?”.

Pikërisht për këtë arsye, përgjegjësia morale e besimtarit është e madhe. Njerëzit nuk e lexojnë gjithmonë Kuranin, por ata “lexojnë” jetën e besimtarëve. Ata nuk e studiojnë domosdoshmërisht akiden islame, por e gjykojnë fenë duke parë mënyrën se si myslimanët sillen me familjen, me të varfrit dhe me tjetrin. Nëse kjo sjellje bie në kundërshtim me idealet që predikon Islami, krijohet një hendek ndërmjet bukurisë së shpalljes dhe përvojës konkrete të individit.

Një përgjigje domethënëse ndaj kësaj çështjeje e gjejmë edhe te Muhamed Gazali, i cili e sheh krizën e ymetit jo si krizë të mungesës së riteve, por si krizë të karakterit. Sipas tij, namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi nuk janë qëllime në vetvete, por mjete për formimin e një njeriu me moral të lartë. Kur këto adhurime humbin funksionin e tyre edukues dhe besimtari vazhdon të jetë i padrejtë, arrogant, mashtrues apo i ashpër me njerëzit, atëherë ai nuk dëmton vetëm veten, por e zbeh edhe autoritetin moral të fesë që përfaqëson.



Gazali shkon edhe më tej kur pohon se edukata nuk ndërtohet vetëm me predikime, por, mbi të gjitha, me shembullin personal, sepse njerëzit nuk ndjekin vetëm atë që dëgjojnë, por sidomos atë që shohin të mishëruar në jetën e atij që i thërret. Në këtë kuptim, përgjegjësia e besimtarit nuk kufizohet në përcjelljen e mesazhit islam, por shtrihet edhe në mënyrën se si ai e mishëron atë në karakterin e tij. Kur kjo dëshmi morale mungon, feja mund ta humbasë fuqinë e saj bindëse jo për shkak të dobësisë së argumenteve, por për shkak të dobësisë së dëshmitarëve të saj. Ky është, në thelb, një paralajmërim se deformimi i karakterit të besimtarit mund të bëhet një nga shkaqet që njerëzit të ftohen nga feja dhe të largohen prej saj, në vend që të afrohen pranë saj.⁴

Megjithatë, përgjegjësia e besimtarit nuk kufizohet vetëm në dimensionin etik të jetës personale. Historia tregon se besueshmëria e fesë cenohet jo vetëm nga dobësitë morale

Sfida më e madhe për besimtarin nuk është të provojë se Allahu ekziston, por ta dëshmojë bukurinë e Tij përmes jetës së vet.

të individëve, por edhe kur ajo instrumentalizohet për interesa politike, ideologjike ose shoqërore. Në këtë kontekst, Ali Shariati thotë se ekziston një religjion që e çliron njeriun dhe ekziston një religjion që përdoret për të justifikuar pushtetin, padrejtësinë dhe privilegjin. Kur feja shndërrohet në instrument të interesave njerëzore, ajo humbet funksionin e saj profetik dhe fillon të prodhojë zhgënjim, revoltë dhe mosbesim.⁵

FANATIZMI, ARROGANCA INTELEKTUALE DHE INSTRUMENTALIZIMI I FESË

Një nga arsyt pse ateizmi praktik gjen terren është mungesa e pajtimit midis mesazhit dhe jetës së besimtarit. Hipokrizia, të cilën Kurani e konsideron një nga sëmundjet më të rrezikshme shpirtërore, nuk është vetëm një mangësi morale e individit, por një deformim i dëshmisë që ai duhet të japë para botës. Besimtari që flet për drejtësinë, por sillet padrejtësisht; që flet për mëshirën, por ushqen urrejtje; që predikon sinqeritetin, por jeton me mashtrim, e shndërron fenë në objekt dyshimi për ata që e vëzhgojnë. Imam Gazaliu e sheh harmoninë ndërmjet dijes dhe veprës si kusht të domosdoshëm për besueshmërinë e dijetarit. Ai paralajmëron se dija që nuk shndërrohet në moral dhe veprim e humbet funksionin e saj udhëzues, ndërsa bartësi i saj rrezikon të bëhet jo urë drejt së vërtetës, por pengesë në rrugën e saj.⁶

Një tjetër faktor që e thëllon këtë krizë është fanatizmi fetar dhe monopolizimi i së vërtetës. Kur besimtari fillon ta identifikojë Islamin me medhhebin, organizatën ose grupin e tij, ai e zvogëlon një mesazh hyjnor në kufijtë e një identiteti njerëzor. Kjo prodhon përçarje brenda bashkësisë së besimtarëve dhe krijon te vëzhguesi përshlytjen se religjioni është më shumë burim konflikti sesa paqeje. Ënal e rendit taassubin (fanatizmin), radikalizmin dhe përjashtimin e tjetrit ndër faktorët kryesorë që ushqejnë ateizmin praktik. Kur religjioni paraqitet si monopol i një grupi të vetëm, shumë të rinj fillojnë ta shohin largimin nga religjioni si rrugën e vetme drejt lirisë intelektuale.⁷



Po ashtu, krijimi i një konflikti artificial midis fesë dhe arsyes e ka dëmtuar imazhin e Islamit. Në disa mjedise fetare, pyetja trajtohet si shenjë dobësie në besim. Megjithatë, kjo qasje nuk përputhet me frymën e Kuranit, i cili është i mbushur me pyetje që e ftojnë njeriun të mendojë: “A nuk kundrojnë?”, “A nuk meditojnë?”, “A nuk shikojnë?”. Sa herë që feja paraqitet si armike e shkencës dhe e filozofisë, problemi nuk qëndron tek Islami, por tek interpretimi i gabuar i tij. Ky deformim krijon një ambient ku brezi i ri mendon se duhet të zgjedhë midis besimit dhe arsyes, duke e ushqyer kështu mosbesimin.⁸

Instrumentalizimi i fesë për interesa politike është një plagë tjetër. Historia dëshmon se, sa herë që religjioni është përdorur për të legjitimuar pushtetin dhe padrejtësinë, ai e ka humbur besueshmërinë e tij morale. Siç argumenton edhe Ernst Bloch, një pjesë e kritikës ndaj religjionit nuk lindi nga refuzimi metafizik i Zotit, por nga revolta kundër institucioneve fetare që ishin identifikuar me shtypjen dhe padrejtësinë.⁹

Së fundi, paaftësia për ta komunikuar fenë në gjuhën e kohës krijon një hendek midis traditës dhe brezit të ri. Kur përgjigjet fetare nuk prekin më pyetjet ekzistenciale të të rinjve, ata largohen nga feja jo për shkak të mungesës së edukimit, por për shkak të mungesës së dialogut dhe argumentimit.¹⁰

Sfida e ateizmit praktik nuk mund të reduktohet në një debat midis besimit dhe mosbesimit. Ajo është, në një masë të madhe, një sfidë për vetë besimtarët. Përgjigjja islame ndaj kësaj sfide nuk është të zemërohem me ata që largohen, por të pyesim veten nëse kemi qenë dëshmitarë të denjë të shpalljes. Nëse dikush do ta njihnte Islamin vetëm përmes jetës sonë, a do ta donte më shumë Allahun apo do të largohej prej Tij?

Kjo nuk do të thotë se përgjegjësia për ateizmin bie tërësisht mbi besimtarët. Ateizmi është një fenomen kompleks, i ndikuar nga faktorë të shumtë. Megjithatë,

mënyra se si besimtarët e përfaqësojnë fenë ndikon ndjeshëm në perceptimin që të tjerët krijojnë për të. Sjellja e besimtarëve nuk është shkak i ateizmit; ekzistenca e Allahut nuk varet nga morali i njerëzve. Por ajo mund të bëhet shkak që e shtyn dikë ta refuzojë fenë pa e njohur atë në thellësinë e saj, ashtu siç e përshkruan edhe Rumi në tregimin e myezinit.

Prandaj, polemika apologjetike, sado e rëndësishme, nuk mjafton nëse nuk shoqërohet me dëshminë morale të jetës. Pejgamberi Muhamed a.s. nuk e ndërtoi misionin e tij mbi triumfin në debate; ai ndërtoi një bashkësi, jeta e së cilës u bë argumenti më bindës për vërtetësinë e shpalljes. Kur Aishja r.a. u pyet për moralin e tij, ajo dha përgjigjen që përmbledh tërë filozofinë islame të edukimit: “Moralin e tij ishte Kurani.” Në këtë fjalë fshihet përgjigjja më e plotë: Pejgamberi ishte interpretimi i gjallë i shpalljes. Para se njerëzit t’i dëgjonin fjalët, ata e panë dritën e fesë në karakterin e tij. Në fund të fundit, sfida më e madhe për besimtarin nuk është të provojë se Allahu ekziston, por të dëshmojë bukurinë e Tij përmes jetës së vet.

1 Mevlânâ Celâleddîn-i Rûmî, Mesnevî, c. 5, vargjet 3367–3388.

2 El Bekare, 2:143

3 Yaşar Ünal, “Pratik Ateizmi Besleyen Dinsel Tutumlar,” İslâmî Araştırmalar 31, nr. 3 (2020): 594.

4 Muhamed Gazali, Karakteri i muslimanit, përktheu Bashkim Aliu (Prishtinë: Komiteti i Bashkuar Saudit – Ndihmë Kosovës, 2004), 7–23.

5 Ali Shariati, Religion vs. Religion, trans. Laleh Bakhtiar (Albuquerque, NM: ABJAD Book Designers and Builders, 1988), 31–35, 56–57.

6 Ebu Hamid el Gazali, İhyâ-u Ulûmî’-d-Dîn, trans. Ahmed Serdaroglu (İstanbul: Bedir Yayınevi, t.y.), 1:93–95, 109–110.

7 Yaşar Ünal, “Pratik Ateizmi Besleyen Dinsel Tutumlar,” İslâmî Araştırmalar 31, nr. 3 (2020): 590, 596–598.

8 Ünal, “Pratik Ateizmi Besleyen Dinsel Tutumlar”, 590, 603.

9 Ernst Bloch, Atheism in Christianity: The Religion of the Exodus and the Kingdom, trans. J. T. Swann (London: Verso, 2009), 221–236.

10 Ünal, “Pratik Ateizmi Besleyen Dinsel Tutumlar,” 601–603.

Shtyllat kryesore të një martese të suksesshme sipas Islamit

Nehat Shehu

HYRJE

“Dhe nga shenjat e Tij është se krijoi për ju nga vetë lloji juaj bashkëshorte, që të gjeni prehje pranë tyre, dhe vendosi ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Er Rum, 21).

Familja përfaqëson institucionin më të hershëm dhe më të rëndësishëm në jetën njerëzore. Ajo është bërthama e parë ku njeriu formohet si individ, mëson vlerat themelore dhe ndërton identitetin e tij moral dhe shoqëror. Prandaj, çdo shoqëri që synon stabilitet dhe zhvillim afatgjatë duhet domosdoshmërisht të ketë familje të shëndosha.

Islami e trajton martesën jo vetëm si një marrëveshje juridike (akd), por si një marrëveshje morale dhe shpirtërore (mithakun ghalidh), të cilën Kurani e përshkruan me të njëjtën terminologji që përdor edhe për besëlidhjet e mëdha të pejgamberëve. Kjo tregon se lidhja bashkëshortore nuk është një raport i zakonshëm, por një amanet para Allahut, i ndërtuar mbi përgjegjësi, besnikëri dhe përkushtim.

Në kohën tonë, edhe pse janë shtuar mundësitë materiale dhe teknologjike, paradoksalisht janë shtuar edhe problemet familjare. Rritja e numrit të shkurorëzimeve, dobësimi i komunikimit ndërmjet bashkë-

Familja e shëndoshë ndërtohet mbi besimin, devotshmërinë dhe përgjegjësinë para Allahut.



shortëve, individualizmi dhe ndikimi i modeleve të huaja mbi familjen myslimane kanë krijuar një realitet që kërkon rikthim serioz të mësimet islame mbi martesën.

Mendimtari algjerian Malik bin Nebiu vëren se kriza e qytetërimit fillon gjithmonë me krizën e familjes, sepse familja është vendi ku formohet njeriu dhe ndërtohet ndërgjegjja e tij. Prandaj, kur flasim për shtyllat e një martese të suksesshme sipas Islamit, nuk kemi parasysh vetëm rregulla juridike, por një sistem të plotë vlerash që synon lumturinë e bashkëshortëve, edukimin e brezave dhe ruajtjen e ekuilibrit shoqëror.^{1 2 3}

BESIMI DHE DEVOTSHMËRIA – THEMELE TË FAMILJES

Çdo ndërtim i qëndrueshëm kërkon themele të forta dhe të palëkundura. Në kontekstin e familjes, këto themele nuk përbëhen nga faktorë të jashtëm, si pasuria, bukuria, statusi shoqëror apo përputhshmëria kulturore, por nga besimi dhe devotshmëria. Këto dy elemente përbëjnë boshtin mbi të cilin ndërtohet stabiliteti i vërtetë familjar dhe garantohet vazhdimësia e marrëdhënies bashkëshortore.

Një bashkëshort i devotshëm nuk e shikon martesën si një marrëdhënie të përkohshme, të bazuar vetëm në ndjenja apo interes personal, por si një amanet të madh hyjnor. Kjo e bën atë më të vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka ndaj bashkëshortit/es, më të kujdesshëm në fjalë dhe më të drejtë në veprime. Në këtë mënyrë, martesa shndërrohet në një hapësirë ku nuk mbizotëron egoizmi, por ndërgjegjja morale dhe ndjenja e përgjegjësisë para Zotit. Besimi në Islam nuk kufizohet vetëm në kryerjen e riteve fetare, por përfaqëson një sistem të plotë jetese që përfshin dimensionin moral, shoqëror dhe psikologjik të njeriut.⁴

Ai ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si individ komunikon, zgjidh konfliktet dhe ndërton marrëdhënie. Një person me besim të thellë e sheh bashkëshortin jo si kundërshtar në konflikt, por si partner në një mision të përbashkët jetësor. Në këtë kuptim, besimi shërben si mekanizëm rregullues i sjelljes brenda familjes. Ai e frenon padrejtësinë, e kufizon agresivitetin emocional dhe e forcon ndjenjën e drejtësisë dhe të mëshirës në marrëdhënie.

Kur një individ është i vetëdijshëm se veprimet e tij janë të mbikëqyrura nga Zoti, ai bëhet më i matur dhe më i përgjegjshëm në çdo vendim që ndikon në jetën familjare. Në literaturën klasike islame, martesa nuk shihet vetëm si institucion shoqëror, por edhe si proces edukimi shpirtëror dhe moral. Ebu Hamid el Gazali thekson se, përmes jetës

Dashuria e vërtetë nuk është vetëm ndjenjë, por edhe mëshirë, respekt dhe përkushtim i përditshëm.

familjare, njeriu kalitet në mënyrë të vazhdueshme në virtyte themelore si durimi, vetëkontrolli, falja, sinqeriteti dhe përlësia.

Sipas kësaj qasjeje, karakteri i njeriut nuk zbulohet plotësisht në izolim, por në jetën e përditshme familjare, ku ai përballet me sfida reale dhe emocione të forta. Pikërisht për këtë arsye, martesa nuk mund të kuptohet vetëm si bashkëjetesë fizike apo ndarje detyrash, por si një shkollë e vazhdueshme e edukimit të karakterit. Në këtë “shkollë”, besimi luan rolin e mësuesit të brendshëm që udhëheq sjelljen dhe formëson qëndrimet e individit.⁵

Po ashtu, në veprën e tij monumentale “Esh Shifa bi Ta’rif Hukuk el Mustafa”, Kadi Ijadi e paraqet sjelljen e Pejgamberit Muha\

med a.s. si modelin më të lartë të etikës familjare, duke theksuar butësinë, respektin dhe drejtësinë e tij në marrëdhëniet bashkëshortore. Kjo tregon se praktika profetike është bazë e rëndësishme për ndërtimin e familjes së shëndoshë.

Kur besimi dhe devotshmëria janë të pranishme në jetën familjare, martesa bëhet më e qëndrueshme, më rezistente ndaj krizave dhe më e aftë për të përballuar sfidat e kohës. Konfliktet nuk shndërrohen në ndarje, por në mundësi për reflektim dhe përmirësim.

Në këtë mënyrë, familja nuk mbetet një strukturë e brishtë emocionale, por shndërrohet në një institucion të fortë shpirtëror dhe moral, ku mbizotërojnë stabiliteti, respekti dhe qetësia.^{6 7}

DASHURIA, MËSHIRA DHE RESPEKTI – ZEMRA TË FAMILJES

Nëse besimi dhe devotshmëria përbëjnë themelin mbi të cilin ndërtohet familja, atëherë dashuria, mëshira dhe respekti janë elementet që i japin asaj jetë dhe kuptim të vazhdueshëm. Pa këto tri dimensione, familja mund të ekzistojë formalisht si strukturë, por humbet ngrohtësinë shpirtërore dhe stabilitetin emocional që e bëjnë atë funksionale dhe të shëndetshme.⁸

Islami e ndërton martesën mbi një ekuilibër të veçantë ndërmjet dimensionit emocional dhe atij moral. Në këtë kuptim, dashuria (mevedde) nuk është vetëm një ndjenjë e çastit, por një prirje e thellë që lidh zemrat dhe krijon afërsi ndërmjet bashkëshortëve.⁹ Ajo shfaqet në forma të ndryshme: në kujdesin e përditshëm, në fjalët e mira, në respektin ndaj ndjenjave të tjetrit dhe në gatishmërinë për të sakrifikuar për mirëqenien e përbashkët. Megjithatë,

Islami nuk e kufizon martesën vetëm në dimensionin e dashurisë emocionale. Ai i shton asaj një element më të qëndrueshëm dhe më të thellë: mëshirën. Mëshira është ajo forcë që e ruan lidhjen bashkëshortore në momentet kur emocionet dobësohen, kur entuziazmi fillestar zbehet dhe kur përditshmëria sjell sfida të ndryshme. Ndryshe nga dashuria, e cila mund të ndikohet nga rrethanat dhe gjendjet psikologjike, mëshira është një qëndrim i brendshëm dhe i qëndrueshëm që buron nga mirëkuptimi, përgjegjësia dhe ndjenja e detyrës ndaj njëritjetrit. Në jetën reale, çdo martesë kalon nëpër faza të ndryshme.^{10 11} Fillimi shpesh karakterizohet nga emocionet e forta dhe afërsia shpirtërore, por me kalimin e kohës vijnë përgjegjësitë e përditshme: kujdesi për fëmijët, vështirësitë ekonomike, lodhja fizike dhe psikologjike, si dhe ndryshimet personale që ndodhin natyrshëm me moshën. Në këto faza, lidhja bashkëshortore nuk mund të mbështetet vetëm në ndjenja, por kërkon pjekuri emocionale, durim dhe gatishmëri për sakrificë.

Një element tjetër thelbësor që shpesh neglizhohet është respekti reciprok. Respekti përfaqëson bazën e dinjitetit brenda familjes dhe është kusht i domosdoshëm për ruajtjen e harmonisë. Kur respektohet bashkëshorti apo bashkëshortja, ruhet edhe vlera e marrëdhënies; kur ky respekt mungon, edhe dashuria fillon të dobësohet gradualisht.

Shprehjet fyese, nënçmimi, ironia e tepruar dhe mosvlerësimi i përpjekjeve të njërit-tjetrit janë ndër faktorët kryesorë që krijojnë distancë emocionale dhe tension në marrëdhënie. Nga ky këndvështrim, respekti nuk është thjesht një sjellje formale apo etikë shoqërore, por një detyrim moral që mbron dinjitetin e familjes dhe ruan ekuilibrin e saj të brendshëm.

Një familje ku mungon respekti nuk mund të arrijë stabilitet të qëndrueshëm, pavarësisht dashurisë fillestare apo lidhjeve emocionale. Në këtë kontekst, jeta e Muhamedit a.s. përfaqëson modelin më të lartë të marrëdhënies bashkëshortore. Ai nuk e kufizonte dashurinë në deklarata verbale, por e shfaqte atë përmes veprave të përditshme: me butësi në komunikim, me kujdes ndaj nevojave të familjes dhe me pjesëmarrje aktive në jetën e shtëpisë.

Sjellja e tij tregonte se autoriteti në familje nuk nënkupton dominim, por përgjegjësi dhe shërbim. Shejh Muhamed Muteveli Sharavi thekson se dashuria dhe mëshira ndërmjet bashkëshortëve janë dhuratë hyjnore që duhet ruajtur me moral dhe devotshmëri, ndërsa Kadi Ijadi në “Esh

**Komunikimi
i mirë dhe
falja janë çelësat
që ruajnë
stabilitetin
e familjes në
kohë sprovash.**

Shifa” e përshkruan Pejgamberin a.s. si njëriun më të butë dhe më të drejtë në familjen e tij.

Pejgamberi a.s. ishte shembull i ekuilibrit mes dashurisë dhe drejtësisë, mes butësisë dhe përgjegjësisë. Ai i trajtonte bashkëshortet me dinjitet, dëgjonte mendimet e tyre dhe krijonte një atmosferë ku mbizotëronte qetësia dhe mirëkuptimi.

Ky model tregon se dashuria e vërtetë nuk është vetëm ndjenjë, por veprim i vazhdueshëm që ndërtohet çdo ditë përmes sjelljes së mirë dhe respektit të ndërsjellë. Prandaj, dashuria, mëshira dhe respekti nuk janë elemente të ndara, por një tërësi e pandashme që formon zemrën e jetës familjare.

Kur këto tri shtylla bashkohen, familja shndërrohet në një ambient të qëndrueshëm, të ngrohtë dhe të sigurt emocionalisht, ku bashkëshortët nuk jetojnë thjesht pranë njërit-tjetrit, por bashkë me njërit-tjetrin në kuptimin më të thellë të fjalës.^{12 13}

PËRGJEGJËSIA DHE KOMUNIKIMI FAMILJAR

Familja në Islam nuk është strukturë dominimi apo marrëdhënie e njëanshme autoriteti, por një sistem i ndërtuar mbi përgjegjësi të ndërsjella, bashkëpunim dhe mirëkuptim. Secili bashkëshort ka rolin dhe detyrën e caktuar, por qëllimi i përbashkët mbetet i njëjtë: ndërtimi i një jete të qetë, të qëndrueshme dhe të ekuilibruar.

Përgjegjësia në familje nënkupton vetëdijen se çdo veprim, fjalë dhe vendim ka ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e marrëdhënies. Nuk bëhet fjalë vetëm për detyra materiale apo praktike, por edhe për përgjegjësi emocionale dhe morale.

Një bashkëshort i përgjegjshëm kujdeset jo vetëm për nevojat fizike të familjes, por edhe për qetësinë shpirtërore dhe psikologjike të saj.¹⁴ Një nga sfidat më të mëdha të familjes moderne është dobësimi i komunikimit të shëndetshëm. Në shumë raste, konfliktet nuk lindin nga probleme të mëdha apo të pazgjidhshme, por nga mungesa e dialogut të hapur, mosshprehja e ndjenjave në kohën e duhur dhe keqkuptimet e vogla që nuk sqarohen. Kur këto neglizhohen, ato grumbullohen dhe shndërrohen në distancë emocionale.

Komunikimi i shëndetshëm nuk është thjesht shkëmbim fjalësh, por një proces i plotë emocional dhe psikologjik. Ai kërkon dëgjim aktiv, durim në përgjigje, respekt ndaj mendimit të tjetrit dhe aftësi për të shprehur ndjenjat pa

lënduar palën tjetër. Një fjalë e thënë në kohën e duhur mund të forcojë lidhjen, ndërsa një fjalë e pamatur mund të krijojë plagë afatgjatë.

Kur komunikimi funksionon si duhet, familja shndërrohet në një hapësirë emocionalisht të sigurt, ku secili anëtar ndihet i dëgjuar, i kuptuar dhe i respektuar. Kjo siguri emocionale është baza e stabilitetit familjar dhe ndikon drejtpërdrejt në edukimin e fëmijëve dhe në harmoninë e përgjithshme të shtëpisë.

Në këtë aspekt, Muhamed Gazali thekson se jeta familjare e Pejgamberit a.s. ishte model i komunikimit të shëndetshëm, ku mbizotëronin butësia, respekti dhe vëmendja ndaj ndjenjave të familjes.¹⁵

Edhe mendimtarët bashkëkohorë e theksojnë rëndësinë e dialogut si bazë të stabilitetit familjar. Kjo tregon se komunikimi në Islam nuk është thjesht një formalitet, por një pjesë përbërëse e moralit dhe edukatës së përditshme.

DURIMI DHE FALJA – ÇELËSA TË STABILITETIT FAMILJAR

Asnjë martesë nuk është e përjashtuar nga sfidat, vështirësitë dhe momentet e tensionit. Islami nuk synon ndërtimin e një familjeje ideale pa probleme, por një familje reale që di t'i përballojë ato me urtësi, pjekuri dhe maturi emocionale. Në këtë drejtim, edhe në literaturën islame, stabiliteti familjar lidhet ngushtë me mënyrën se si bashkëshortët i menaxhojnë krizat dhe reagimet e tyre emocionale.

Durimi (sabri) në jetën familjare nuk është thjesht një përmbajtje pasive ndaj situatave të vështira, por një aftësi aktive për të kontrolluar emocionet, për të menaxhuar zemërimin dhe për të shmangur marrjen e vendimeve të nxituara në momente tensioni. Ai kërkon vetëdije, disiplinë dhe forcë të brendshme.¹⁶ Në këtë kuptim, Imam Gazaliu e konsideron durimin si një nga elementet kryesore të edukimit moral të njeriut, veçanërisht në jetën familjare, ku sprovat janë pjesë e përditshmërisë.

Falja është një nga virtytet më të larta në marrëdhëniet njerëzore. Ajo nuk nënkupton dobësi, por përfaqëson forcë morale dhe pjekuri shpirtërore. Falja i jep familjes mundësinë të ecë përpara, duke mos lejuar që gabimet e përkohshme të shndërrohen në arsye për prishjen e përhershme të marrëdhënies.

Edhe shejh Muhamed Muteveli Sharavi thekson se falja është një nga mënyrat më të sigurta për të ruajtur dashurinë dhe qetësinë brenda familjes. Kur durimi dhe falja

Familja e fortë nuk ndërtohet mbi komoditetin, por mbi vlerat që i rezistojnë kohës.

bashkohen, ato krijojnë një klimë të shëndetshme familjare, ku konfliktet nuk përshkallëzohen, por trajtohen me qetësi dhe përmes dialogut. Në një ambient të tillë, bashkëshortët mësojnë ta kuptojnë njëri-tjetrin më thellë dhe të jenë më tolerantë ndaj dobësive njerëzore.

Në të njëjtën frymë, edhe Jusuf el Karadavi thekson rëndësinë e kulturës së faljes si bazë për stabilitetin e marrëdhënieve bashkëshortore.¹⁷ Në këtë mënyrë, sabri dhe falja nuk mbeten vetëm vlera individuale, por shndërrohen në mekanizma praktikë që ruajnë ekuilibrin familjar dhe parandalojnë përshkallëzimin e konflikteve, ashtu siç e thekson edhe Vehbe Zuhejli në analizat e tij mbi familjen dhe shoqërinë.^{18 19}

SFIDAT E FAMILJES NË KOHËN MODERNE

Familja bashkëkohore përballet me sfida të shumta në kushtet e zhvillimeve të shpejta sociale, kulturore dhe teknologjike. Një nga ndikimet më të mëdha është zhvillimi i teknologjisë dhe i rrjeteve sociale, të cilat, ndonëse kanë sjellë lehtësira në komunikim, shpesh kanë ndikuar në dobësimin e komunikimit të drejtpërdrejtë brenda familjes. Shumë familje sot përballen me mungesën e kohës cilësore për të qëndruar së bashku. Angazhimet e shumta profesionale, stresi i përditshëm dhe ritmi i shpejtë i jetës kanë



bërë që bashkëshortët të kalojnë më pak kohë në dialog dhe të përjetojnë më shumë distancë emocionale. Kjo mungesë kohe shpesh krijon keqkuptime dhe largim mes tyre.

Një tjetër sfidë e rëndësishme është përhapja e individualizmit ekstrem, ku lumturia personale vendoset mbi përgjegjësitë familjare. Në këtë qasje, martesë shihet shpesh si mjet për kënaqësi individuale dhe jo si angazhim i përbashkët afatgjatë, gjë që e bën atë më të brishtë dhe më të ekspozuar ndaj shturjes. Në këtë kontekst, dietari bashkëkohor Jusuf el Karadavi thekson se një nga gabimet e mendësisë moderne është reduktimi i martesës vetëm në kënaqësi personale, duke harruar dimensionin e saj moral, familjar dhe shoqëror. Sipas tij, kur martesë ndahet nga përgjegjësi dhe vlerat etike, ajo humbet stabilitetin dhe kthehet në një lidhje të brishtë dhe të përkohshme.

Gjithashtu, pritshmëritë jorealiste për martesën, të ushqyera nga media dhe kultura moderne, shpesh krijojnë zhgënjim kur përballen me realitetin e jetës së përditshme, e cila kërkon durim, sakrificë dhe kompromis. Për këtë arsye, rikthimi te vlerat islame të familjes nuk është vetëm një çështje fetare, por një nevojë reale shoqërore. Këto vlera ofrojnë një model të ekuilibruar të jetës familjare, ku përgjegjësi, dashuria dhe morali ndërthuren për të krijuar stabilitet afatgjatë.^{20 21}

PËRFUNDIMI

Martesa në Islam përfaqëson një institucion të ndërtuar mbi parime të qarta morale, shpirtërore dhe shoqërore, të cilat synojnë krijimin e një familjeje të qëndrueshme dhe të shëndetshme. Ajo nuk është thjesht një marrëdhënie formale ndërmjet dy individëve, por një lidhje e thellë e bazuar në përgjegjësi, besim dhe përkushtim të ndërsjellë, që ka për qëllim ndërtimin e një jete të përbashkët të karakterizuar nga qetësia dhe stabiliteti.

Në thelb, martesë në Islam mbështetet në katër shtylla kryesore: besimi dhe devotshmëria si themele shpirtërore; dashuria dhe mëshira si dimensione emocionale; përgjegjësi dhe komunikimi si strukturë funksionale e marrëdhënies; si dhe durimi dhe falja si garanci për vazhdimësinë e saj në kohë sfidash. Këto shtylla nuk janë të ndara nga njëra-tjetra, por janë të ndërlidhura në mënyrë të tillë që njëra e plotëson tjetrën dhe së bashku krijojnë ekuilibrin e jetës familjare.

Kur këto vlera zbatohen në mënyrë praktike në jetën e përditshme, familja shndërrohet në një ambient të qetë dhe të sigurt, ku mbizotërojnë mirëkuptimi, respekti dhe dashuria e ndërsjellë. Në një familje të tillë, bashkëshortët nuk jetojnë thjesht pranë njëri-tjetrit, por bashkëpunojnë në ndërtimin e një jete të përbashkët me një qëllim të qartë moral dhe shpirtëror.

Njëkohësisht, fëmijët që rriten në një mjedis të tillë formohen si individë më të ekuilibruar, më të përgjegjshëm dhe më të shëndetshëm emocionalisht e moralisht, duke reflektuar vlerat që kanë përjetuar në familje. Në të kundërt, kur këto parime mungojnë ose neglizhohen, familja humbet stabilitetin e saj natyror dhe bëhet më e brishtë përballë sfidave të jetës.

Mungesa e besimit, dobësimi i komunikimit, mungesa e respektit dhe mungesa e durimit shpesh çojnë në keqkuptime të vazhdueshme, tensione emocionale dhe, në fund, në shpërbërjen e lidhjes familjare. Kjo tregon se kriza e familjes nuk është vetëm rezultat i faktorëve të jashtëm, por edhe i dobësimit të vlerave të brendshme që e mbajnë atë të qëndrueshme.

Prandaj, rikthimi dhe përkushtimi ndaj këtyre parimeve nuk përfaqëson vetëm një ideal fetar, por një nevojë reale dhe të domosdoshme për shoqërinë bashkëkohore. Në një kohë kur familja përballlet me sfida të shumta, këto vlera ofrojnë një model të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm jetese, i cili garanton jo vetëm lumturinë e individit, por edhe stabilitetin e shoqërisë në tërësi.

- 1 Malik bin Nebi, *Shurut en Nehda*, (Bejrut: Dar el Fikr), f. 87-95.
- 2 Hamude Abdulati, *Hajkelu'l Usra fi'l Islam*, (Kajro: Darus Selam), f. 43.
- 3 Po aty.
- 4 Ebu Hamid el Gazali, *Ihja Ulum ed Din, Kitabu Adab en Nikah* (Bejrut: Dar el Marife), vëll. II, f. 30-45.
- 5 Po aty.
- 6 Kadi Ijad, *Esh Shifa bi Tarif Hukuk el Mustafa* (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmije), f. 231-240.
- 7 Vehbe ez Zuhejli, *El Fikh el Islami ve Edilletuhu* (Damask: Dar el Fikr), vëll. VII, f. 312-330.
- 8 Jusuf el Karadavi, *El Usra kema Juriduha el Islam* (Kajro: Mektebetu Vehbe), f. 45-60.
- 9 Muhamed et Tahir ibën Ashur, *Et Tahrir ve et Tenvir* (Tunis: Dar Sahnun), vëll. XXI, f. 54-60.
- 10 Ali es-Sabuni, *Safvetu et-Tefasir* (Bejrut: Dar el-Fikr), vëll. II, f. 210-215.
- 11 Mustafa Mahmud, *El Islam: Ma Huve* (Kajro: Dar esh Shuruk), f. 112-120.
- 12 Kadi Ijad, *Esh Shifa bi Tarif Hukuk el Mustafa* (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmije), f. 129-139.
- 13 Muhamed el Gazali, *Fikh es Sire* (Kajro: Dar esh Shuruk), f. 412-420.
- 14 Hamude Abdulati, *Hajkelu'l Usra fi'l Islam*, (Kajro Darus Selam), f. 211-238.
- 15 Muhamed el Gazali, *Fikh es Sire* (Kajro: Dar esh Shuruk), f. 412-420.
- 16 Muhamed Seid Ramadan el Buti, *Kubra el Jakinijjat el Kevnijje* (Damask: Dar el Fikr), f. 201-210.
- 17 Jusuf el Karadavi, *El Usra kema Juriduha el-Islam* (Kajro: Mektebetu Vehbe), f. 45-60.
- 18 Vehbe ez Zuhejli, *Et Tefsir el Munir* (Damask: Dar el Fikr), vëll. XXI, f. 72-80.
- 19 Muhamed Seid Ramadan el Buti, *Kubra el Jakinijjat el Kevnijje* (Damask: Dar el Fikr), f. 201-210.
- 20 Muhamed Seid Ramadan el Buti, *El Mer'etu bejne Tugjan en Nidham el Garbi ve Letaif et Teshri' er Rabbani* (Damask: Dar el Fikr), f. 98-115.
- 21 Hamude Abdulati, *Hajkelu'l Usra fi'l Islam*, (Kajro Darus Selam), f. 89.

Tabiinët – bashkëndërtuesit e hallkës së dytë të medhhebit hanefi

Dr. Muhamed Stublla

BAZAT HISTORIKE DHE METODOLOGJIKE TË MEDHHEBIT HANEFI

Njëra prej veçorive themelore të shpalljes së fundit dhe të Pejgamberit të fundit është universaliteti. Shpallja e fundit është e vlefshme për të gjitha kohërat dhe vendet. Për rrjedhojë, misioni i Muhamedit a.s. vazhdon edhe pas vdekjes së tij.

Një nga karakteristikat që e dallon këtë mision nga misionet e mëparshme është ruajtja dhe transmetimi i tij në mënyrë autentike, të saktë dhe pa lajthitje. Edhe pse pejgamberët para Muhamedit a.s. u dërguan njëri pas tjetrit, e në disa raste edhe në të njëjtën kohë, ndikimi i mësimave të tyre dhe vazhdimësia e tyre nuk morën përmasat që mori misioni i Muhamedit a.s. Një ndër faktorët kryesorë që e mundësoi këtë vazhdimësi ishte brezi i sahabëve, të cilët ofruan tërë aftësitë e tyre intelektuale,

kohën dhe përkushtimin e plotë për ruajtjen dhe transmetimin e mësimave hyjnore. Ata ishin dëshmitarë të drejtpërdrejtë të shpalljes, njohës të rrethanave të zbritjes së ajeteve, të objektivave të tyre, si dhe të shpjegimeve që Muhamedi a.s. u jepte atyre.

Ndër sahabët që kanë pasur ndikimin më të madh në formësimin e parimeve të medhhebit hanefi, pra të metodologjisë së tij në kuptimin dhe interpretimin e Islamit, veçohen: Abdullah ibën Mesudi, Ali ibën ebu Talibi, Omer ibën Hatabi dhe sahabë të tjerë. Pikërisht mendimet juridike, interpretimet dhe metodologjia e këtyre sahabëve përbëjnë bazën mbi të cilën u ndërtua metodologjia e medhhebit hanefi. Në këtë kuptim, medhhebi nuk duhet parë si një mendim individual i një juristi. Përkundrazi, ai përfaqëson sistemimin shkencor të kuptimeve dhe interpretimeve të transmetuara nga sahabët, të cilët i kishin marrë ato drejtpërdrejt nga Muhamedi a.s. Këto

Medhhebi hanefi nuk është mendimi i një njeriu, por vazhdimësia shkencore e trashëgimisë së sahabëve, muhadramëve dhe tabiinëve.



kuptime u transmetuan brez pas brezi, përmes një zinxhiri të pandërprerë dijetarësh, derisa morën formën shkencore dhe u konkretizuan në dispozita juridike, duke marrë formë të interpretimit teorik dhe të zbatimit praktik të Islamit.

Ky konkludim është i bazuar në studimet shkencore universitare, të cilat tregojnë se rreth 90% e qëndrimeve juridike të Abdullah ibën Mesudit, Ali ibën ebu Talibit dhe Omer ibën Hatabit janë qëndrime të medhhebit hanefi. Ky rezultat dëshmon se fillet intelektuale dhe metodologjike të medhhebit hanefi burojnë nga tradita juridike e sahabëve, nga brezi që u edukua drejtpërdrejt nga Muhamedi a.s.¹

Muhadramët janë ata që kanë jetuar në kohën e Pejgamberit a.s., por nuk patën mundësinë ta takonin atë. Ata dallohen nga sahabët për mungesën e privilegjit të shoqërimin me Pejgamberin Muhamed a.s. Megjithatë, ata ishin dijetarë, juristë dhe transmetues të shquar. Ndër më të njohurit prej tyre veçohen: Alkame ibën Kajsi, Esved ibën Jezidi, Mesruk ibën Exhdaë etj. Pra, ata së bashku me sahabët përbëjnë hallkën e parë në formësimin e mendësisë dhe metodologjisë juridike të medhhebit hanefi.²

Tabiinët, si brezi që u edukua nga sahabët, u dalluan për dijen e thellë, devotshmërinë dhe lidhjen e ngushtë me Kuranin dhe Sunetin. Shumë prej tyre, si Seid ibën Xhubejri, Ibrahim Nehaiu dhe Amir esh Shabiu, luajtën një rol vendimtar në zhvillimin e mendimit juridik, i cili më vonë do të njihej si medhhebi hanefi. Pra, tabiinët jo vetëm që ruajtën dhe transmetuan trashëgiminë shkencore të sahabëve dhe muhadramëve, por edhe e zhvilluan, e sistemuan dhe e pasuruan atë metodologji. Në këtë fazë, mendësia juridike që kishte filluar nga sahabët dhe muhadramët vazhdoi të marrë trajtë më të qartë shkencore, mbi të cilën do të ndërtohej dhe kristalizohej medhhebi hanefi.³

Forca e medhhebit hanefi qëndron në metodologjinë e tij, të ndërtuar mbi Kuranin, Sunetin, ixhmanë dhe kijasin.

Për rrjedhojë, medhhebi hanefi paraqet një metodologji të qëndrueshme juridike, të mbështetur në Kuranin, Sunetin, ixhman, kijasin dhe rregulla të tjera mbështetëse, të cilat u ndërtuan mbi kontributin shkencor të dijetarëve më të shquar të brezave të parë të Islamit. Për këtë arsye, medhhebi konsiderohet vazhdimësia më autentike e trashëgimisë së tabiinëve dhe sahabëve, që në formë shkencore përmbloodhi dhe harmonizoi Kuranin dhe Sunetin. Ndër përfaqësuesit më të shquar të gjeneratës së tabiinëve, bashkëthemelues të medhhebit hanefi dhe mësues të Ebu Hanifes, të cilët ishin vendimtarë në konsolidimin e medhhebit, veçojmë:

EL HAKEM IBËN UTEJBEH

El Hakem ibën Utejbëh,⁴ tabiin, dijetar shumë i shquar, jurist i dalluar dhe transmetues i një numri të madh hadithesh; ai njihej si një transmetues i besueshëm dhe i përpiktë. Pas vdekjes së imamatit të njohur, Amir esh Shabiut, zuri vendin e tij si autoriteti më i kompletuar në fushën e transmetimit dhe njohjes së hadithit. Kishte lindur në të njëjtin vit me Ibrahim Nehaiun, por jetoi rreth njëzet vjet më gjatë se ai dhe ndërroi jetë në vitin 115 h. Konsiderohej një nga tri autoritetet kryesore shkencore të Kufes. Gëzonte respekt të veçantë për devotshmërinë, integritetin dhe profesionalizmin e tij. Ishte gjithashtu një asket i dalluar. Sufjan Thevriu transmeton se imami i hadithit, Jahja ibën ebi Kethiri, i ka thënë: “Në këtë vend nuk ka njeri më të ditur dhe jurist më të mirë se Hakem ibën Utejbë”, ndonëse aty jetonin dijetarë të rangut të lartë, si Ata ibën ebi Rebahu dhe bashkëkohësit e tij.⁵ Dijetarët e këtij niveli, e veçanërisht në shkencën e hadithit, janë garanci për saktësinë, besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e hadithit në medhhebin hanefi, si dhe në trashëgiminë islame në përgjithësi.

HABIB IBËN EBI THABITI

Habib ibën ebi Thabiti, tabiin, njëri ndër tri personalitetet më të ditura dhe më të nderuara të Kufes; ishte ndër dijetarët, fetvaja e të cilëve kërkohej dhe pranohej nga mbarë besimtarët.⁶ Ai ishte jurist dhe myfti i njohur, i cili kishte takuar disa nga sahabët. Ishte transmetues i besueshëm dhe i përpiktë i haditheve. Prej tij janë transmetuar dhe regjistruar qindra hadithe, shumë prej të cilave gjenden në koleksionet më të njohura të hadithit. Ndërroi jetë në vitin 119 h.⁷ Fama e tij në aspektin profesional dhe shpirtëror, në një ambient të jashtëzakonshëm fetar, tregon se sa e pasur është kjo shkollë juridike me dijetarë, të cilët jo vetëm që nderohen dhe vlerësohen brenda medhhebit, por edhe çmohen nga të tjerët.



ALKAMEH BIN MURTHID EL HADRAMIJU

Alkameh bin Murthid el Hadramiju, tabiin⁸, transmetues shumë i besueshëm dhe i përpiktë, transmetimet e të cilit gjenden në gjashtë koleksionet e njohura të hadithit, por edhe në burime të tjera të rëndësishme.⁹ Dijetar dhe jurist i shquar; ai kishte takuar dhe transmetuar hadithe nga shumë sahabë. Ishte ndër transmetuesit më të përpiktë dhe më të saktë në transmetime. Nëse një çështje i nënshtrohej ixhtihadit të Alkame ibën Murthidit, përfundimi i tij konsiderohej argument i mjaftueshëm për t'u pranuar si mendim i drejtë, në përputhje me Kuranin dhe Sunetin. Vdiq në vitin 120 h.¹⁰ Madhështia e medhhebit dëshmohej përmes arritjeve të këtyre dijetarëve të mëdhenj. Cila rrugë mund ta përfaqësojë, transmetojë dhe paraqesë fenë me një përpikëri si kjo?! Asnjë. Medhhebi është rruga e drejtë, e të vërtetës.

HAMAD IBËN EBU SULEJMANI

Hamad ibën ebu Sulejmani ishte tabiin. Ndër sahabët që kishte takuar dhe prej të cilëve kishte transmetuar ishte shërbyesi i të Dërguarit të Allahut a.s., Enes ibën Maliku. Ndërsa ndër tabiinët më të njohur, nga i cili përfitoi dhe mori më së shumti nga dituria e tij, ishte Imam Ibrahim Nehaiu, tabiiu dhe dijetari më i ditur i kohës së tij. Ai shkruante dhe mësonte gjithçka që vinte prej tij. Kur Ibrahim Nehaiu u pyet: “Kur të vdesësh, te kush të drejtohem?”, ai u përgjigj: “Te Hamadi.” Kjo ishte një dëshmi e vlerësimit të lartë për Imam Hamadin, njësoj sikurse Pejgamberi a.s. që e kishte udhëzuar atë që e kishte pyetur: “Nëse të kërkoj dhe nuk të gjej, kujt t'i drejtohem?”, ai i tha: “Tek Ebu Bekri”, për shkak të pozitës së tij të lartë dhe epërsisë së tij ndër sahabët. Në të njëjtën mënyrë, Ibrahim Nehaiu e veçoi Hamadin si një nga dijetarët më të ditur pas tij. Imam Hamadi kujdesej shumë për nevojtarët dhe ishte një asket i madh. Njëri prej familjarëve të tij tregon se Mus'hafi i tij kishte shenja të lotëve të tij, gjë që dëshmonte se ai e lexonte Kuranin me meditim të thellë dhe ndikohej fuqishëm prej tij.¹¹ Ishte dijetar i shquar. Ibën Shubrumeh ka thënë: “Nuk më ka bindur askush me dijen e tij sikurse më ka bindur Hamadi.” Ai ka transmetuar shumë hadithe. Dijetari Ibën Meini ka thënë për të: “Është i besueshëm dhe i përpiktë.” Në transmetimet e njohura të Shubes përmendet se ai ishte i drejtë dhe i pranuar. Ishte specialist dhe i dalluar në transmetimin e haditheve nga Ibrahim Nehaiu.¹² Vlerësime të ngjashme për Imam Hamadin kanë dhënë pothuajse të gjithë dijetarët islamë. Dyshimet ose disa pretendime lidhur me mospërpikërinë e tij në transmetimin e haditheve rrëzohen nga konsensusi i dijetarëve të Kufes, të cilët, me kërkesën dhe insistimin e tyre, e caktuan Imam Hamadin prijës fetar të Kufes për ta zëvendësuar Ibrahim Nehaiun pas vdekjes së tij. Prandaj,

**Ebu Hanifja
nuk e shpiku
medhhebin
hanefi; ai e
konsolidoi,
e sistemoi dhe
e përhap
trashëgiminë
juridike që
kishte marrë
nga mësuesit
e tij.**

pretendime të tilla konsiderohen të izoluara dhe nuk mund të qëndrojnë përballë vlerësimit unanim të autoriteteve të hadithit,¹³ të cilët ishin bashkëkohanikë dhe njohësit më të mirë të tij. Edhe më i veçantë është fakti se Imam Hamadi ishte mësuesi kryesor dhe i pazëvendësueshëm i Imamit të Madh, Ebu Hanifes. Për këtë është thënë: “Nuk është njohur që dikush ta ketë shoqëruar mësuesin e tij ashtu siç Ebu Hanifja e shoqëroi Hamadin.” Kjo dëshmon për përkushtimin e jashtëzakonshëm të Ebu Hanifes ndaj mësuesit të tij dhe ndikimin e madh që Imam Hamadi pati në formimin e tij shkencor. Një dijetar me një formim kaq të plotë ishte e natyrshme të nxirrte nxënës dhe dijetarë të jashtëzakonshëm, siç ishte Imami i Madh, Ebu Hanife. Imam Hamadi ndërroi jetë në vitin 120 h.¹⁴ Prandaj, është e qartë se Ebu Hanifja nuk e shpiku medhhebin hanefi,

por e trashëgoi atë nga mësuesit dhe paraardhësit e tij. Kontributi i tij konsistoi në konsolidimin, detajimin, kristalizimin, plotësimin dhe shpërndarjen e kësaj trashëgimie juridike, duke i dhënë asaj formën e plotë dhe të qëndrueshme me të cilën njihet edhe sot.

OTHMAN IBËN ASIM IBËN HUSEJNI

Othman ibën Asim ibën Husejni ishte tabiin nga Kufja. Ai transmetoi hadithe nga disa sahabë dhe nga shumë dijetarë të shquar të tabiinëve, ndërsa numri i dijetarëve që mësuan dhe transmetuan prej tij ishte shumë i madh. Ishte kërkuar i përkushtuar i dërguarit, i devotshëm, modest, bujar dhe kontribuues i vazhdueshëm në përhapjen e dijes. Në shkencën e hadithit njihej si një ndër transmetuesit më të besueshëm dhe më të përpiktë. Edhe pse Kufja ishte një qendër e njohur e dijes dhe e dijetarëve, ai arriti të dallohej me personalitetin dhe autoritetin e tij shkencor. Imami i hadithit, Shube ibën Haxhaxhi, ka thënë: “Ai ishte prej shokëve tanë”, duke nënkuptuar se ishte prej dijetarëve të nivelit dhe metodologjisë së tyre. Gjithashtu, ai thoshte: “Ishte njeri i mirë, besnik dhe i përpiktë.” Vlerësime të larta për të kanë dhënë edhe shumë dijetarë të tjerë të kohës së tij. Në të vërtetë, dëshmia më e fortë për pozitën e një dijetari ose transmetuesi është vlerësimi i bashkëkohësve të tij, të cilët e kanë njohur nga afër dhe gjykojnë drejt për dijen dhe besueshmërinë e tij. Ndër dëshmitë më domethënëse është ajo e hafëzit dhe imamit të shquar, Ibën Mehdiut, i cili ka thënë: “Nuk do të gjesht asnjë hafëz të hadithit që të mos e pranojë dhe ta vlerësojë Ibën Husejnin.” Ai ndërroi jetë në vitin 127 h.¹⁵

MEABED IBËN HALID EL XHEDELIU

Meabed ibën Halid el Xhedeliu ishte tabiin nga Kufja. Ai ka transmetuar hadithe nga një grup sahabësh;¹⁶ Ibën Halidi ishte adhurues i përkushtuar i Allahut të Lartësuar

dhe i njohur për devotshmërinë e tij. Ai dallohej për qëndrimin e gjatë në namazin e natës; kur e fillonte, nuk e ndërpriste deri në namazin e sabahut. Në shkencën e hadithit konsiderohej ndër transmetuesit më të besueshëm dhe më të përpiktë. Të gjithë autorët e gjashtë koleksioneve të njohura të hadithit kanë transmetuar hadithe përmes tij. Ai shquhej për diturinë e gjerë, jo vetëm në shkencat fetare dhe në hadith, por edhe në gjeografi, histori të popujve, fiseve dhe fusha të tjera të dijes. Ndërroi jetë në vitin 118 h.¹⁷ Ky është një shembull që hedh poshtë pretendimin se dijetarët e hershëm nuk i njihnin shkencat e tjera. Përkundrazi, shumë prej tyre ishin njohës të mirë jo vetëm të shkencave fetare islame, por edhe të shkencave të tjera. Tek ata bashkoheshin devotshmëria dhe dituria, një virtut që nuk gjendet lehtë në kohën tonë.

XHAMIU BIN SHEDAD EL MUHARIB

Xhamiu bin Shedad el Muharib, tabiin.¹⁸ Për të mos e zgjatur, do të mjaftohem me përshkrimin që Imami el Ixhliu i bën, i cili thotë: “Ishte imam i shquar dhe i besueshëm, shejh i urtë, transmetues i besueshëm dhe i përpiktë, i sprovuar në qëndrueshmërinë e tij dhe i palëkundur.”¹⁹ Ndërroi jetë në vitin 128 h.²⁰

LEGJITIMITETI SHKENCOR I MEDHHEBIT HANEFI

Besimtari duhet të kërkojë të vërtetën dhe nuk lejohet të jetë fanatik apo i verbër përballë argumenteve. Nëse i analizojmë temat e trajtuara në “Diturinë Islame”: “Sahabët – hallka e parë në themelimin e medhhebit hanefi”, “Muhadramët – bashkëthemelues të hallkës së parë të medhhebit hanefi”, “Tabiinët – hallka e dytë e ndërtimit të shkollës juridike hanefite” dhe “Tabiinët – bashkëndertuesit e hallkës së dytë të medhhebit hanefi”, do të kuptojmë qartë se sa të mëdhenj ishin dijetarët e kësaj shkolle në njohjen, transmetimin dhe kuptimin e haditheve. Njeriu i ditur dhe i sinqertë nuk mund të akuzojë apo të pretendojë se medhebi hanefi nuk e njeh ose nuk e respekton hadithin. Përkundrazi, medhebi përfaqëson formën më të plotë të ruajtjes dhe përcjelljes së mësimave, synimeve dhe praktikës së Pejgamberit a.s. Pra, nuk është rastësi që dijetarët ndër shekuj, në mënyrë unanime, kanë pranuar dhe kanë dëshmuar për besueshmërinë e transmetuesve dhe themeluesve të kësaj shkolle.

Tani, pasi kemi përfunduar paraqitjen e gjeneratës së mësimave të Ebu Hanifes, radha është të kalojmë në një etapë tjetër, atë të Ebu Hanifes dhe shokëve të tij. Edhe pse Ebu Hanifa është figurë qendrore dhe jashtëzakonisht e rëndësishme në medhebin hanefi, ai nuk përfaqëson i vetëm të gjithë medhebin. Prandaj, duhet të trajtohet roli

Kush pason medhebin, ndjek Kuranin dhe Sunetin e kuptuar përmes metodologjisë së brezave më të mirë të Islamit.

i kësaj gjenerate në konsolidimin, klasikimin, detajimin, formësimin final shkencor të medhhebit, si dhe në shkrimin e tij. Prandaj, sot nuk diskutohet më për zinxhirin e transmetimit, sepse ai tashmë është i përfunduar, njësoj siç nuk vihet më në diskutim saktësia e librave të hadithit pas përfundimit dhe pranimi të tyre nga ymeti. Ajo që studiohet është metodologjia, mënyra e përzgjedhjes së argumenteve dhe shtrirja e medhhebit. Në mexhlin e Imam Ebu Hanifes është ndërtuar korniza mbi të cilën kuptohet, zhvillohet dhe do të vazhdojë të kuptohet Islami. Ky rezultat është i pranishëm edhe sot, me bekimin e Zotit, të Pejgamberit a.s. dhe me konsensusin e dijetarëve ndër shekuj.

Përfundim: Kush pason medhebin, e pason Kuranin dhe Sunetin e studiuar, të cilët asnjëherë nuk e kundërshtojnë njëri-tjetrin. Ai që nuk e pason medhebin, është larguar nga praktika e mirëfilltë shkencore islame.

- 1 Shih: “Dituria Islame”, Sahabët – hallka e parë në themelimin e medhhebit hanefi, f. 14.
- 2 Shih: “Dituria Islame”, Muhadramët, bashkëthemelues të hallkës së parë të medhhebit hanefi, f. 24.
- 3 Shih: “Dituria Islame”, Tabiinët – hallka e dytë e ndërtimit të shkollës juridike hanefite, f. 17.
- 4 Është thënë emri i tij është Ujejne, por e vërteta është Utejb.
- 5 El Baxhi, Sulejman ibën Halef, Et Tadiil ve et Texhrih limen harxh lhu el Buhari fi el Xhamia es Sahih, (Riad, Dar el Livae Linesher ve et Tevzië, 1986) 2/569.
- 6 Ibën es Sead, Et Tabekat el Kubra, 6/316.
- 7 Ibën Haxher, Shihabuddin, Tehdhib et Tehdhib, (Indi, Hajdar Abad ed Deken, Dairatu el Mearif en Nidhamijeh 1327 h.) 2/178-180.
- 8 Ibën es Sead, Et Tabekat el Kubra, 6/323. Vëmendje: Ibën Seadi, e vendos nënë kategorinë e tretë, që janë tabiinët, gjithëherë sipas metodologjisë së tij të shkrimit të librit.
- 9 El Mizij, Xhemaluddin, Tehdhib el Kemal fi Esmae err Rrixhal, (Bejrut, Muesesetu err Rrisaleh, 1992), 20/309-311.
- 10 Edh Dhehbij, Shemsudin, Sijer Ealam en Nubela, (Bejrut, Muesesetu err Rrisaleh, 1996), 5/206.
- 11 Ibën es Sead, Et Tabekat el Kubra, 6/324-325.
- 12 Ibën Adij, Ebu Ahmed, El Kamil fi ed Duafai err Rrixhal, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1997), 3/5-7.
- 13 Ebu Shejh el Asbehani, Tabekat el Muhadithin bi Asbehan ve el Varidine Alejha, 1/327-330.
- 14 Ibën es Sead, Et Tabekat el Kubra, 6/325.
- 15 Shih: Ibën Asakir, Alij ibën el Hasen, Terih Medinetu Dimeshk, (Dar el Fiker Litbah ve en Nesher ve et Tevzië, 1995), 38/397-418.
- 16 Ibën Hiban, Muhamed ibën Hiban, Eth Thikat, (Indi, Vizareh el Mearif Ilihukumeh el Alije el Hindijeh, 1973), 5/434.
- 17 Edh Dhehbij, Shemsudin, Tehdhib el Kemal fi Esmae err Rrixhal, (Bejrut, Mesesetu err Rrisaleh, 1992) 28/229-233.
- 18 Ibën es Sead, Et Tabekat el Kubra, 6/315.
- 19 El Ixhlij, Ahmed ibën Abdullah, Mearifetu eth Thikat min Rrixhal Ehl el Ilm ve el Hadith ve min ed Duafa ve Dhikr Medhehibihim ve Ahbarihim, i njohur: Eth Thikat, (Saudi, Medine, Mektebu ed Dar, 1958), 1/94.
- 20 Mugletaj, Alauddin, Ikmal Tehdhib el Kemal fi Esmae err Rrixhal, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2011), 2/68.

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (10)

VEPRA “EL VIKAJEH” ME AUTOR MAHMUD BURHANUSHERIATIN

Hazir D. Selmani

Para pushtimit dhe shkatërrimit mongol, në Buharën e shekullit VII hixhri jetoi një familje e shquar buharase. Kjo familje njihet si El Mehbubi. Druri gjenealogjik i tyre shkon deri te sahabiu Ubade bin Samiti r.a. Nga gjiri i saj dolën shumë personalitete të mëdha në fushën e fikhut hanefi dhe prej tyre u shkruan disa nga librat më të rëndësishëm të këtij medhhebi. Njëri prej dijetarëve më të shquar të kësaj familjeje ishte Mahmudi, i njohur diku si Burhanusheriati e diku si Taxhusheriati. Megjithëse libri i tij ishte njëri ndër më të studiuarit dhe më të përhapurit, përsëri për jetën e tij dhe të dijetarëve të tjerë të familjes El Mehbubi nuk dihet shumë. Edhe ajo pak që dihet ka disa mospërputhje në renditjen e emrave dhe të titujve të nderit që gëzonin këta dijetarë, si dhe në atë se kush ishte biri i kujt dhe autor i cilit libër.

KUSH ËSHTË MAHMUD BURHANUSHERIATI?

Ai ishte dijetar, biri i dijetarit dhe nipi i dijetarit. Pastaj, vëllai i dijetarit dhe, më vonë, u bë edhe gjyshi i dijetarit ose, më konkretisht, Mahmud Burhanusheriati bin Ahmed Sadrusheriati bin Xhemal Ubejdilah bin Ibrahim el Mehbubi el Ubadij el Buhari el Kermani. Stërgjyshi i kësaj familjeje është Xhemal Ubejdullah bin Ibrahim el Mehbubi (546–630 hixhri), i cili njihej si Ebu Hanifeja i Dytë. Ai pas vetes la një djalë dijetar me emrin Ahmed. Tani, Ahmed, i biri i Ubejdullahut, u njoh si Sadrusheriati i Madh ose si Sadrusheriati i Parë (vd. 640 hixhri) dhe pati dy djem dijetarë: i pari është Omer Taxhusheriati (vd. pas vitit 695 hixhri), ndërsa i dyti është Mahmud Burhanusheriati

El Vikajeh’ është një nga katër doracakët më autoritativë të medhhebit hanefi dhe ndër veprat më të studiuar në historinë e tij.




(vd. 672–673 hixhri). Në mesin e dijetarëve ka mospajtime se cili prej këtyre dy vëllezërve e shkroi realisht veprën “El Vikajeh”, Omeri apo Mahmudi!? Edhe pse më e sigurt është se autori ishte Mahmudi. Pastaj, ka mospajtime për titullin e nderit që gëzonte Mahmudi në fjalë: a ishte ai Mahmud Taxhusheriat apo Mahmud Burhanusheriat? Në burime dhe botime haset herë në formën e parë e herë në formën e dytë. Hapësira e kufizuar e këtij studimi pamundëson zgjerimin e mëtejshëm në këtë aspekt, edhe pse është një mesele mjaft e koklavitur dhe nuk luan fare rol në rëndësinë dhe peshën e doracakut. Shumë bukur shprehet Lekneviu në përfundim të këtij diskutimi të gjatë, kur thotë: “Në këtë çështje kanë rrëshqitur këmbët e dijetarëve të mëdhenj dhe janë kundërshtuar pendët e figurave të shquara.”¹ Në thelb kjo që u ofrua më sipër është ajka e asaj që e ofron kadiu dhe historiani i shquar osman Edirneviu,² pastaj dr. El Omer në recensimin e “Dhehiratu’l-Ukba” dhe para tij dr. Salahu në recenzimin e “Sherhu’l-Vikajeh”.³ Nisur nga kjo, në këtë studim jemi përcaktuar për formën e dytë (Burhanusheriat). Madje, më vonë, edhe vetë nipi i tij, Sadrusheriat i Ri (i Dytë ose i Vogli), do të shprehet kështu: “... gjyshi im dhe mësuesi im, dijetari i edukuar në dijen hyjnore dhe praktikuesi i devotshëm, Burhani i shariatit, i hakut e i dinit, trashëguesi i (dijes së) pejgamberëve dhe nebijve, Mahmudi, i biri i Sadrusheriatit, ...

Mahmud Burhanusheriat
e shkroi
‘El Vikajeh’
posaçërisht
që nipi i tij ta
mësonte dhe
ta memorizonte
më lehtë
fikhun hanefi.

hartoi për hifzin tim librin Vikajetu’r-Rivajeh fi Mesaili’l-Hidajeh...”⁴ Ky tekst tregon se autori i “El Vikajeh” quhet Mahmud, njihej si Burhanusheriat dhe ishte gjyshi i Sadrusheriatit të Ri (vd. 747 hixhri), si dhe se doracakun në fjalë e shkroi pikërisht për këtë nip të tij. Nipi në fjalë, realisht, i kishte që të dy gjyshërit: Sadrusheriatin nga ana e babait dhe Burhanusheriatin nga ana e nënës. Nipi, Sadrusheriat i Ri, më vonë u bë personaliteti më i rëndësishëm i kohës për medhhebin hanefi. Disa nga veprat e tij u kthyen në doracakët më të rëndësishëm në fikhun, usulin dhe akiden hanefito-maturidite.

Mësimet i mori nga babai i tij, alamet dijetari hanefi Ahmed Sadrusheriat i Madh (i Parë), i cili ishte autori i veprës usulore Tenkihu’l-ukul (Telkihu’l-ukul) fi furuki’l-menkul.⁵ Mësues të tjerë të tij nuk dihen, edhe pse besohet, për shkak të pozitës së lakmueshme familjare, se ai ka pasur shumë të tillë. Njësoj, nuk përmenden as nxënësit e tij, me përjashtim të nipit, Ubejdullah Sadrusheriat i Ri, edhe pse në fund të jetës dihet se punoi në një medrese të famshme të Kermanit. Kjo varfëri informacionesh për këtë brez dijetarësh të trojeve të Transoksanës (ar.: Maveraenehër) shpjegohet me faktin se brezi i tyre përjetoi pushtimin famëkeq mongol me djegie e shkatërrim qytetesh, vrasje e përdhunime, rrënim medresesh e xhamish, si dhe shkatërrim librash e djegie qytetesh e qendrash të dijes



islame, kështu që shumica e asaj që ishte shkruar në ato troje u humb dhe figurat që mbetën gjallë nuk gjetën më fuqinë për të shkruar për jetën dhe veprimtarinë e këtij brezi të vuajtur dijetarësh. Pas pushtimit mongol, ai, së bashku me familjen e tij, u shpërngul në Kerman. Këtu punoi si mësimdhënës në medresenë e famshme sulltanore El Kutbijeh, derisa vdiq në vitin 673 hixhri dhe u varros në Kerman.⁶ Burhanusheriati nuk pati më fatin të kthehej në vendlindjen e tij, të baballarëve dhe të stërgjyshërve të tij. Rreth dy vjet më vonë, pra në vitin 675 hixhri, në Kerman vajti edhe vëllai tjetër Omer Taxhusheriati.⁷ Ky i fundit, këtu me sa duket, pati incidentin me Ebu'l Berakat Nesefiun mbi komentin e “El Hidajes”, që çoi në shkrimin e të paktën tre veprave autoriale të Nesefiut.⁸

VEPRAT E BURHANUSHERIATIT

Mahmud Burhanusheriati pas vetes nuk la një numër të madh veprash. Ajo që dihet është se ai shkroi veprën famëmadhe “El Vikajeh”. Pastaj thuhet se shkroi edhe veprën “El Fetava ve'l Vakiaat”, si dhe në disa burime këtij i atribuohet komenti i “El Hidajes” me titull “Nihajetu'l-Kifajeh”. Mirëpo, ajo që dihet është se komenti i Hidajes me titull “Nihajetu'l-Kifajeh” është i vëllait të tij, Omer Taxhusheriati. Ndërsa, “El Fetava ve'l Vakiat” herë i atribuohet vëllait, e herë Burhanusheriati.⁹

DORACAKU FIKHOR “EL VIKAJEH”

Mbi doracakun-koment “El Hidajeh”, krahas shumë komenteve, u shkruan edhe disa versione të shkurtuara të tij. Numri i këtyre muhtesarëve shkon deri në 10 sosh. Njëri prej tyre, madje edhe më i famshmi dhe më i rëndësishmi, është doracaku “El Vikajeh”. Emri i plotë i tij është “Vikajetu'r-Rivajeh fi Mesaili'l-Hidajeh” (shq.: Ruajtja e transmetimeve të meseleve të “El Hidajes”). Ky libër u shkrua nga gjyshi për nipin, siç u pa më lart, që nipi ta memorizonte sa më lehtë materialin e “El Hidajes”. Prandaj, për nga numri i kapitujve dhe renditja, vepra “El Vikajeh” është njësoj si vepra “El Hidaje”. Të dyjave u mungon kapitulli i trashëgimisë. Doracaku “El Vikajeh”, për nga teksti, është shumë më i shkurtër se “El Hidajeh”, afërsisht sa çereku i saj, ndërsa pak më i madh se doracaku “Bidajetu'l-Mubtedij”. Krahas përmbledhjes së tekstit, edhe disa tituj kapitujsh në “El Vikajeh” janë shkruar me disa

Mbi ‘El Vikajeh’ janë shkruar mbi dyzet komente, gjë që dëshmon rëndësinë dhe ndikimin e jashtëzakonshëm të kësaj vepre në traditën juridike hanefite.

ndryshime. Si doracak, është më i ndërlikuar edhe se vetë “El Hidajeh”, për shkak se në thelb ai nuk u shkrua që të ishte më i qartë, por që të ishte sa më i lehtë për hifz (shq.: memorizim). U shkrua me sa më pak fjalë e fjali dhe në të duhej të përfshihej i tërë materiali i “El Hidajes”. “El Vikajeh”, për një kohë të shkurtër, u popullarizua tej mase dhe u përhap në të gjitha trojet ku ishte shtrirë medhhebi hanefi, sidomos në Perandorinë Osmane. Vepra “El Vikajeh” ka qenë pjesë e programit të shumë medreseve tradicionale islame dhe vijon akoma të jetë, sidomos në subkontinentin indian dhe në shumë shtete aziatike të ish-Bashkimit Sovjetik. Në Turqi pritët të bëhet pjesë e programit të nivelit të specializimit në fikh edhe në zinxhirin e medreseve të Ismailagës. Mbi këtë vepër disa herë u shkruan shkurtime të tjera (muhtesarë) dhe njëri prej tyre është muhtesari i vetë nipit të autorit, i njohur me titullin “El Nukajeh”, për të cilin do të flitet në një shkrim të veçantë – në dashtë Allahu. Tani për tani, vepra “El Vikajeh” është e përkthyer në osmanlisht, edhe atë që nga koha e sulltan Muratit II. Pastaj është përkthyer edhe në persisht, urdisht, turqishten e Kazanit, turqishten bashkëkohore dhe rusisht. Në gjuhën shqipe, deri më tani, nuk ka asgjë të përkthyer prej saj, edhe pse hoxhallarët e shekullit të kaluar e kanë njohur këtë vepër dhe kjo gjë dëshmohej me dorëshkrimet e vjetra që aty-këtu hasen nëpër bibliotekat private familjare të këtyre hoxhallarëve. Edhe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të

Kosovës ka disa dorëshkrime.¹⁰ Mbi “El Vikajeh” janë shkruar edhe disa libra kritikë që synonin të ofronin një tekst më preciz fikhor të saj, siç bëri Ibën Kemal Pasha në veprën e tij “El Islah” (Islahu'l-Vikajeh, shq.: Ndreqja e El Vikajeh), por që për këtë hap të tij hasi në kundërshtime të mëdha, sidomos nga Birgivi dhe shumë të tjerë. Deri më tani ka pasur disa botime dhe më të vjetrat janë ato që janë botuar në Kazan-Tataristan. Kjo vepër ka shumë dorëshkrime nëpër bibliotekat e botës islame, sidomos në trojet ku ishte dhe është i shtrirë medhhebi hanefi. Për nga rëndësia e madhe medhhebore, kjo vepër dhe ky doracak bëjnë pjesë në mesin e Katër Doracakëve me konsideratën më të lartë medhhebore, ku bëjnë pjesë: “El Vikajeh”, “Kenzu'd-Dekaik”, “Mexhmeu'l-Behrajn” dhe “El Muhtar”.¹¹

KOMENTET E DORACAKUT FIKHOR “EL VIKAJEH”

“El Vikajeh”, njëjtë sikur edhe doracakët e tjerë fikhorë, nuk është vepër edhe aq e lehtë për t’u zbërthyer plotësisht pa iu referuar komenteve të saj, ngase qëllimi i përpilimit të doracakëve nuk ishte thjeshtësia dhe detajizimi, por përmbledhja e tërë fikhut me pak fjalë dhe në sa më pak fletë. Për shkak se ky doracak ishte libër mësimor në mexhliset klasike islame të hoxhallarëve, si dhe libër medreseje në shumë medrese, kjo gjë solli një numër të madh komentesh që janë shkruar rreth tij. Numri i veprave shpjeguese mbi këtë doracak shkon mbi 40,¹² e që i bie të llogaritet në mesin e doracakëve më të komentuar të fikhut hanefi. Këtu nuk përfshihen komentet në gjuhën urdisht. Këtu do të renditen dhjetë librat shpjegues më të njohur që janë shkruar mbi këtë doracak:

1. “Sherhu’l-Vikajeh”, me autor Sadrusheriatin e Dytë (vd. 747 hixhri), për të cilin u shkrua vetë “El Vikajeh”. Ky është komenti i parë dhe madje edhe më i rëndësishmi i “El Vikajeh”. Pastaj, mbi këtë libër të botuar disa herë dhe tejet të përhapur si dorëshkrim, u shkrua numri më i madh i librave të llojit mbikoment në tërë historinë e medhhebit hanefi. Si libër, është i botuar në dy vëllime. Prej kësaj vepra ka të paktën 3 kopje dorëshkrimore në Bibliotekën e BIK-ut¹³ dhe kjo gjë tregon shumë për nivelin e hoxhallarëve të vjetër shqiptar.

2. “El Inajeh fi sherhi’l Vikajeh”, dorëshkrim me autor Alaudin el Esvedin (vd. 800 hixhri), i njohur edhe si Karahisari ose Kara Hoxha. Këtë libër e shkroi si myderriz në Medresenë e Iznikut.

3. “El Istigna”, dorëshkrim i Alaudin Tarabulusit (vd. 849 hixhri). Ky koment ndryshe njihet edhe si El Keusexhijeh.

4. “Sherhu’l Vikajeh”, me autor Ibën Melekun (vd. 854 hixhri). Fillimisht, babai Abduletif ibën Meleku (vd. 801 hixhri) shkroi një koment për t’ia mësuar njërit prej djemve të tij fikhun hanefi. Drafti përfundimtar i këtij komenti u humb. Vite më vonë, djali tjetër i tij, Muhamed ibën Meleku (vd. 854 hixhri), duke mos dashur të humbiste shpjegimin e babait, mblodhi skicat dhe draftet fillestare të komentit të babait dhe shkroi komentin që ne sot e njohim të “El Vikajes”. Ky koment, i botuar në katër vëllime të mëdha, i atribuohet babait, edhe pse realisht autori i tij është i biri.

5. “Sherhu’l Vikajeh”, dorëshkrim me autor Ali Heravi Razi, i njohur si Musannifek (vd. 875 hixhri). Pasardhës i Fahrudin Raziut. Pjesëmarrës në fushatën boshnjake të sulltan Mehmet Fatihut në vitin 1463. Edhe ky dorëshkrim llogaritet si njëri ndër komentet më të zgjeruara të “El Vikajes”.

6. “El Isharah ve’r-ramz ila tahkiki’l-Vikajeh”, dorëshkrim i Abdalberr ibën Shihneh (921 h.).

7. “Teuxhihu’l Inajeh li xhemi’sh-shuruhi’l Vikajeh”, dorëshkrim me autor Ebu’l Jumen ibën Shihneh (vd. pas 920 hixhri). Në hyrje, autori tregon se “El Vikajeh” është libri i parë që ai e ka memorizuar në fillimet e dijes. Këtu Ibën Shihne përmbledh në mënyrë të lehtë disa komente paraprake.

8. “Sherhu’l Vikajeh”, dorëshkrim me autor asketin e madh Muhjiddin Mahmud Çelebiun, i njohur më shumë si Shejhzade (vd. 950 hixhri). Këtë vepër e shkroi gradualisht, ku para mbajtjes së secilit ders mbante shënime derisa e përfundoi atë. Llogaritet ndër komentet më të mira të Vikajes.

9. “El Tetbik sherhu’l Vikajeh”, dorëshkrim me autor Kasim bin Sulejman Karamanit (vd. 970 hixhri). Veçori e këtij komenti janë përgjigjet ndaj kritikave dhe përmirësimeve të Ibën Kemal Pashës, të cilat i kishte bërë në “El Islah” mbi veprën “El Vikajeh”.

10. “El Inajeh fi sherhi’l-Vikajeh”, dorëshkrim me autor Salih bin Muhamed Tumurtashit (vd. 1055 hixhri). Ky është i biri i Tumurtashit të Madh, autorit të “Tenviru’l Ebsar ve Xhamiu’l-Bihar”. (vijon, inshallah)

1 Abdulhax Leknevi, El Fevauidu’l Behijeh. (Damask: Daru’l Kalem, 2023, botimi I), f. 348, bio. nr. 232.

2 Kadi Muhamed Çami Edirnevi, Mehammu’l Fukahai’l hanefijeti’l enxhab. (Stamboll: Harf, 2022, botimi I), f. 229, bio. nr. 293 si dhe f. 366.

3 Shiko: Dr. Salah abu’l Haxh, Hyrja studimore e veprës Sherhu’l Vikajeh. (Aman: El Verrak, 2006, botimi I), vëll. 1, f. 29-31; Dr. Muhamed Abdulkadir el Omer, Hyrja studimore e veprës Dhehiratu’l Ukbra fi sherhi Sadrisheriatit’l-Udhma. (Aman: Daru’r Rajahin, 2025, botimi I), vëll. 1, f. 50-52.

4 Ubejdullah Sadrusheriatit, (El Nukajeh) Muhtesaru’l Vikajeh fi mesaili’l Hidajeh. (Kazan, Lito-Tipografia e I.N. Kharitonov, 1911), f. 2

5 Ibën Tulun, El Gurafu’l alijeh fi tabekati mute’ehiri’l-hanefijeh. (Stamboll: ISAM, 2020, botimi I), vëll. 1, f. 216, bio. nr. 90; f. 231, bio. nr. 294; Mehammu’l Fukahai’l hanefijeti’l enxhab, f. 109, bio. nr. 109.

6 TDV Islam Ansiklopedisi, (Stamboll: Türkiye Diyanet Vakfı, 2023), vol. 35, fq. 427.

7 Omer Taxhusheriatit, Nihajetu’l Kifajeh. (Stamboll: Mektebetu’l Irshad, 2024, botimi I), vëll. 1, f. 4.

8 El Fevauidu’l-Behijeh, f. 326, bio. nr. 218.

9 Jusuf el Mer’ashli, Mesadiru’d Dirasati’l-islamijeh el fikhu’l-hanefijju furuan ve usulen (Bejrut: DKI, 2020, botimi I), vëll. 1, f. 324-326; Mehammu’l Fukahai’l hanefijeti’l enxhab, f. 109, bio. nr. 109.

10 Shiko: Katalogu i dorëshkrimeve arabe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës, fq. 420, 435 dhe 731.

11 Ibën Abidin, Raddu’l-Muhtar ale’d Durri’l Muhtar. (Damask: Daru’l Fikr, 1992, botimi II), vëll. 1, f. 77; El Fevauidu’l Behijeh, f. 336, bio. nr. 226.

12 Për të parë listën e plotë dhe të dhënat e nevojshme mbi këta komente shiko: Xhamiu’s Shuruh ve’l Havashi, vëll. 4, f. 900 e më tej; Hyrja studimore e veprës Sherhu’l Vikajeh, vëll. 1, f. 71-75; Muhamed el Omer, Studimi hyrës i veprës Dhehiratu’l Ukba fi sherhi Sadri’s Sheriatit’l Udhma. (Aman: Daru’r Rajahin, 2026, botimi I), vëll. 1, f. 90-127.

13 Shiko: Katalogu i dorëshkrimeve arabe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës, f. 419, 718, 739, 975 dhe 985.

Embrioni dhe të drejtat e tij në legjislacionin islam

Labinot Ademi

Fëja islame dhe embriologjia moderne pajtohen në faktin se zhvillimi i embrionit është një proces gradual, i cili kalon nëpër etapa të njëpasnjëshme dhe të mirëpërcaktuara. Burimet islame përshkruajnë fazat fillestare të krijimit të njeriut, duke filluar me fekondimin (nutfah), më pas kalimin në fazën e embrionit të ngjitur në murin e mitrës ('alakah), e më tej në fazën e masës së mishit (mudghah). Në hadithin e transmetuar nga Abdullah ibën Mesudi r.a., Pejgamberi a.s. shpjegon se këto faza zhvillohen në mënyrë të njëpasnjëshme dhe se, pas përfundimit të tyre, Allahu i Madhëruar dërgon një melaqe, e cila i fryn embrionit shpirtin. Në hadith thuhet: “Vërtet, krijimi i secilit prej jush mbledhet në barkun e nënës së tij për dyzet ditë si (spermatozoid i hedhur) nutfah, pastaj

po aq bëhet (gjak i ngjizur) 'alakah, pastaj po aq (si mish i përtypur) mudghah; më pas dërgohet melaqja... dhe i fryn atij shpirtin...”¹

Nga këndvështrimi i jurisprudencës islame, ky hadith përbën bazën kryesore për përcaktimin e momentit të frymimit të shpirtit (nafkh al ruh), të cilin shumica e juristëve klasikë e kanë vendosur pas kalimit të njëqind e njëzet (120) ditëve nga fillimi i shtatzënisë. Ky moment ka rëndësi të veçantë juridike, pasi lidhet me një sërë dispozitash që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës së fetusit, ndërprerjen e shtatzënisë dhe përgjegjësinë penale e civile në rast të cenimit të tij.

Hadithi tregon se formimi i embrionit kalon nëpër tri faza apo etapa, secila zgjat nga dyzet ditë, që do të thotë njëqind e njëzet ditë ose katër muaj. Pas kësaj periudhe, Allahu xh.sh. dërgon një melaqe, e cila i fryn shpirtin embrionit dhe nëna e ndien të gjallë embrionin e saj në bark. Kjo ndodh në dhjetë ditët pas përfundimit të katër muajve, përkatësisht pas njëqind e njëzet ditëve të tri etapave.

Embrioni, kur mbush katër muaj e dhjetë ditë, tashmë ka shpirt. Meqenëse embrioni është fryt i marrëdhënieve midis burrit dhe gruas, Sheriati islam i ka garantuar atij shumë të drejta, si përballë prindërve të tij, ashtu edhe përballë shoqërisë ku lind, në të gjitha fazat e formimit të tij.

Ndër të drejtat më të rëndësishme janë:

1. Të jetë fryt i një martese të ligjshme midis dy palëve që kanë një marrëdhënie

Islami e mbron jetën e fëmijës që nga fillimi i formimit të tij në barkun e nënës.



martesore të vlefshme, në mënyrë që të ruhet prejardhja e këtij fëmije dhe të mos jetë rezultat i një lidhjeje jashtëmartesore – zinasë.

2. Të ketë prindër të ndershëm, ku secili ka zgjedhur tjetrin në mënyrë të duhur dhe tek të dy të jetë e pranishme aftësia për martesë, veçanërisht përputhshmëria në besim dhe moral.²

Ndër të drejtat e tjera të embrionit para lindjes së tij është edhe ruajtja e jetës së tij derisa ende ndodhet në barkun e nënës.

Embrioni është fëmija që ndodhet në barkun e nënës së tij. Imam Kurtubiu, në komentimin e ajetit:

“...Dhe kur ishit embrion në barkun e nënave tuaja...” (En Nexhm, 32), thotë: “Exhinn është shumës i fjalës ‘xhenin’ – embrion dhe është quajtur kështu, sepse është i fshehur dhe i mbuluar brenda barkut.”³

Islami i ka dhënë të drejta fëmijës që në fillim të formimit të tij, në këtë fazë në barkun e nënës. E ka mbrojtur atë nga çdo formë sulmi dhe i ka ruajtur të drejtën për jetën, duke e ndaluar abortin dhe nxjerrjen e tij nga barku pas frymimit të shpirtit, duke u mbështetur në fjalën e Allahut të Lartësuar: “...Mos e vritni njeriun që Allahu e ka ndaluar, përveçse me të drejtë...” (El En’am, 151), qoftë edhe nëse aborti bëhet me marrëveshjen e bashkëshortëve.

KUJDESI PËR SHËNDETIN E EMBRIONIT

Islami i ka mundësuar nënës largimin nga lodhja fizike dhe psikologjike që mund të ndikojë negativisht në embrionin e saj, në mënyrë që ai të mos pësojë dëmtime ose abort. Për këtë arsye, Sheriati e ka liruar gruan shtatzënë nga disa obligime fetare gjatë shtatzënisë, siç është agjërimi, nëse ajo frikësohet për veten apo për fëmijën e saj.

Kujdesi për embrionin është përgjegjësi e përbashkët e prindërve dhe e shoqërisë.


Po ashtu, Islami i ka rekomanduar nënës që të ushqehet me ushqime të pasura me vitamina dhe elemente ushqyese që ndihmojnë në formimin dhe mbrojtjen e embrionit, si dhe në rritjen e tij të plotë.

Gjithashtu, Islami i ka këshilluar edhe baballarët që të marrin të gjitha masat për ta mbrojtur fëmijën nga ndikimi i djallit, që nga momenti i vendosjes së tij në mitër. Pejgamberi Muhamed a.s. ka thënë:

“Nëse ndonjëri prej jush, kur bën marrëdhënie intime me gruan e tij, thotë: ‘Me emrin e Allahut, o Allah, na largo ne prej djallit dhe largoje djallin prej asaj që na furnizon’, dhe pastaj nga ajo marrëdhënie lind fëmija – djalli nuk do ta dëmtojë atë kurrë.”⁴

PEZULLIMI I ZBATIMIT TË DËNIMIT NDAJ GRUAS SHTATZËNË PËR MBROJTJEN E JETËS SË FETUSIT

Islami ka ndaluar që të zbatohet ndonjë dënim ndaj gruas shtatzënë, nëse ky dënim mund të dëmtojë frytin (embrionin). Kjo është vërtetuar edhe në historinë e gruas nga fisi Ghamid, e cila kishte bërë zina dhe kishte mbetur shtatzënë. Pejgamberi a.s. i tha: “Shko derisa të lindësh fëmijën.”⁵



NDALIMI I DËMTIMIT TË EMBRIONIT NË PËRGJITHËSI

Sic kemi thënë më lart, Islami e ka ndaluar në mënyrë të përgjithshme dëmtimin e embrionit, saqë i ka lejuar nënës shtatzënë që të mos agjërojë gjatë Ramazanit – me kusht që ajo ta kompensojë më vonë. Nga Enesi ibën Maliku r.a. transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu ia ka hequr udhëtarit agjërimin dhe gjysmën e namazit, dhe ia ka hequr agjërimin gruas shtatzënë dhe asaj që ushqen me gj.”⁶

USHQIMI PËRMES NËNËS

Embrioni jeton në mitrën e nënës për rreth nëntë muaj dhe ushqehet përmes kordonit të kërthizës. Prandaj, është e detyrueshme që nëna të ndjekë një regjim ushqimor të saktë dhe të shëndetshëm. Allahu i Lartësuar thotë: “...Hani nga ushqimet e mira që Ne ju kemi dhënë...” (El Araf, 160).

Gjithashtu, ajo duhet të shmangë ushqimet e ndaluara, sipas fjalës së Allahut: “Ju është ndaluar mishi i kafshëve të ngordhura, gjaku dhe mishi i derrit...” (El Maide, 3).

RUAJTJA E PASURISË SË FËMIJËS ENDE PA LINDUR

Ndër të drejtat e fëmijës para lindjes është edhe ruajtja e të drejtave të tij pasurore, edhe pse ende është në barkun e nënës. Islami ka bërë obligim pagesën e dijes (kompensim për dëm) në rast se embrioni vritet.⁷

Gjithashtu, i ka dhënë atij të drejtën për trashëgimi, testament dhe të drejta të tjera që janë trajtuar gjerësisht nga dijetarët në librat e fikhut dhe të rregullave juridike.⁸



Sheriati islam i garanton embrionit të drejtën për jetën, dinjitetin dhe mbrojtjen edhe para lindjes.

LUTJA PARA LINDJES

Ndër të drejtat e fëmijës para lindjes është që të lutemi për të me lutje të mira. Kjo është përmendur edhe në Kuranin famëlartë, ku na mësohet të themi: “*Zoti ynë, na fal nga bashkëshortet dhe pasardhësit tanë ata që do të jenë gezim për sytë tanë dhe bëna udhëheqës për të devotshmit.*” (El Furkan, 74).

Gjithashtu, në një ajet tjetër thuhet: “Zoti im, më dhuro nga ana Jote një pasardhës të mirë, vërtet Ti je Ai që dëgjon lutjen.” (Ali Imran, 38).

1 Transmetojnë Imam Buhariu, hadithi nr. 3208 dhe Imam Muslimi, hadithi nr. 2643.

2 Mustafa Ahmed ez Zerka, El Fikh el Islami fi thevbihi el Xhedid, (Damask, Dar el Kalem, 1961), 110.

3 Muhamed bin Ahmed el Kurtubij, El Xhamiu li Ahkam el Kur'an, (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmije, 1988), 72.

4 Muhamed Ismail el Buhari, Sahih el Buhari, (Riad: Bejt el Efkar ed Duvelijeh li en Neshr, 1998), 53.

5 Malik bin Enes, El Muveta, (Damask, Muesesetu er Riseletu Neshirun, 2013), 629.

6 Muhamed bin Isa bin Sevrete et Tirmidhij, Sunen et Tirmidhij, (Kajro, Dar et Tesijl, 2016), 98.

7 Mexhmua min el Fukaha, El Mevsuah el Fikhijeh el Kuvejtijeh, botimi 2, (Kuvajt, Vizaretu el Evkaf ve Shu'un el Islamijeh, 1998), 59-61.

8 Po aty, 65.

Roli i nënës dhe i bashkëshortes nën shënjestrën e relativizmit modern

Nada Dosti

Relativizmi moral përçon idenë se nuk ka të vërteta apo role universale, se çdo person apo kulturë përcakton vetë se çfarë është e duhur apo e drejtë për të.

Në epokën tonë të ashtuquajtur moderne, roli i familjes dhe, veçanërisht, ai i nënës, i cili historikisht ka qenë kyç, sidomos në rritjen dhe edukimin e brezave, po minohet, duke u riformësuar dhe transformuar, në përpjekje për t'iu përshtatur ideologjive të kohës.

Si fillim, le të fokusohemi pak tek ajo se çfarë nënkuptohet me relativizëm modern dhe se si ky relativizëm ka ndikuar në perceptimin e sotëm për rolin e gruas në përgjithësi, deri te rolet e saj në shoqëri dhe familje.

Relativizmi moral përçon idenë se nuk ka të vërteta apo role universale, se çdo person apo kulturë përcakton vetë se çfarë është e duhur apo e drejtë për të. Shpesh, ai lidhet

me një tezë empirike, sipas së cilës ekzistojnë mospajtime morale të thella dhe të përhapura, si dhe me një tezë metaetike, sipas së cilës vërtetësia apo justifikimi i gjykimeve morale nuk është absolut, por relativ ndaj standardit moral të një personi apo grupi personash. Ndonjëherë, “relativizmi moral” lidhet edhe me një qëndrim normativ mbi mënyrën se si duhet të mendojmë apo të veprojmë ndaj atyre me të cilët nuk pajtohemi moralisht, të cilët, në shumicën e rasteve, duhet t'i tolerojmë.

Por, si po i vë relativizmi në pikëpyetje rolet që dikur konsideroheshin “të natyrshe” ose “të shenjta”, si ai i nënës dhe i bashkëshortes?



Ja disa aspekte të mendimit postmodernist që vlejné të nxirren në pah për të na ndihmuar t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve: së pari, mendimi postmodernist inkurajoi idenë se shoqëria jonë, e cila po bëhet gjithnjë e më pluraliste, duhet t'i pranojë dhe t'i dëgjojë zërat e shumtë: rrëfimet për gjininë, minoritetet etnike, orientimet seksuale dhe traditat kulturore. Mendimtarët postmodernë i nxitën audiencat që të vinin në pikëpyetje dhe ta dekonstruktin gjuhën, gjuhën e imazheve, institucionet dhe dijen e transmetuar, si dhe të shtronin pyetje se si fjalët, rrëfimet, arti dhe arkitektura mund të vendosin forma pushteti dhe "hegjemonie", të cilat, përndryshe, nuk do të dalloheshin. Proza e tyre, e mbushur me zhargon, ishte pjesë e nevojës më të gjerë, gjatë çerekut të fundit të shekullit të kaluar, për gjithëpërfshirje, diversitet, liri personale dhe të drejta civile. Mendimtarët kryesorë, të lidhur me këtë shkollë mendimi jo fort kompakte, bënë shumë për ta dëmtuar nocionin e së vërtetës. Trualli i tyre i natyrshëm ishte ironia, sipërfaqësorja, tëhuajësimi dhe fragmentizimi. Filozofët postmodernistë parapëlqenin ta konsideronin gjuhën dhe kulturën si "konstrukte shoqërore", si fenomene politike që pasqyronin ndarjen e pushtetit mes klasave, racave, gjinive dhe seksualitetit, dhe jo si ideale abstrakte të filozofisë klasike. Sipas tyre, gjithçka është "konstrukt shoqëror".

Le të ndalemi tani te dëmtimi i nocionit të së vërtetës dhe te konstruktet shoqërore. Edhe pse në teorinë e konstrukteve shoqërore, si dhe në ndarjet e padrejta mes klasave, racave dhe gjinive, ka pjesërisht të vërteta dhe të pavërteta, njeriu, në natyrshmërinë e tij, lind me një etalon matës që e ndihmon të bëjë dallimin mes tyre.

ROLI I MEDIAS NË SHËNJESTRIMIN E ROLIT TË NËNËS

Me rastin e Ditës së Nënës, e cila kremtohet në maj në Turqi, këtë vit u zhvillua një debat mbi mëmësinë. Reklama që shkaktoi polemika u hodh në qarkullim nga një markë e njohur gjermane e pajisjeve shtëpiake, me titullin "Bash një histori nënë". Në reklamë, brenda një dyqani, zhvillohej një dialog midis

dy grave rreth temës së amësisë. Ndërsa reklama vazhdonte, krijohej përshtypja se ato po flisnin për fëmijët e tyre, por në fund doli se "fëmija" për të cilin flitej ishte, në fakt, një qen shtëpiak. Kjo situatë krijoi polemika të mëdha në rrjetet sociale, ku shumë përdorues argumentuan se kjo mënyrë paraqitjeje po e zhvlerësonte konceptin e familjes, të fëmijës dhe, mbi të gjitha, të amësisë.

Reagimet zyrtare ishin edhe më të forta. Ministria e Familjes dhe Shërbimeve Sociale u shpreh se konceptet e amësisë dhe të familjes nuk duhet të vihen në diskutim dhe se nuk e shihte të drejtë zëvendësimin e këtyre vlerave me koncepte të tjera. Kryetari i RTÜK-ut (Këshilli i Lartë i Radios dhe Televizionit, rregullatori shtetëror i medias në Turqi) deklaroi se ata e mbështesin dashurinë ndaj të gjitha qenieve, por qëndrojnë kundër zhvlerësimit të një vlere kaq të lartë sa amësia, sepse amësia nuk përcaktohet nga reklama, por gjen kuptim nëpërmjet jetës. RTÜK-u njoftoi zyrtarisht nisjen e një hetimi dhe, pas presionit të tij, firma në fjalë e hoqi reklamën nga qarkullimi.

Ajo që e bën këtë reklamë të duket se është nisur nga një qëllim dashakeqës është fakti se firma e pajisjeve elektro-shtëpiake, në fushatat e saj evropiane, përdor fëmijë dhe tema tradicionale familjare, ndërsa në Turqi zgjodhi qenin, gjë që u cilësua si "standard i dyfishtë sipas tregut". Pra, në thelb, një reklamë komerciale që barazoi metaforikisht kafshët shtëpiake me fëmijët, në kontekstin e Ditës së Nënës, u përjetua nga një pjesë e opinionit publik turk si zhvlerësim i vlerave tradicionale familjare.

Polemika mori edhe një dimension tjetër kur një prezantuese e TRT-së (transmetuesi publik shtetëror) uroi në ekran zotëruesit e qenve dhe të maceve për Ditën e Nënës, duke thënë se edhe ajo është një "nënë leshtuakësh". Kjo shkaktoi reagime të reja dhe, brenda vetë TRT-së, u sqarua se komentet e saj nuk përfaqësonin politikën institucionale të kanalit. Kjo çështje u polarizua qartë politikisht dhe kulturalisht: nga njëra anë ishin ata që thoshin se

Kur relativizimi mohon të vërtetat universale, Kurani dhe Suneti mbeten busulla e besimtarit.

struktura familjare po prishet dhe, nga ana tjetër, ata që thoshin: “Mos na u përzini në jetën tonë”, ndërsa debati u përshkallëzua edhe më tej.

Ky është vetëm një shembull i nënvlerësimit të rolit të nënës, por ka me qindra punime, artikuj, ese dhe libra shkencorë që flasin për mënyrën se si, në epokën postmoderne, qëllimisht po zbehet roli i nënës, sepse amësia nuk përputhet me kapitalizmin, konsumerizmin, feminizmin dhe ideologji të shumta që çojnë përpara rendet botërore.

MOSPËRPUTHSHMËRIA DHE PAQËNDRUESHMËRIA E RELATIVIZMIT MORAL

Sipas relativizmit moral, çdo veprim mund të jetë njëkohësisht i drejtë dhe i gabuar. Për shembull, në raport me një kulturë liberale, skllavëria është e gabuar, por në raport me një kulturë joliberale,

Islami ruan ekuilibrin: as imponim i padrejtë ndaj gruas, as liri pa përgjegjësi, por drejtësi, fitre dhe mesatare.

skllavëria mund të jetë e drejtë. Përsëri, cila nga këto dy kultura ka të drejtë? Sipas relativistit moral, asnjëra. Rrjedhimisht, skllavëria mund të jetë njëkohësisht e drejtë dhe e gabuar, pasi kjo varet nga këndvështrimi i veçantë i një kulture të caktuar.

Për më tepër, relativizmi kulturor pohon se ne duhet t'i tolerojmë kulturat e tjera. Kjo do të thotë se, meqenëse nuk ekziston asnjë standard përfundimtar i moralit, relativisti moral nuk duhet t'i gjykojë kulturat e tjera, por, përkundrazi, duhet t'i tolerojë ato.

Gjithashtu, relativizmi kulturor argumenton se progresi moral nuk ndodh në kuptimin që një ndryshim moral, për shembull, nga skllavëria drejt barazisë, të nënkuptojë një lëvizje drejt një standardi moral përfundimtar.

Sipas relativistit moral, edhe Hitleri nuk duhet të gjykohet, sepse, sipas këtij këndvështrimi, edhe ai ka pasur arsytet dhe bindjet e veta për atë që ka bërë. Një qasje e tillë nuk e merr parasysh faktin se disa bindje etike pranohen dhe mbështeten nga të gjitha kulturat.

Cila kulturë mund të mos e dënojë dhe të mos e refuzojë vrasjen ose gënjeshtrenë? Cila kulturë mund të mos e pranojë drejtësinë dhe ndershmërinë? Në fakt, mund të thuhet se ky pretendim mbështetet në një induksion të paplotë, pasi mund të gjenden shumë raste në të cilat disa detyrime mbeten të qëndrueshme në të gjitha bashkësitë dhe kulturat, pavarësisht ndryshimeve kulturore.

SI TË LUNDROJMË NË NJË EPOKË TË RELATIVIZMIT MODERN

Çdo qytetërim ka një sistem etik që përcakton vlerat dhe moralin e tij. Edhe konceptet themelore të “së mirës” dhe “së keqes” burojnë prej këtij sistemi. Ky sistem etik e merr frymëzimin nga botëkuptimi i qytetërimit në fjalë. Islami, ashtu si të gjitha fetë e tjera, u ofron gjithashtu besimtarëve të tij një kod të plotë moral. Kurani dhe Suneti janë kriteret e vetme për përcaktimin e parimeve themelore të etikës islame dhe, për këtë arsye, morali në Islam është njëkohësisht objektiv dhe absolut.



Në botën postmoderne, ndërkohë, sistemi moral dhe ai i vlerave, i mbështetur nga mendimtarët postmodernistë, është relativ dhe subjektiv, në vend që të jetë absolut dhe objektiv, dhe si i tillë ndryshon sipas kohës dhe hapësirës. Ai mund të kalojë gjithashtu nëpër evolucion dhe asnjë veprim apo koncept nuk mund të gjykohej sipas ndonjë kriteri absolut. Ky “relativizëm” dhe ky “subjektivizëm” sfidojnë potencialisht të gjitha shkollat tradicionale të etikës.

Thënë kjo, ajo që e ndihmon njeriun të lundrojë në këtë botë të vërtetave dhe post-të vërtetave (post-truth) është universaliteti i Islamit dhe besimi në nocionin e fitres. Disa vlera, të cilat promovohen edhe nga Islami, janë të mbjella në natyrën njerëzore. Askush nuk do të kishte guximin, madje as shoqëritë më të degjeneruara, t'i quanin vlera ose normale vrasjen e foshnjave, abuzimin me fëmijët apo incestin, sado që përpiqen t'i normalizojnë veprime të tilla, më të këqija se kafshërore, dhe t'i arsyetojnë ato me llojlloj teorish të liberalizmit. Dhe, sado që një virtut të linçohet si prapambetje apo konservatorizëm, thellë-thellë natyrshmëria njerëzore do ta pranojë atë; mjafton që këtë virtut ta vendosni përballë një qenieje të sinqertë dhe të pa kompromentuar në natyrën e saj, siç janë fëmijët.

Sa herë që një besimtar përballet me pikëpyetje ose vë në dyshim ndonjë konstrukt shoqëror, mjafton t'i kthehet brendisë së tij dhe ta pyesë veten: A është kjo pjesë e natyrshmërisë? A e pranon vetja ime, me gjithë qenien time, këtë gjë? Dhe, kur na duket se logjika jonë është korruptuar nga ideologji të shumta dhe nga copëza të vërtetash të hedhura andej-këtej nga rende të ndryshme botërore, mjafton t'u kthehemi burimeve tona fetare, të cilat kanë mbetur të pa kompromentuara dhe të pa korruptuara: Kuranit dhe traditës profetike.

Dhe, kur vjen puna te roli i nënës në Islam, janë shkruar shumë libra, janë botuar shumë hulumtime dhe janë mbajtur mijëra ligjërata, aq sa do të ishte e tepërt të shtohesh diçka më shumë. Por ajo që vlen të theksohet është fakti se roli i nënës, ashtu si edhe rolet e tjera gjinore, si dhe marrëdhëniet në çift, përveç disa të drejtave dhe rregullave bazë,

Askush nuk do të kishte guximin, madje as shoqëritë më të degjeneruara, t'i quanin vlera ose normale vrasjen e foshnjave, abuzimin me fëmijët apo incestin, sado që përpiqen t'i normalizojnë veprime të tilla, më të këqija se kafshërore, dhe t'i arsyetojnë ato me llojlloj teorish të liberalizmit.

në shumë detaje janë lënë të hapura dhe fleksibile.

Sipas dijetarëve islamë, arsyeja për këtë është që secila kulturë dhe shoqëri të vendosë vetë se si dëshiron t'i menaxhojë zgjedhjet personale, me kusht që ato të mos bien në kundërshtim me natyrshmërinë dhe me rregullat e Islamit, si dhe të mos cenojnë të drejtat dhe “hakun” e të tjerëve.

Për shembull, në rastin e gjidhënies, nëna nuk është e detyruar ta ushqejë foshnjën e saj me gj. Megjithatë, e drejta e foshnjës për t'u ushqyer duhet të përmbushet në një mënyrë ose në një tjetër, qoftë nga vetë nëna, nga një gjidhënëse tjetër e kontraktuar për këtë arsye apo me alternativa të tjera, nëse bashkëshortët bien dakord për këtë.

Në këtë rast, Islami, si fe e mesatares, as nuk e ngarkon gruan, siç ndodh në disa kultura të tjera, duke e konsideruar gjidhënien detyrim të padiskutueshëm, por as nuk i jep asaj liri të pakufizuar për të mos e ushqyer fëmijën pa konsensusin e babait, nën pretekstin: “Trupi im, e drejta ime”.

Si bashkëshorte, ajo nuk është e detyruar të punojë dhe të kontribuojë ekonomikisht në familje, siç ndodh në disa kultura perëndimore, por as nuk detyrohet, me çdo kusht, të qëndrojë e mbyllur në shtëpi, nëse dëshiron të punojë. Kjo vlen pavarësisht përjashtimeve të ndryshme dhe pavarësisht asaj që përpiqen të imponojnë disa vende islame, të cilat kulturën e kanë shndërruar në fe dhe fenë në kulturë.

Bibliografia:

- Alvaro, C. A. (n.d.). The Incoherence of Moral Relativism. CUNY Neë York City College of Technology.
- D'Ancona, Mattheë, Post-Truth: The New war on Truth and How to Fight Back: 9781785036873 Books. (n.d.).
- Goëans, C. (2026, June 28). Moral Relativism. <https://plato.stanford.edu/entries/moral-relativism/>
- Nasir, M. N. (2011). Confronting The Threat of Relativism : Vieës from Islamic Philosophy. *Kanz Philosophia a Journal for Islamic Philosophy and Mysticism*, 1(2), 163. <https://doi.org/10.20871/kpjipm.v1i2.18>
- Piroozvand, S., & Nassiri, M. (2012). Moral Relativism under Criticism. *Journal of Emerging Trends in Educational Research and Policy Studies (JETERAPS)* 3(4): 593-599.
- Shaukat, M. A., & Basharat, T. (2022). A study of Relativistic Theory of Ethics in the light of Islamic Theory of Morality. *Journal of Islamic Thought and Civilization*, 12(2), 286–298. <https://doi.org/10.32350/jitc.122.20>

Komunikimi toksik dhe gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale

Enis Reçica

Fjala mund të ndërtojë ura mirëkuptimi, por mund të mbjellë edhe urrejtje që dëmton breza të tërë.

Rrjetet sociale kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si njerëzimi flet, mendon dhe formon opinion. Për një brez të tërë, i cili sot po rritet me telefonin inteligjent në dorë që nga fëmijëria, ekrani nuk i atribuohet më vetëm leksionit “një dritare drejt botës”, por një hapësirë ku formohen identiteti, vetë-vlerësimi dhe madje edhe kuptimi i së mirës dhe i së keqes. Për këto arsye, fatkeqësisht, kjo hapësirë e re komunikimi është shndërruar njëkohësisht edhe në një terren pjellor për një dukuri shqetësuese: gjuhën e urrejtjes dhe komunikimin toksik.

Gjuha e urrejtjes, përveçse është një fjalë e ashpër e thënë në një moment nervozizmi, është edhe një sistem i tërë komunikimi që synon ta poshtërojë, ta etiketojë dhe ta

çnjerëzojë tjetrin për shkak të fesë, kombësisë, gjinisë, bindjeve politike apo të çfarëdo dallimi tjetër. Kur kjo gjuhë përsëritet çdo ditë, në çdo koment e postim, ajo nuk mbetet vetëm “zhurmë digjitale” pa pasoja. Ajo depërton në mendjen e brezave të rinj dhe fillon t’ua formësojë vlerat që nga fëmijëria, ndërsa dëmet e saj mund të jenë kolosale për brezat e ardhshëm.

ÇKA NËNKUPTOJMË ME “GJUHË TË URREJTJES”?

Kombet e Bashkuara e përkufizojnë gjuhën e urrejtjes si çdo lloj komunikimi, qoftë me fjalë, me shkrim apo me sjellje, me të cilin sulmohet ose përdoret terminologji përçmuese ndaj një personi apo grupi në



bazë të fesë, etnisë, kombësisë, racës, ngjyrës, prejardhjes, gjinisë apo ndonjë faktori tjetër identitar, dhe që mund ta rrezikojë paqen shoqërore. Kjo gjuhë shpesh vishet me petkun e “lirisë së fjalës”, ndonëse, në thelb, ajo nuk synon dialog apo bindje me argumente, por poshtërim, dehumanizim dhe përjashtim të tjetrit.

Një ndër faktorët kryesorë që e nxit përhapjen e gjuhës së urrejtjes në internet është zakonisht anonimiteti dhe mungesa e pasojave ligjore. Me fjalë të tjera, atëherë kur personi bindet se “askush s’e di kush jam” dhe se “askush s’do të më ndëshkojë”, filtri i tij moral dobësohet ndjeshëm.

Ky trend është gjithkund, kudo që ka internet, kompjuter apo telefon mobil. Edhe Kosova, si shumica e vendeve me qasje të lartë në internet dhe me një popullsi të re, po e përjeton këtë dukuri në një përmasë të dukshme.

Sipas një hulumtimi të organizatës “Demokracia për Zhvillim”, rreth 15.3 për qind e komenteve të bëra në rrjetet sociale, lidhur me një rast që përfshinte një familje politikane në Kosovë, përmbanin gjuhë të hapur urrejtjeje. Zakonisht, janë gratë politike që përballen me më shumë gjuhë urrejtjeje dhe bullizëm sa herë që shkruajnë në rrjetet e tyre sociale. Ndërkaq, studime të tjera, edhe në nivel lokal, kanë gjetur se rreth një e pesta e fëmijëve dhe adoleshentëve në vend kanë përjetuar bullizëm, sidomos në rrjetet sociale. Mungesa e sanksioneve konkrete e bën gjuhën e urrejtjes “më të lirshme” në internet sesa në komunikimin ballë për ballë, ndërsa institucionet ende nuk kanë një kornizë të plotë ligjore për ta trajtuar këtë dukuri, veçanërisht kur viktimat janë të mitur.

PASOJAT NË EDUKIMIN E BREZAVE

Fëmijët dhe të rinjtë e sotëm po rriten në një mjedis ku argumentin dhe të vërtetën shpesh i zëvendësojnë zëri më i lartë, etiketimi dhe ofendimi. Pa dyshim se kjo ka disa pasoja afatgjata në formimin e tyre moral dhe psikologjik:

1. Fillimisht shfaqet normalizimi i dhunës verbale. Kur fëmija sheh çdo ditë se debatet online zgjidhen me fyerje e jo me argumente, ai fillon ta konsiderojë këtë si një formë “normale”.

2. Dëmtimi i vetëvlerësimit dhe i shëndetit mendor. Viktimat e bullizmit kibernetik

shpesh përjetojnë ankth, izolim shoqëror dhe ulje të performancës shkollore.

3. Polarizimi shoqëror dhe fetar që në moshë të re. Të rinjtë mësohen ta shohin “tjetrin” (etnikisht, fetarisht apo ideologjikisht të ndryshëm) si armik, e jo si bashkëqytetar.

Këto pasoja nuk mbeten të izoluara në botën virtuale. Ato transferohen në shkollë, në familje dhe në shoqëri, duke formuar breza që e kanë më të vështirë të dëgjojnë, të diskutojnë me qetësi dhe ta pranojnë ndryshimin e mendimit si diçka të natyrshme.

A mund të jetë Islami alternativa për ta luftuar këtë “gjuhë”?

Islami i kushton rëndësi qendrore fjalës si mjet përgjegjësie, jo vetëm si mjet komunikimi. Kurani dhe hadithi flasin vazhdimisht për peshën e madhe që bart gjuha e njeriut, si dhe për rrezikun që sjell keqpërdorimi i saj.

Allahu i Lartësuar thotë: *“O ju që besuat, të mos tallet një popull me një popull tjetër, se mund të jenë ata (të përqeshurit) më të mirë se ata (që përqeshin) [...] Mos e përgjoni njëri-tjetrin! A dëshiron ndonjëri prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë e urreni, prandaj kini frikë Allahun!”* (El Huxhurat, 11-12).

Ky ajet i drejtohet drejtpërdrejt asaj çka sot ndodh masivisht në rrjetet sociale: përqeshjes publike të dikujt, etiketimit, ironisë poshtëruese dhe përgojimit të personave apo grupeve. Vetë krahasimi i fortë me “ngrënien e mishit të vëllait të vdekur” tregon se sa të rëndë e konsideron Islami dëmtimin e nderit të tjetrit përmes fjalës.

Gjithashtu, Allahu urdhëron: *“...dhe thua-ju robërve të Mi që t’u thonë njerëzve fjalën më të mirë, sepse djalli ndërson mes tyre. Vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.”* (El Isra, 53).

Ky ajet tregon qartë se komunikimi me fjalë të mira nuk është thjesht një zgjedhje etike, por një urdhër hyjnor, ndërsa fjala e keqe dhe përçarëse identifikohet drejtpërdrejt si mjet i djallit për të mbjellë armiqësi mes njerëzve – gjë që sot e shohim të ndodhë në kohë rekord përmes një komenti apo postimi.

I Dërguari i Allahut a.s. e ka theksuar po ashtu rëndësinë e ruajtjes së gjuhës si shenjë e besimit të vërtetë. Ai a.s. transmetohet se ka thënë: “Kush i beson Allahut dhe Ditës së

Rrjetet sociale nuk formësojnë vetëm opinionin publik, por edhe karakterin dhe vlerat e brezit të ri.

Sipas Islamit, përgjegjësia për fjalën nuk mbaron te tastiera; ajo vazhdon edhe para Allahut.



Fundit, le të flasë fjalë të mirë ose le të heshtë.” (Buhariu dhe Muslimi).

Këto tekste fetare nuk flasin për diçka abstrakte. Ato flasin pikërisht për atë çka ndodh sot pas ekranit dhe në rrjetet sociale: fjalë të hedhura shpejt e pa u peshuar, të cilat lënë gjurmë të thella në jetën e njerëzve dhe që, sipas mësimit islam, mbartin përgjegjësi edhe përpara Krijuesit.

NGA DUKURI GLOBALE NË DINAMIKË VENDORE

Kosova nuk bën përjashtim në këtë rrjedhë botërore. Rritja e shpejtë e platformave si TikTok, Instagram dhe Facebook te popullsia e re ka bërë që fëmijët të ekspozohen ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme që në moshë shumë të hershme, shpesh pa mbikëqyrje të duhur prindërore. Ekspertët e fushës së edukimit digjital në Kosovë theksojnë se shumica e fëmijëve fillojnë ta përdorin TikTok-un para moshës së rekomanduar prej trembëdhjetë vjetësh dhe shpesh e kalojnë kohën në këto platforma pa asnjë filtër apo bisedë paraprake me prindërit rreth rreziqeve që fshihen pas ekranit.

Krahas kësaj, përmbajtjet me gjuhë të ashpër, sensacionale apo përçarëse gjenerojnë dukshëm më shumë ndërveprim (komente, shpërndarje, reagime) sesa përmbajtjet e balancuara dhe informuese. Kjo tregon se vetë këto platforma janë të programuara për t'u dhënë përparësi përmbajtjeve nxitëse e përçarëse. Kjo krijon një cikël vetëpërfurcues: sa më shumë urrejtje shihet, aq më shumë urrejtje prodhohet, sepse sistemi “e shpërblen” atë që tërheq më shumë vëmendje, e jo atë që edukon apo bashkon.

Rasti i Kosovës tregon gjithashtu se gjuha e urrejtjes shpesh shfaqet më intensivisht në periudha tensionesh shoqërore apo politike, siç u vu re gjatë ngjarjeve të trazuara në veri të vendit apo edhe gjatë proceseve zgjedhore. Në

këto periudha, numri i postimeve dhe i komenteve me përmbajtje përçarëse rritet ndjeshëm brenda pak orësh. Kjo tregon qartë se rrjetet sociale, në mungesë të edukimit dhe të vetëdijes qytetare, mund të shndërrohen shpejt në amplifikues të krizave, në vend që të jenë hapësirë për dialog dhe zgjidhje.

ÇKA MUND TË BËJMË?

Përballja me këtë dukuri kërkon një përpjekje të përbashkët, jo vetëm ndalime teknike apo ligjore. Ndonëse, edhe institucionalisht, shteti duhet të ndërhyjë, siç po bëjnë rëndom një varg shtetesh evropiane, duke marrë masa rigorozë, qoftë për mbylljen e tërësishme të platformave të caktuara, qoftë për kushtëzimin e moshës për qasje në to. Derisa shteti të ndërhyjë institucionalisht, ne mund të veprojme kështu:

1. Edukimi medial që në moshë të hershme. Fëmijëve dhe të rinjve duhet t'u mësohet se si të dallojnë informacionin e vërtetë nga manipulimi dhe se si të komunikojnë me respekt në internet. Në Kosovë, tash e sa kohë, është shtruar si kërkesë futja e “Lëndës mediale” në shkolla.

2. Roli aktiv i prindërve. Familja duhet të zhvillojë biseda të hapura me fëmijët për atë çka shohin dhe përfetojnë në rrjetet sociale.

3. Angazhimi i xhamive dhe i institucioneve fetare në ligjëratat dhe programe rinore, që e trajtojnë drejtpërdrejt etikën e fjalës dhe të komunikimit digjital, duke e lidhur këtë me vlerat islame të nderit, të drejtësisë dhe të respektit ndaj tjetrit.

4. Kultivimi i shembullit personal. Prindërit, mësuesit dhe udhëheqësit fetarë duhet ta praktikojnë vetë atë që mësojnë, sepse brezat e rinj mësojnë më shumë nga shembulli sesa nga fjala.

Gjuha e urrejtjes dhe kultura e durimit

ROLI I INSTITUCIONEVE SHETËRORE, FETARE DHE I MEDIAVE NË NDËRTIMIN E KOHEZIONIT SOCIAL

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

HYRJE

Shoqëria bashkëkohore sot po përballet gjithnjë e më shumë me probleme të theksuara, të cilat po reflektohen edhe në segmentet e tjera të jetës. Përderisa liria e shprehjes është zgjeruar si një nga shtyllat themelore të sistemit demokratik, njëkohësisht është rritur edhe përhapja e diskurseve përjashtuese, diskriminuese dhe nxitëse të urrejtjes ndaj individëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore. Në këtë kontekst, duhet thënë se gjuha e urrejtjes nuk është vetëm një fenomen gjuhësor apo komunikues, por ajo përfaqëson një mekanizëm social që “prodhon dhe riprodhon pabarazi, stigmatizim dhe përjashtim, duke cenuar kohezionin social, sigurinë njerëzore dhe funksionimin demokratik të institucioneve”.¹ Përhapja e saj lidhet me faktorë strukturorë, si polarizimi politik,

trashëgimia e konflikteve, dobësitë institucionale dhe dinamika e zhvillimit të platformave digjitale. Rasti i Kosovës shërben si një model për të analizuar këto procese në një shoqëri që, pavarësisht trashëgimisë së saj të bashkëjetesës shekullore ndërmjet komuniteteve dhe diversitetit fetar e kulturor, përballet me forma të reja të polarizimit dhe të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në hapësirën digjitale. Të dhënat tregojnë se ndërtimi i një kulture të qëndrueshme të tolerancës nuk mund të mbështetet vetëm në masa ligjore ose në mekanizma ndëshkues, por kërkohet një qasje e integruar, ku institucionet shtetërore, komunitetet fetare, mediat, sistemi arsimor dhe organizatat e shoqërisë civile veprojnë në mënyrë të koordinuar për të promovuar dialogun, besimin reciprok dhe respektimin e diversitetit.

Përderisa liria e shprehjes është zgjeruar si një nga shtyllat themelore të sistemit demokratik, njëkohësisht është rritur edhe përhapja e diskurseve përjashtuese, diskriminuese dhe nxitëse të urrejtjes ndaj individëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore.



Pasojat që shkaktohen nga gjuha e urrejtjes nuk lidhen vetëm me individin e sulmuar, por ato prekin themelet e besimit social dhe të demokracisë.

GJUHA E URREJTJES DHE DIMENSIONI SOCIAL

Gjuha e urrejtjes përfaqëson një fenomen kompleks social, politik dhe psikologjik që shkon përtej përdorimit të fjalëve fyese ose diskriminuese. Ajo përbën një praktikë komunikimi që prodhon dhe riprodhon raporte të pabarabarta pushteti, duke legjitimuar përjashtimin e grupeve të caktuara nga hapësirat publike dhe duke cenuar dinjitetin e tyre qytetar.² Pasojat që shkaktohen nga gjuha e urrejtjes nuk lidhen vetëm me individin e sulmuar, por ato prekin themelet e besimit social dhe të demokracisë. Sociologu Pierre Bourdieu, ndër të tjera, argumenton se “pushteti simbolik ushtrohet përmes gjuhës, duke bërë që disa forma të komunikimit të perceptohen si legjitime, ndërsa të tjera të shërbejnë si instrumente dominimi dhe nënshtrimi.”³ Madje, vetë Komisioni Evropian, në raportet e tij, nënvizon se gjuha e urrejtjes përfshin “çdo formë të shprehjes që përhap, nxit, promovon ose justifikon urrejtjen, dhunën ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash”, duke u shfaqur përmes fyerjeve, etiketimeve, stereotipave, dehumanizimit, gjuhës kërcënuese, nxitjes së urrejtjes dhe justifikimit të dhunës.⁴

RASTI I KOSOVËS DHE NEVOJA PËR NDËRVEPRIM SOCIAL

Në Kosovë, viteve të fundit është vërejtur një shpërfaqje e gjuhës së urrejtjes, e cila fillimisht ka nisur nga politikanët në kuadër të fushatave zgjedhore dhe që gradualisht është manifestuar përmes formave të ndryshme, sidomos në rrjetet sociale. Lidhur me gjuhën e urrejtjes

dhe mënyrën e shpërfaqjes, Vlora Konushevc, në një studim të bërë në vitin 2025, thekson se “grupi më shpesh i targetuar ishte i bazuar në përkatësinë etnike, ku 27 incidente përfshinin ksenofobinë, diskriminimin etnik ose racizmin. Urrejtja me bazë gjinore doli në 22 incidente, ndërsa gazetarët ishin grupi i tretë më i targetuar (14 incidente), gjë që dëshmon cenueshmërinë e aktorëve medialë në diskursin publik”⁵.

Pra, mund të shihet se së fundi është rritur dukshëm edhe numri i incidenteve përmes komenteve fyese e diskriminuese ndaj grupeve të ndryshme, përfshirë ato fetare.⁶

Sa i përket formës apo mënyrës së shpërndarjes, gjuha e urrejtjes shpërndahet përmes rrjeteve sociale, sidomos në Facebook, e deri te kanali YouTube, pavarësisht politikave që kanë këto media sociale.

Hulumtimi i realizuar nga Vlora Konushevc vë në dukje se “mediat sociale, sidomos Facebooku, ishin mediumi dominues për përhapjen e urrejtjes, të implikuara në mbi 76 incidente, ose si platformë e vetme ose si e përbashkët. Pas tyre vijnë portalet online”⁷. Këto të dhëna nga ky raport hulumtues mund të shërbejnë si një bazë e mirë studimi për të analizuar së afërmi problemet e shpërfaqura në rrjetet sociale, të cilat promovojnë urrejtje ndaj grupeve të ndryshme, sidomos ndërmjet konfesioneve fetare.

SHKAQET DHE PASOJA E GJUHËS SË URREJTJES

Duhet theksuar se gjuha e urrejtjes nuk është një fenomen i izoluar komunikues, por ajo është produkt i ndërveprimit të faktorëve të ndryshëm, përfshirë ata historikë, politikë,




Figura 1. Pasqyrimi i incidenteve përmes gjuhës së urrejtjes (Konushevc, 2025).

institucionalë, ekonomikë, socialë, kulturorë dhe teknologjikë.

- **Trashëgimia historike e konflikteve dhe kujtesa kolektive** – vazhdojnë të përbëjnë një burim të rëndësishëm të diskurseve të gjuhës së urrejtjes, sidomos në Ballkanin Perëndimor, në raport me vendet e tjera të zhvilluara.

- **Polarizimi politik** – konsiderohet një nga faktorët e tjerë në prodhimin dhe normativizimin e gjuhës së urrejtjes. Ky polarizim, pastaj, shndërrohet në një model normativ, sidomos për gjeneratat e reja.

- **Zbatimi joefektiv i legjislacionit** – i cili krijon një klimë që e ushqen gjuhën e urrejtjes. Komisioni dhe Parlamenti Evropian kanë theksuar vazhdimisht se institucionet e drejtësisë në Kosovë duhet të “forcojnë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kur autorët janë figura publike ose zyrtarë politikë”⁸

- **Transformimi i komunikimit publik nga platformat digjitale** – ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

- **Presioni i konkurrencës mbi sektorin mediatik** – ka krijuar modele të reja për prodhimin e përmbajtjeve të ndjeshme dhe konfliktuale.

Sa u përket pasojave, ato nuk kufizohen vetëm në komunikimin publik, por ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në raportet shoqërore, mirëqenien psikologjike të individëve dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

Në kontekstin e Kosovës, raportet ndër-fetare tradicionalisht janë karakterizuar nga bashkëjetesa dhe toleranca, ndërsa konfliktet e zhvilluara kanë pasur kryesisht karakter politik dhe etnonacional.

DIMENSIONI FETAR SI FAKTOR I INSTRUMENTALIZIMIT TË GJUHËS SË URREJTJES

Një dimension që ka pasur rëndësi në vitet e fundit është instrumentalizimi i identiteteve fetare në diskursin publik. Në kontekstin e Kosovës, raportet ndër-fetare tradicionalisht janë karakterizuar nga bashkëjetesa dhe toleranca, ndërsa konfliktet e zhvilluara kanë pasur kryesisht karakter politik dhe etnonacional. Megjithatë, raportet e fundit ndërkombëtare evidentojnë se platformat digjitale dhe debatet politike kanë “krijuar hapësirë për rritjen e narrativave që lidhin identitetin fetar me identitetin kombëtar ose me orientime të caktuara politike”⁹. Në raste të tilla, feja nuk funksionon si burim i drejtpërdrejtë i konfliktit, por si një simbol identitar që keqpërdoret për mobilizim politik, prodhim të stereotipave dhe deprivim social të grupeve të tjera. Nga dioptria sociologjike, sociologu i njohur José Casanova argumenton se “feja në shoqëritë demokratike nuk është domosdoshmërisht burim konflikti; përkundrazi, ajo mund të shërbejë si faktor integrues dhe promotor i dialogut publik kur institucionet fetare promovojnë respektin reciprok, solidaritetin dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor”¹⁰.

Një rast që e ilustron këtë fenomen është vrasja e një imami në komunën e Dragashit gjatë vitit 2026. Edhe pse autoritetet e trajtuan ngjarjen si të lidhur me një mosmarrëveshje pronësore, reagimet e shumta në rrjetet sociale u karakterizuan nga komente fyese dhe stigmatizuese që synonin viktimën për shkak të përkatësisë së tij fetare. Ky rast tregon se identiteti fetar mund të instrumentalizohet lehtësisht në komunikimin virtual, duke i përdorur incidentet individuale si mjete për përhapjen e paragjyqimeve dhe të stigmës ndaj komuniteteve fetare.

KUADRI LIGJOR PËR PARANDALIMIN E GJUHËS SË URREJTJES

Luftimi i gjuhës së urrejtjes dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor përbëjnë një nga përgjegjësitë themelore të një shteti demokratik. Në Republikën e Kosovës, ky obligim nuk buron vetëm nga legjislacioni penal, por




Figura 2. Shpërndarja e gjuhës së urrejtjes përmes mediave (Konushevci, 2025).

mbështetet në një bazë të gjerë ligjore që garanton barazinë, mosdiskriminimin, lirinë e shprehjes, lirinë e besimit dhe mbrojtjen e diversitetit kulturor e fetar. Themeli i këtij sistemi është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila, në nenin 3, e përcakton Kosovën si “një shoqëri shumetnike, të ndërtuar mbi parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të identitetit të të gjitha komuniteteve”.¹¹ Kësisoj, Kushtetuta ndërton një model kushtetues ku pluralizmi dhe diversiteti nuk trajtohen vetëm si të drejta individuale, por edhe si vlera themelore mbi të cilat mbështetet demokracia e vendit. Një rol të rëndësishëm, në aspektin e normave juridike, ka edhe Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore, “i cili e trajton dhunën psikologjike, verbale dhe format e tjera të abuzimit si pjesë të mekanizmave që cenojnë dinjitetin dhe sigurinë e individit”.¹² Në fushën e raporteve ndërfetare, Kosova vazhdon të ndërtojë një model institucional të bazuar në respektimin e pluralizmit fetar. Në anën tjetër, zhvillimet e viteve të fundit tregojnë se ky mozaik i bashkëjetesës përballet me sfida të reja, veçanërisht në hapësirën virtuale. Ndoshta kjo është edhe rezultat i ndryshimeve dhe zhvillimeve sociale, madje edhe i trendeve të globalizmit, të cilat po dalin të jenë goxha sfiduese për rendin e ri botëror.

INSTITUCIONET SHETETËRORE DHE FETARE SI AKTORË SOCIALË DHE ROLI I MEDIAVE

Institucionet shtetërore dhe fetare përbëjnë dy nga agjencitë më të rëndësishme të socializimit dhe të ndërtimit të kohezionit shoqëror. Përtej funksioneve të tyre, ato ndikojnë në formësimin e normave, vlerave dhe modeleve të bashkëjetesës, duke orientuar mënyrën se si qytetarët e perceptojnë diversitetin, dallimet kulturore dhe raportet me njëri-tjetrin. Në këtë drejtim, roli i tyre për të promovuar tolerancën apo durimin ose, në të kundërtën, për të lejuar normalizimin e gjuhës së urrejtjes ka ndikim social të drejtpërdrejtë në stabilitetin social dhe funksionimin demokratik të shoqërisë. Kësisoj, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe bashkësive fetare ka kontribuar ndër vite në ruajtjen e klimës së tolerancës përmes dialogut ndërfetar, deklaratave të përbashkëta kundër dukurive negative në shoqëri dhe aktiviteteve të përbashkëta humanitare. Në anën tjetër, mediat, si entitete të pavarura,

Institucionet shtetërore dhe fetare përbëjnë dy nga agjencitë më të rëndësishme të socializimit dhe të ndërtimit të kohezionit shoqëror.

përtej funksionit informues, ndikojnë në mënyrën se si ndërtohen perceptimet apo narrativat dhe si artikulohen konfliktet sociale.

NDËRVEPRIMI INSTITUCIONAL – NJË MODEL I INTEGRUAR DHE I NEVOJSHËM

Analiza e këtij studimi tregon se asnjë institucion nuk mund ta parandalojë i vetëm përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Efekti i zbatimit të politikave publike varet nga koordinimi ndërmjet institucioneve shtetërore, bashkësive fetare, mediave, sistemit arsimor dhe organizatave të shoqërisë civile. Pikërisht ky koordinim krijon kushte për ndërtimin e besimit, forcimin e kohezionit social dhe mbrojtjen e kulturës së tolerancës dhe bashkëjetesës.

Si përfundim, mund të thuhet se trajtimi i kësaj teme tregon se gjuha e urrejtjes nuk mund të kuptohet vetëm si një fenomen i izoluar komunikimi, por si një proces social që ushqehet nga polarizimi politik, trashëgimia e konflikteve, dobësitë institucionale dhe dinamika e komunikimit digjital.

1 Waldron, Jeremy: “*The Harm in Hate Speech*”, Cambridge, MA: Harvard University Press, 2012, shih: <https://doi.org/10.4159/harvard.9780674065086>

2 Shala, Bajrami Luljeta: “*Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediat sociale*”, Si ta parandalojmë doracak për mësues, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2016, fq. 16.

3 Bourdieu, Pierre: “*Language and Symbolic Power*”, ed. John B. Thompson, trans. Gino Raymond and Matthew Adamson, Cambridge, MA: Harvard University Press, 1991, fq. 40.

4 European Commission against Racism and Intolerance (ECRI): “*General Policy Recommendation No. 15 (Revised) on Combating Hate Speech* (Strasbourg: Council of Europe”, adopted December 8, 2015; revised 2021), <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>

5 Konushevc, Vlorë: “*Raporti i monitorimit të gjuhës së urrejtjes në Kosovë 2025*”, Rrjeti i Raportimit të Diversitetit (RDN), Prishtinë, 2025, f. 7.

6 Konushevc, Vlorë: “*Raporti i monitorimit të gjuhës së urrejtjes në Kosovë 2025*”, Rrjeti i Raportimit të Diversitetit (RDN), Prishtinë, 2025, f. 7.

7 Po aty, f. 8.

8 European Commission, *Kosovo Report 2024* (Brussels: European Commission, 2024), European Parliament, *Report on the 2023 and 2024 Commission Reports on Kosovo*, 2025.

9 Freedom House, *Freedom in the World 2024: Kosovo* (Washington, DC: Freedom House, 2024), <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2024>

10 Casanova, José: “*Public Religions in the Modern World*”, Chicago: University of Chicago Press, 1994).

11 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3, 24, 38, 40.

12 Ligji Nr. 08/I-185 Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.

(Zh)bërja e autoriteteve

Imer Topanica

Njerëzit kanë nevojë për udhëheqës që i drejtojnë. Përherë, në mesin e njerëzve, shquhen personalitete që kanë fuqi dhe aftësi drejtuese. Sipas fjalorëve western,¹ autoriteti, si nocion, nënkupton pikërisht mishërimin e këtyre aftësive të një personalitet, grup shoqëror, entitet apo institucion. Me fjalë të tjera, fuqia e dikujt, e drejta për të dhënë urdhra, për të kontrolluar, për të marrë vendime, për të përqafuar vlera e jetësuar parime të caktuara morale, si dhe, mbi të gjitha, për t'i shtyrë të tjerët t'i jetësojnë e zbatojnë ato, s' nënkupton gjë tjetër veçse aftësinë e manifestimit të autoritetit.

Po çfarë është autoriteti? A s' është ai që merr vendime, që urdhëron, që nënshton, që i detyron e i drejton, me apo pa dëshirë, të tjerët të veprojnë sipas fuqisë, intelektit dhe vullnetit të tij? Për këtë, Bertrand Russell, tek

“Authority and the Individual”,² bën dallimin ndërmjet “autoritetit të domosdoshëm” dhe “autoritetit që dominon”. Mbi të gjitha, pranimë e tij në një mjedis shoqëror të organizuar e sheh në funksion të një kontrolli ose pushteti të nevojshëm për kohezionin social.

Në varësi nga mënyrat e manifestimit, mbështetur në traditat e ndryshme shoqërore dhe në modelet e organizimit të tyre, shquajmë edhe lloje të ndryshme të autoriteteve. Autoriteti prindëror, autoriteti moral, autoriteti intelektual, autoriteti i forcës, autoriteti shtetëror etj., janë togfjalësja që na i kujtojnë prindin, mësuesin, shkrimtarin, gazetarin, akademikun, politikanin, ushtarakun, policin, gjyqtarin, prokurorin, udhëheqësin shtetëror etj., të cilët, në ndërgjegjen tonë, janë etabluar si role që e ndihmojnë shoqërinë të mos dalë nga “binarët”. Megjithatë, jehona e vonë e

“Më shumë bëhet përpjekje që njerëzit të përshtaten me sistemin, sesa ai t’iu përshtatet atyre.”

Russell



përplasjeve kulturore në Perëndim ndërmjet lëvizjeve liberale dhe të majta ekstreme, kundër tabanit të djathtë dhe konservator, i ka zvetënuar në masë të dukshme modelet tradicionale të autoriteteve (nënë, babanë, mësuesin, prijësin fetar etj.), ndërsa, në anën tjetër, i ka forcuar modelet e reja, që për botëkuptimin tonë janë më pak relevante. Këto çështje³ i kemi trajtuar edhe në artikujt e mëparshëm, andaj ndjesë, nëse ju bie të hasni në “ripërtpje” argumentesh tashmë të artikuluara. Por, përtej kësaj, interesi ynë është gjurmimi, identifikimi dhe analizimi i shkaqeve që kanë çuar në zhbërjen e modelit të autoritetit moral dhe intelektual, mjaft me ndikim dikur në mjedisin tonë shoqëror.

RIMODELIMI

Le të pyesim një herë: Çfarë kërkon autoriteti prindëror në një mjedis ku sistemi i vlerave, i cili promovohet, do t'i trajtojë fëmijët si pronë të vetë sistemit – ndërkohë që ia ka dalë t'i distancojë fëmijët nga prindërit? Çfarë kërkon autoriteti i mësuesit në një mjedis kulturor ku ata që duan t'i “edukojnë” brezat përdorin pajisjet e sofistikuara teknologjike, duke i shfrytëzuar përmbajtjet deri edhe pornografike, për t'ua vjelë vëmendjen të rinjve e, për rrjedhojë, duke ua injektuar sëmundjet, ndër të tjera edhe atë të identitetit gjinor? Çfarë kërkon autoriteti i dijetarit? Intelektualit? Kur sistemi do t'i kthejë masat në konsumatorë të pavetëdijshëm produktesh, duke i përfshirë edhe ato që njihen si premtime elektorale? Ja pra, këtu duhet kërkuar thelbi i arsyes pse ne jemi duke e përjetuar rimodelimin e autoriteteve.

Russell thotë: “Më shumë bëhet përpjekje që njerëzit të përshtaten me sistemin, sesa ai t'iu përshtatet atyre.”⁴ Kjo na e bën të lehtë leximin dhe kuptimin e skenarit rreth zhbërjes së disa autoriteteve tradicionale. Ndër “viktimat” e radhës është edhe vetë familja nukleare (*nuclear family*). Trendi i këtyre shpërnderimeve po vazhdon, megjithëse ka shenja se celulat ideologjike janë nën një presion të madh në nivel global, sidomos pas mega-skandalit që lidhet me “Dosjet Epstein”.⁵

Kongresmenë e senatorë republikanë e kanë ngritur zërin dhe kanë kërkuar publikimin e plotë të dosjeve. Dhe, ani pse vetëm

Zbehja e rolit prindëror dhe e autoriteteve tradicionale po i lë fëmijët të pambrojtur ndaj agjendave dhe kontrollit ideologjik të sistemit.

një pjesë e vogël e tyre janë nxjerrë në shesh, duke u redaktuar për publikun e gjerë, megjithatë edhe kjo ka shkaktuar një tronditje të madhe në opinionin publik perëndimor. Dyshimet se shumë institucione shtetërore e private, organizata e entitete kulturore, u kanë shërbyer besnikërisht ideologjive, janë tërësisht të mbështetura.

Kur senatori Josh Hawley u ballafaqua publikisht me drejtorin ekzekutiv të Netflix-it, Ted Sarandos,⁶ ndërsa e akuzoi se po e promovon ideologjinë transgjimore, theksoi, ndër të tjera, faktin që platforma në fjalë është e mbushur me materiale që e promovojnë agjendën LGBTIQ+.

“Pse pothuajse gjysma e programit tuaj për fëmijë paraqet këtë material shumë të diskutueshëm dhe shumë të seksualizuar?”⁷ – e pyet ai, ndër të tjera. E çfarë na shërben ky rast në diskutimin tonë? Shumë thjesht, me zbehjen e rolit të prindërve, agjendat e tilla shtrihen më lehtë, sepse nuk ka asnjë autoritet që mund t'i parandalojë. Pra, po e ritheksojmë: ndërsa roli prindëror zbehet, ai zëvendësohet me një autoritet tjetër, shpesh jo të dukshëm në kuptimin fizik. Grupet e fuqishme që i kontrollojnë dhe i promovojnë agjendat e djallit, nëpërmjet pajisjeve të teknologjisë informative, përkatësisht rrjeteve sociale si Facebook, X, YouTube, TikTok, Snapchat etj., ia kanë dalë t'i “kulturalizojnë” brezat e rinj në



një frymë e cila i ka zhveshur tërësisht nga tabani i traditave të mëdha.

Nëse shoqëria është një familje e madhe dhe nëse autoritetet morale e intelektuale u ngjajnë prindërve, në kuptimin e rolit që ata e gëzojnë në funksion të zhvillimit dhe emancipimit shoqëror, e kuptojmë pse zhbërja e rolit të tyre ka qenë e pashmangshme.

KOSOVA, NJË FSHAT GLOBAL NË MINIATURË

Ndryshimi i sistemeve politike, gjithnjë vjen me një kosto edhe në planin e vlerave, e madje edhe në aspektin e zëvendësimit të autoriteteve. Në rend të parë, për shkak se shtresat që dikur ishin në pushtet, që diktonin një standard vlerash të tjera; zëvendësohen nga shtresa të reja pushtetarësh, që vijnë me ‘pakot’ e veta të vlerave. Dikush mund të thotë se çdo shtresë pushtetarësh ka nevojë për zëra intelektualësh që ua sigurojnë jetëgjatësinë në pushtet, duke e mbrojtur narrativën e kauzës së tyre, shkaku i së cilës kanë ardhur në shprehje. Megjithatë, intelektual i njëmendët, nuk shndërrohet në instrument të pushtetit, por ai e mbron kur ka të drejtë dhe e kritikon apo e kundërshton kur ai bëhet i egër e i padurueshëm. Kursi i interesit intelektual, përherë është i kthyer nga masa dhe shtresat më pak të mbrojtura.

Por, pushtetet ndonjëherë ndryshohen më lehtë, e intelektual i *nuk ‘prodhohet’* përditë.

Por çfarë është intelektual i fundi i fundit? “Është e përhapur ideja për intelektualin që duhet të jetë një individ i arsimuar me nivel, me standarde të larta morale, që i kundërvihet gjendjes shoqërore ekzistuese, veçanërisht gjendjeve patologjike në shoqëri dhe hipokrizisë së elitës në pushtet”⁸ – vënon me të drejtë studiuesi Albinot Maloku. Ndërsa merret pikërisht me shkakun e zbehjes së “aurës” së intelektualit, ai konstaton se ajo ka ardhur si rrjedhojë e shumë faktorëve.

“Sot, me të drejtë mund të thotë secili se, kohërat e peshës së fjalës dhe të besimit ndaj intelektualit i përkasin të kaluarës, ose se mezi mund të numërohen intelektualët karizmatikë që gëzojnë famë dhe fuqi për t’i orientuar zhvillimet shoqërore. Sidomos duke pasur parasysh kohën e lulëzimit të industrisë së argëtimit masiv dhe të arsimit masiv, “të famshmit”, figurat nga bota e filmit, muzikës, kulinarisë dhe biznesit, e përveç kësaj, rrjetet sociale dhe teknologjitë e tjera të ngjashme të informacionit, kanë rritur numrin e modeleve njerëzore që vlejnë për t’u imituar. Në këtë kuptim, mund të flitet për një

Kohërat e peshës së fjalës dhe të besimit ndaj intelektualit i përkasin të kaluarës, duke u zëvendësuar nga ‘të famshmit’ e industrisë së argëtimit.

‘egalitarizim’ dhe ‘banalizim’ (sekularizim?) të ‘karizmës’ intelektuale të dikurshme. Mirëpo, një shpjegim më të mirë për këtë gjendje patologjike shoqërore të vlerësimit e ofroi Hobsbawm, i cili, si historian i shkëlqyer, thotë se “këtu bëhet fjalë për faktin se ideologët (dhe politikanët), në fund të shekullit XX, ia lanë vlerësimin kritik dhe racional, si dhe angazhimin për ndryshime shoqërore dhe sigurimin e një ekuilibri më të qëndrueshëm shoqëror, automatizmit (‘auto-vlerësimit’) të individëve, të cilët maksimizojnë përfitimin e tyre dhe të shoqërisë, duke iu dorëzuar një tregu të pakufizuar dhe të çrregulluar”. Kjo gjendje mund të kuptohet, por nuk mund të justifikohet, pasi ndodhi në kohën e rritjes ekonomike dhe të triumfit të shoqërisë konsumatore, kur, bashkë me të, rendi i gjërave është çrregulluar me pasoja të rënda.”

Kosova, përkatësisht shoqëria kosovare, nuk është një përjashtim i këtij konteksti global. Natyrisht, për shkak të disa shtresimeve të forta identitare, siç janë ato fetare, mund të themi se procesi i zhbërjes së këtyre autoriteteve është zhvilluar me një ritëm më të ngadaltë.

Konspiracionistët, mjaft të zëshëm në hapësirat tona publike, thonë se zvetënimi i rolit të intelektualëve në skenën publike vjen si rrjedhojë edhe e ndikimit të politikave hegjemoniste të armiqve tanë. Duke i shuar këto role, duke i amortizuar, planet e tyre janë më pranë jetësimit të ideve të tyre për rikthimin e kontrollit mbi vendin tonë.

Gjithsesi, edhe po t’i marrim me rezervë këto modele të shpjegimit, kur shohim zbehjen e ndikimit të këtyre modeleve autoritare në mjedisin tonë social e kulturor, na shtynë të mendojmë më thellë. Çfarë ka ndodhur me Akademinë e Arteve dhe e Shkencave të Kosovës (ASHAK)¹⁰, cili është ndikimi i veprimtarisë së saj në zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror e institucional? Çfarë ka bërë ajo në rastet kur republika jonë ka kaluar nëpër sfida të mëdha, sidomos në rrafshin politik? Cili është zëri i saj në rastet kur skena politike ngeci duke mos ia dalë të ofrojë zgjidhje për çështje shumë të ndjeshme politiko – shoqërore? Ku është Universiteti i Prishtinës? Ku janë studentët? Diçka e rëndë ka ndodhur, diçka e pariparueshme.

Nëse në vitet e 90-ta, të shekullit që iku, karshi Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së), e cila udhëhiqej nga figura karizmatike e Ibrahim Rugovës, qëndronte simboli i rezistencës Adem Demaçi, kush mund t’i mbath “këpucët” e

tyre të mëdha sot, në kuptimin e peshës së veprimtarisë që ata dikur e kishin?

Duhet të pajtohemi se “habitatit” i mediave nëpërmjet të cilave dikur artikulohej zëri i intelektualëve, në vitet e fundit ka ndryshuar në mënyrë të rrufeshme. Nëse nga vitet 60 – deri në vitet 90 kishim librin dhe gazetën si medime ku frekuentonin mendimet e intelektualëve, në vitet 2000 fillon hegjemonia e mediave elektronike. Por, përgjatë kohës kur skena mediale diktohej nga ritmi i televizioneve dhe gazetave të shtypura, standardi i etikës gazetareske është ruajtur bukur mirë. Pastaj kur u futën në garë portalet dhe rrjetet sociale, veçmas Tik-Tok-u, gjithçka ndryshoi për të keq. Dëshpërimisht duhet të pajtohemi me konstatimin e Umberto Eco-s kur para disa vitesh shprehej: “Mediat sociale u kanë dhënë të drejtën e fjalës budallenjve”.¹¹

EPILOG

Njerëzit kanë nevojë për udhëheqës që i drejtojnë. Përherë në mesin e njerëzve shquhen personalitete që kanë fuqi dhe aftësi drejtimi. Sipas fjalorëve *western*, autoriteti – si nocion, nënkupton pikërisht mishërimin e këtyre aftësive të një personalitet, grup shoqëror, entitet apo institucion. Me fjalë të tjera, fuqia e dikujt, e drejta për të dhënë urdhra, për të kontrolluar, për të marrë vendime, për të përqafuar vlera e jetësuar parime të caktuara morale, si dhe mbi të gjitha për t’i shtyrë të tjerët t’i jetësojnë e zbatojnë ato, s’nënkupton gjë tjetër veçse aftësinë e manifestimit të autoritetit.

Diskutimi më i hershëm mbi modelin e organizimit shoqëror, mbetet ideja e Platonit për Republikën.¹² Shteti

Fuqia e dikujt, e drejta për të dhënë urdhra, për të kontrolluar, për të marrë vendime, për të përqafuar vlera e jetësuar parime të caktuara morale, si dhe mbi të gjitha për t’i shtyrë të tjerët t’i jetësojnë e zbatojnë ato, s’nënkupton gjë tjetër veçse aftësinë e manifestimit të autoritetit.

utopik, sipas Platonit, mbetet ai që i shëmbëllen një piramide. Baza e piramidës, sipas tij, duhet të përbëhet nga zejtarët, bujqit, tregtarët dhe zotëruesit e profesioneve të ndryshme. Ata do ta kishin për detyrë prodhimtarinë dhe mirëmbajtjen e ekonomisë. Në mes të saj, do të duhej vendosur rojet – përkatësisht luftëtarët. Funkcioni i tyre do të lidhej me mbrojtjen, ruajtjen e rendit dhe zbatimin e ligjeve. Pra, ata do të edukoheshin që në vegjëli me disiplinë të rreptë. Atyre nuk do t’ju lejohej grumbullimi i pasurive private dhe do të duhej të jetonin për interesin publik. Luftëtarët do të shquheshin nga virtyti i guximit. Ndërsa maja e piramidës së republikës ideale, sipas Platonit, do të përbëhej nga filozofët mbretër. Duke qenë se ata e njohin të vërtetën, e kuptojnë të mirën, nuk sundojnë për interesa personale, qeverisin për të mirën e shoqërisë, meritojnë të vendosen në maje të organizimit shtetëror.

Por Alfred North Whitehead, një matematikues dhe filozof britanik, i cili për Platonin shprehej kështu: “Karakterizimi më i sigurt i përgjithshëm i traditës filozofike evropiane është se ajo përbëhet nga një seri shënimesh në fund të faqes për Platonin!”, andaj s’kemi si të mos pajtohemi që diskutimi mbi organizimin shoqëror, ndërtimin e shtetit ideal, e qe besa edhe autoritetin që duhet ta udhëheq shoqërinë, nuk ka përfunduar.

Madje, madje as nuk do të përfundojë deri në fund të ekzistencës njerëzore. Për këtë arsye, ky artikull s’është veçse një reflektim i shpejt mbi traditën e këtij debati të gjatë e të papërfunduar.



- <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/authority?q=AUTHORITIES>
- Russel B. “AUTHORITY AND THE INDIVIDUAL”; Routledge, London and New York 1964.
- I.Toponica, ‘Kriza e leximit dhe hegjemonia e teknologjisë; ‘Dituria Islame’, Prishtinë, gusht 2024, f. 45.
- Russel B. “AUTHORITY AND THE INDIVIDUAL”; Routledge, London and New York, 1964.
- https://en.wikipedia.org/wiki/Epstein_files
- <https://www.hawley.senate.gov/hawley-grills-netflix-ceo-for-promoting-transgender-ideology-secures-commitment-to-protect-american-jobs/>
- Po aty
- Albinot Maloku “Intelektualët dhe kriza e besimit”, ‘Studime’ nr. 5, f. 79.
- Po aty, f. 81.
- <https://ashak.org/>
- <https://www.lastampa.it/cultura/2015/06/11/news/umberto-eco-con-i-social-parola-a-legioni-di-imbecilli-1.35250428/>
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Republic_\(Plato\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Republic_(Plato))



Ruajtja e identitetit fetar në epokën e globalizimit dhe transformimeve kulturore

SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT BASHKËKOHORE

Aid Nasufaj


HYRJE

Epoka bashkëkohore karakterizohet nga procese të thella globalizimi, zhvillime të vullshme teknologjike dhe transformime të vazhdueshme kulturore, të cilat kanë ndikuar në pothuajse çdo aspekt të jetës njerëzore. Këto ndryshime kanë sjellë mundësi të reja për komunikim, bashkëpunim dhe shkëmbim kulturor, por, njëkohësisht, kanë ngritur edhe sfida serioze për ruajtjen e identiteteve tradicionale, veçanërisht të identitetit fetar. Në një botë ku kufijtë kulturorë dhe gjeografikë po bëhen gjithnjë e më të depërtueshëm, individët dhe komunitetet fetare përballen me nevojën për t'i ruajtur vlerat, bindjet dhe traditat e tyre përballë ndikimeve të shumta globale.

Feja ka qenë historikisht një nga elementet themelore të identitetit individual dhe kolektiv. Ajo ka ndikuar në formimin e sistemeve morale, normave shoqërore dhe botëkuptimeve që kanë udhëhequr jetën e komuniteteve njerëzore për shekuj me radhë. Në Islam, identiteti fetar nuk kufizohet vetëm në aspektin ritual, por përfshin një mënyrë të tërë jetese, të ndërtuar mbi besimin, moralin dhe përgjegjësinë ndaj Allahut dhe shoqërisë.

Kurani i shenjtë thekson rëndësinë e qëndrueshmërisë në besim dhe të ruajtjes së lidhjes me udhëzimin hyjnor. Allahu i Madhëruar thotë: *“O ju që besuat! Kini frikë Allahun ashtu siç duhet t'i keni frikë Atij dhe mos vdisni ndryshe, veçse duke qenë myslimanë.”* (Ali Imran, 102).

Epoka bashkëkohore karakterizohet nga procese të thella globalizimi, zhvillime të vullshme teknologjike dhe transformime të vazhdueshme kulturore, të cilat kanë ndikuar në pothuajse çdo aspekt të jetës njerëzore.



Ky ajet paraqet një thirrje të vazhdueshme për ruajtjen e identitetit islam, pavarësisht ndryshimeve të kohës dhe rrethanave historike.

Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut a.s. i ka kushtuar rëndësi të veçantë ruajtjes së besimit dhe identitetit fetar në kohë sprovas. Ai ka thënë: “Kam lënë ndër ju dy gjëra; nëse kapeni fort pas tyre, nuk do të humbni kurrë: Librin e Allahut dhe Sunetin tim.”¹

Ky hadith tregon se burimet themelore të Islamit mbeten udhërrëfyesi kryesor për ruajtjen e identitetit fetar në çdo kohë dhe në çdo vend.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e globalizimit dhe të transformimeve kulturore në identitetin fetar, të shqyrtojë sfidat kryesore me të cilat përballen besimtarët në botën moderne, të evidentojë mekanizmat që ndihmojnë në ruajtjen e identitetit fetar dhe të paraqesë perspektivat bashkëkohore për harmonizimin e identitetit fetar me realitetet e një bote gjithnjë e më të globalizuar. Nëpërmjet analizës së burimeve islame dhe të literaturës bashkëkohore, synohet të argumentohet se ruajtja e identitetit fetar nuk përbën pengesë për pjesëmarrjen aktive në shoqërinë moderne, por një faktor të rëndësishëm për ruajtjen e ekuilibrit moral dhe shpirtëror të individit.

GLOBALIZIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË IDENTITETIN FETAR

Globalizimi konsiderohet si një proces i zgjerimit të marrëdhënieve ekonomike, kulturore, teknologjike dhe informative në nivel botëror, i cili ka transformuar mënyrën e jetesës së njerëzve dhe perceptimin e tyre për identitetin. Ndonëse ky fenomen ka afruar popujt dhe kulturat, ai ka krijuar gjithashtu sfida serioze për ruajtjen e identiteteve tradicionale, veçanërisht të atyre fetare. Në kushtet e një bote të ndërlidhur, individit ekspozohet çdo ditë ndaj ideve, bindjeve dhe stileve të ndryshme të jetesës, të cilat ndikojnë në formimin e botëkuptimit të tij.²

Islami e njeh llojllojshmërinë kulturore dhe etnike si pjesë të urtësisë hyjnore. Allahu i Madhëruar thotë: “O njerëz! Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, që të njiheni me njëri-tjetrin. Më i nderuari tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” (El Huxhurat, 13).

Ky ajet tregon se ndërveprimi ndërmjet popujve nuk është, në vetvete, problematik, por sfida lind kur procesi i globalizimit shndërrohet në një mjet të uniformizimit kulturor dhe të dobësimit të veçorive identitare të komuniteteve fetare.³

Një nga karakteristikat kryesore të globalizimit bashkëkohor është dominimi i mediave dhe i teknologjisë së

Rrjetet sociale, platformat digjitale dhe industria globale e argëtimit kanë krijuar modele të reja kulturore, të cilat ndikojnë fuqishëm në mendësinë e brezave të rinj.

informacionit. Rrjetet sociale, platformat digjitale dhe industria globale e argëtimit kanë krijuar modele të reja kulturore, të cilat ndikojnë fuqishëm në mendësinë e brezave të rinj. Përmes tyre përhapen vlera, sjellje dhe ideologji të ndryshme, të cilat jo rrallë bien ndesh me mësimet tradicionale fetare.⁴

Përballë kësaj situate, Kurani i paralajmëron besimtarët që të mos i ndjekin verbërisht rrjedhat dominuese të shoqërisë: “Nëse i bindesh shumicës së atyre që janë në tokë, ata do të të largojnë nga rruga e Allahut.” (El En’am, 116).

Ky ajet nuk nënkupton refuzimin e dialogut me botën, por thekson nevojën që besimtari ta ruajë aftësinë kritike dhe të mos e humbasë identitetin e tij nën presionin e shumicës.⁵

I Dërguari i Allahut a.s. ka tërhequr vëmendjen edhe ndaj periudhave kur ruajtja e fesë bëhet e vështirë. Ai a.s. ka thënë: “Do të vijë një kohë kur ai që mbahet pas fesë së tij do të jetë sikur ai që mban prush në dorë.” (Tirmidhiu).

Ky hadith përshkruan me saktësi sfidat e kohës moderne, në të cilat besimtari shpesh përballet me presione kulturore, morale dhe ideologjike, që e vështirësojnë ruajtjen e identitetit fetar.⁶

Megjithatë, globalizimi nuk duhet të shihet vetëm si kërcënim. Ai ka krijuar mundësi të jashtëzakonshme për përhapjen e dijes islame. Sot, bibliotekat digjitale, universitetet online, ligjëratat virtuale dhe aplikacionet fetare mundësojnë qasje në burime, të cilat brezat e mëhershëm nuk i kishin. Në këtë aspekt, teknologjia mund të shndërrohet në një mjet për forcimin e vetëdijes fetare dhe jo domosdoshmërisht në një faktor të dobësimit të saj.⁷

SFIDAT BASHKËKOHORE NË RUAJTJEN E IDENTITETIT FETAR

Ruajtja e identitetit fetar në shekullin XXI përballet me sfida të shumta, që burojnë nga ndryshimet e shpejta shoqërore, kulturore dhe teknologjike. Ndër sfidat më të mëdha renditet sekularizmi, i cili promovon ndarjen e fesë nga jeta publike dhe kufizimin e saj në sferën private të individit. Në shumë vende moderne, feja konsiderohet çështje personale, ndërsa normat shoqërore dhe ligjore ndërtohen kryesisht mbi baza laike. Kjo situatë ka ndikuar në dobësimin e rolit tradicional të institucioneve fetare në formimin moral të individit dhe të komunitetit.⁸

Kurani i shenjtë i kujton besimtarit se feja nuk është vetëm një bindje private, por një mënyrë jetese, që përfshin të gjitha dimensionet e ekzistencës njerëzore. Allahu thotë: “Thuaj: Vërtet, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve.” (El En’am, 162).

Ky ajet thekson se identiteti fetar duhet të reflektohet në të gjitha aspektet e jetës dhe se nuk mund të kufizohet vetëm në rituale të veçuara nga realiteti shoqëror.⁹

Një sfidë tjetër serioze është relativizmi moral, i cili mbron ekzistencën e standardeve universale të së mirës dhe të së keqes. Në kulturën bashkëkohore, shpesh promovohet ideja se çdo individ ka të drejtë t'i përcaktojë vetë normat e tij morale, pa iu referuar autoritetit hyjnor. Kjo qasje bie ndesh me konceptin islam të moralit, i cili bazohet në shpalljen hyjnore dhe në mësimet profetike.¹⁰

Përballë kësaj prirjeje, Allahu i Madhëruar thotë: *“Pastaj të vumë ty në një rrugë të qartë të fesë; ndiqe atë dhe mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë.”* (El Xhathije, 18).

Sipas komentuesve klasikë, ky ajet nënvizon domosdoshmërinë e mbështetjes në udhëzimin hyjnor dhe jo në prirjet e ndryshueshme të shoqërisë.¹¹

Mediat dhe rrjetet sociale përbëjnë gjithashtu një sfidë të rëndësishme. Ato kanë aftësinë të formësojnë perceptimet, bindjet dhe sjelljet e individëve shumë më shpejt sesa institucionet tradicionale. Përmbajtjet që promovojnë individualizmin ekstrem, materializmin dhe hedonizmin ndikojnë veçanërisht te të rinjtë, të cilët kalojnë një pjesë të konsiderueshme të kohës së tyre në hapësirat virtuale.¹²

I Dërguari i Allahut a.s. ka paralajmëruar për ndikimin e shoqërisë dhe të mjedisit në formimin e individit. Ai a.s. ka thënë: *“Njeriu është në fenë e mikut të tij, prandaj secili prej jush le të shikojë se kë merr për mik.”*¹³

Një nga sfidat më të ndjeshme mbetet kriza e identitetit te të rinjtë. Të rinjtë e sotëm jetojnë ndërmjet kulturave, ideologjive dhe sistemeve të ndryshme të vlerave. Në mungesë të një edukimi të fortë fetar dhe moral, ata mund të përfshihen pasiguri lidhur me identitetin e tyre dhe të humbin lidhjen me trashëgiminë shpirtërore të komunitetit të tyre.¹⁴

MEKANIZMAT E RUAJTJES SË IDENTITETIT FETAR

Përballë sfidave të globalizimit dhe të transformimeve kulturore, ruajtja e identitetit fetar kërkon mekanizma të qëndrueshëm edukativë, shpirtërorë dhe institucionalë. Ndër këta mekanizma, edukimi fetar zë një vend qendror. Njohja e bazave të fesë, e historisë së saj dhe e vlerave morale që ajo promovon i jep individit aftësinë për ta kuptuar identitetin e tij dhe për t’iu përgjigjur sfidave intelektuale të kohës.¹⁵



Kurani e vlerëson dijen si themel të besimit dhe të vetëdijes fetare: *“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?”* (Ez Zumer, 9).

Ky ajet tregon se ruajtja e identitetit fetar nuk mund të mbështetet vetëm në traditë, por kërkon dije dhe kuptim të vazhdueshëm.¹⁶

Familja konsiderohet institucioni i parë dhe më i rëndësishëm në transmetimin e identitetit fetar. Brenda saj fëmija mëson lutjen, normat morale, respektin për të tjerët dhe ndjenjën e përkatësisë fetare. Një familje që kultivon vlera shpirtërore krijon baza të forta për formimin e personalitetit fetar të brezave të rinj.¹⁷

Allahu urdhëron: *“O ju që besuat! Ruajeni veten dhe familjet tuaja nga zjarri.”* (Et Tahrim, 6).

Komentuesit e Kuranit kanë theksuar se ky urdhër përfshin edukimin fetar, moral dhe shpirtëror të anëtarëve të familjes.¹⁸

Përveç familjes, institucionet fetare luajnë rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e identitetit religjioz. Xhamitë, medresetë, fakultetet islame dhe qendrat kulturore, krijojnë hapësira ku besimtarët forcojnë njohuritë e tyre dhe ndërtojnë lidhje me komunitetin. Këto institucione shërbejnë si ura lidhëse ndërmjet traditës fetare dhe sfidave bashkëkohore.¹⁹

Një element tjetër themelor është praktikimi i rregullt i adhurimeve. Namazi, agjërimi, leximi i Kuranit dhe përmendja e Allahut, forcojnë lidhjen shpirtërore të besimtarit me Krijuesin dhe e mbrojnë atë nga ndikimet negative të mjedisit.²⁰

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Shembulli i atij që e përmend Zotin e tij dhe atij që nuk e përmend është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit.”*

Ky hadith tregon se kujtimi i Allahut nuk është vetëm një akt adhurimi, por edhe një mekanizëm për ruajtjen e vitalitetit shpirtëror dhe identitetit fetar.²¹

PERSPEKTIVAT BASHKËKOHORE PËR HARMONIZIMIN E IDENTITETIT FETAR ME BOTËN GLOBALE

Globalizimi nuk duhet të shihet si kërcënim i domosdoshëm për identitetin fetar. Përkundrazi, sfida kryesore qëndron në harmonizimin e vlerave fetare me realitetet e botës moderne, duke ruajtur parimet themelore të fesë dhe duke qenë pjesë aktive e shoqërisë bashkëkohore.²²

Në Islam, hapja ndaj kulturave dhe popujve të tjerë nuk bie ndesh me ruajtjen e identitetit fetar. Allahu i Madhëruar thotë: *“Allahu nuk jua ndalon të silleni mirë dhe me drejtësi ndaj atyre që nuk ju kanë luftuar për shkak të fesë.”* (El Mumtehine, 8).

Ky ajet tregon se bashkëjetesa, respekti dhe drejtësia janë pjesë e mësimave islame.²³

Një rol të rëndësishëm luan dialogu ndërfaqësor, i cili ndihmon në forcimin e mirëkuptimit dhe respektit reciprok ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Kurani urdhëron: *“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë.”* (En Nahl, 125).

Ky parim vendos bazat e komunikimit konstruktiv dhe të kulturës së dialogut.²⁴

Po ashtu, edukimi fetar mbetet një element kyç në ruajtjen e identitetit islam. Brezat e rinj kanë nevojë për njohuri të argumentuara dhe të përshtatura me sfidat e kohës. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Kërkimi i dijes është obligim për çdo mysliman.”* Ky hadith tregon rëndësinë e dijes në forcimin e besimit dhe vetëdijes fetare.²⁵

Zhvillimi teknologjik paraqet gjithashtu mundësi të mëdha për përhapjen e vlerave fetare përmes platformave digjitale, ligjëratave online dhe burimeve elektronike. Megjithatë, informacioni duhet të trajtohet me kujdes dhe verifikim. Allahu thotë: *“Nëse ndonjë i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, verifikojeni atë.”* (El Huxhurat, 6).

Së fundi, ruajtja e identitetit fetar kërkon angazhim aktiv në jetën shoqërore. Besimtari duhet të kontribuojë në përhapjen e së mirës, drejtësisë dhe solidaritetit.²⁶ Allahu thotë: *“Ju jeni populli më i mirë i nxjerrë për njerëzit: urdhëroni për të mirë dhe ndaloni nga e keqja.”* (Ali Imran, 110).

Prandaj, perspektiva më e qëndrueshme për ruajtjen e identitetit fetar është ndërtimi i një besimi të vetëdijshëm, të argumentuar dhe të hapur ndaj dialogut, duke ruajtur vlerat autentike islame në kushtet e botës globale.²⁷

PËRFUNDIMI

Ruajtja e identitetit fetar në epokën e globalizimit mbetet një sfidë e rëndësishme për individin dhe shoqërinë. Studimi tregoi se fenomene, si sekularizmi, relativizmi moral dhe ndikimi i mediave, mund të ndikojnë në dobësimin e identitetit fetar, por njëkohësisht krijojnë nevojën për

forcimin e vetëdijes dhe edukimit religjioz. Familja, institucionet fetare dhe praktikimi i adhurimeve vazhdojnë të jenë faktorë kyç në ruajtjen e këtij identiteti. Po ashtu, dialogu ndërfaqësor, përdorimi i teknologjisë dhe zhvillimi i një besimi të argumentuar ofrojnë mundësi të reja për harmonizimin e fesë me botën moderne. Prandaj, ruajtja e identitetit fetar kërkon qëndrueshmëri në parime, dije dhe angazhim aktiv në shoqëri, në mënyrë që besimtari të kontribuojë pozitivisht në ndërtimin e një bote më të drejtë dhe më humane.

1 Sahihul Xhami', nr. i hadithit: 2937.

2 Anthony Giddens, *Runaway World: How Globalization is Reshaping Our Lives*, Profile Books, London, 2002, f. 18–24.

3 Muhammad Tahir-ul-Qadri, *Islam on Human Rights*, Minhaj-ul-Quran Publications, Lahore, 2010, f. 45–48.

4 Manuel Castells, *The Rise of the Network Society*, Wiley-Blackwell, Oxford, 2010, f. 407–425.

5 Muhammed b. Ahmed el Kurtubi, *El Xhami' li Ahkami'l Kuran*, Dar el Kutub el Misriyye, Kajro, 1964, vëll. 7, f. 72–74.

6 Muhamed b. Isa et Tirmidhi, *Sunen et Tirmidhi*, Dar el Garb el Islami, Bejrut, 1998, nr. 2260; Ebu'l Ala el Mubarekfuri, *Tuhfetü'l Ahvezi*, Dar el Kutub el Ilmijje, Bejrut, 1990, vëll. 6, f. 467.

7 Gary R. Bunt, *Islam in the Digital Age*, Pluto Press, London, 2003, f. 112–130.

8 José Casanova, *Public Religions in the Modern World*, University of Chicago Press, Chicago, 1994, f. 15–38.

9 Ismail ibën Kethir, *Tefsiru'l Kuran el Adhim*, Dar Tayyibah, Rijad, 1999, vëll. 3, f. 375–378.

10 Charles Taylor, *A Secular Age*, Harvard University Press, Cambridge, 2007, f. 299–321.

11 Ebu Abdullah el Kurtubi, *El Xhami' li Ahkami'l Kuran*, Dar el Kutub el Misriyye, Kajro, 1964, vëll. 16, f. 163–165.

12 Zygmunt Bauman, *Liquid Modernity*, Polity Press, Cambridge, 2000, f. 58–74.

13 Transmeton Ebu Davudi (4833), Tirmidhiu (2378) dhe Ahmedi (8398).

14 Olivier Roy, *Globalized Islam: The Search for a New Ummah*, Columbia University Press, New York, 2004, f. 24–46.

15 Jusuf el Karadavi, *El Ilmu fi'l Islam*, Mektebetu Vehbe, Kajro, 1996, f. 11–24.

16 Fahrudin er Razi, *Mefatih el Gajb*, Dar Ihja et Turath el Arabi, Bejrut, 1999, vëll. 26, f. 234–236.

17 Abdullah Nasih Ulvan, *Tarbijetu'l Evlad fi'l Islam*, Dar es Selam, Kajro, 2004, vëll. 1, f. 15–33.

18 Ismail ibën Kethir, *Tefsiru'l Kuran el Adhim*, vëll. 8, f. 167–169.

19 Muhammad Hamidullah, *Introduction to Islam*, Islamic Publications, Paris, 1980, f. 121–128.

20 Ebu Hamid el Gazali, *Ihja Ulum ed Din*, Dar el Ma'rife, Bejrut, vëll. 1, f. 295–312.

21 Muhammed b. Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, Kitabu'd Daavat, nr. 6407.

22 Peter L. Berger, *The Desecularization of the World: Resurgent Religion and World Politics*, Grand Rapids, 1999, f. 2–18.

23 Ibën Kethir, *Tefsiru'l Kuran el Adhim*, vëll. 8, f. 120–123.

24 El Kurtubi, *El Xhami' li Ahkami'l Kuran*, vëll. 10, f. 199–203.

25 Ibën Maxhe, *Sunen ibën Maxhe*, nr. 224.

26 Wahbe Zuhajli, *Et Tefsir el Munir*, vëll. 26, f. 219–223.

27 Fahrudin er Razi, *Mefatih el Gajb*, vëll. 8, f. 327–331.

Arti i përkthimit

Ejup Ramadani

Me letërsinë kisha një afërsi që nga shkollimi fillor. Libri ishte i pranishëm në shtëpinë tonë modeste të fshatit që atëherë. Në klasën e parë fillore mora dhuratë “Picimulin” e Rexhep Hoxhës dhe ishte një përjetim i rrallë.

Në atë kohë garonim me moshatarët e shkollës se kush sa romane kishte lexuar. Ishte shumë normale që ne të dilnim me dele në livadhe dhe nën sjetull të kishim një libër.

Mësimet universitare i fillova në Kajro. Një botë dhe ambient krejt tjetër. Kujtoj se si atje, në rrugë për në fakultet, domosdoshmërisht ndaleshim në Atebe, ku shiteshin libra të rinj dhe të vjetër.

Filluam të lexonim dhe të grumbullonim informacione. Shumë herët kuptuam se në Egjipt ishte një shkrimtar i madh në mesin e shumë shkrimtarëve të njohur, Taha Husein, me dy tituj doktorate; një në El Ez’her dhe një në Sorbonë, e që ishte i verbër. Ai, madje, e kishte marrë titullin “Shtylla e letërsisë arabe”.

Kjo ma zgjoi kureshtjen tejmasë. Ende pa i marrë këmbët mirë, fillova ta lexoj “El Wae’dul Hak”, nga po ky shkrimtar. Ai fliste për personalitete të veçuara të historisë islame me pendën e një shkrimtari. Kjo më bëri shumë përshtypje. Fillon, për shembull, me Jasirin, dëshmorin e parë nga grupi i vogël që i besonte Muhamedit a.s. Një

Libri ishte i pranishëm në shtëpinë tonë modeste që nga fëmijëria dhe u bë udhërrëfyesi im në rrugën e dijes.



varfanjak dhe burrë i pavërejtur në Mekë, por i paluhatshtëm në besimin e tij.

Në vazhdim, shkrimtari flet për El Habeshijen, e cila ishte një princeshë dhe kishte ardhur në Mekë me suitën e Ebrehas, mbretit të Abisinisë, për ta shkatërruar Qabenë. Por Qabeja nuk shkatërrohet. Tempulli është nën mbrojtjen hyjnore. Në vend të saj, u shkatërrua ushtria e Ebrehas dhe pjesëtarët e saj u shkapërderdhën gjithandej. Princesha u has në rrugë nga një beduin, i cili, për ta poshtëruar atë, e martoi me robin e tij, Rabahun.

Pas një kohe, ata u martuan dhe u lindi Bilali, myezini i parë në Islam. Ai edhe u quajt Bilal el Habeshij.

Dikur i hyra ta përkthej. Doli “Premtimi”, të cilin e botoi Logosi në vitin 2014.

Në Kajro, madje, në vitet e para, më kujtohet ta kem lexuar një libër, i cili bënte fjalë për tre burra palestinezë, që kishin vendosur të shkonin në Kuvajtin fqinj për të siguruar bukën për familjet e tyre në vendin e okupuar.

Ata bien në duar të një matrapazi, i cili ishte irakian dhe voziste një cisternë uji nga Iraku në Kuvajt. Vozitësi mjeran, për të fituar ca para më shumë me pak mund, mendon që t’i kontrabandojë këta tre hallexhinj, duke i marrë pranë vetes deri

Përkthimi nuk është vetëm bartje e fjalëve nga një gjuhë në tjetrën, por urë që lidh kulturat dhe e sjell dijen më pranë lexuesit.


afër kufirit. Ndërsa, në momentin kur ata afrohen pranë kufirit, vozitësi e hap cisternën e hekurt, në muajt e vapës, në mes të shkretëtirës, duke menduar se kufiri kalohet shpejt. Por gjërat nuk shkojnë gjithherë ashtu siç mendon njeriu. Të tre burrat piqen brenda cisternës së hekurt dhe vozitësi largohet nga kufiri për t’i varrosur tre të ngratët në shkretëtirë.

Tregim prekës dhe tmerrues, do të thosha. Koha kalonte dhe bota filloi të ndryshonte edhe këndej pari. Regjimi i hekurt dhe vrastar i Millosheviqit filloi të mos zgjidhte metoda për të eliminuar djem të rinj shqiptarë. Ata filluan të mendonin të iknin kuturu. Ishte kjo koha kur e kujtova rastin e tre burrave palestinezë, të cilët, në ikje e sipër, përfunduan të pjekur në cisternë, në mes të vapës, e pastaj përfunduan në varre.

Në vitin 2015, Koha e botoi romanin e shkrimtarit të njohur palestinez, Gassan Kanafanit, “Burrrat në diell”.

Në vitin 2016, Koha gjithashtu e botoi romanin e Nexhib Mahfuzit, nobelistit të vetëm arab, “Rrëfimi i një nate”.

Në vitin 2019, Shtëpia Botuese Buzuku e botoi “Kusarin”, nga autori katarian Abdul Aziz al Mahmud, të cilin e përktheva me propozimin e profesor Muhamed Mufakut, shkrimtar dhe publicist shqiptaro-sirian.



Në vitin 2020 e përktheva “Kafeneja el Karnek”, një libër i vogël nga Nexhib Mahfuzi, por me stil të lartë narrativ, ku përshkruhen të metat e sistemit shoqëror, i cili fillon mirë, por devijon dhe, si pasojë, populli vuan në të gjitha nivelet.

Duke lexuar dhe zgjeruar horizontin e temave, mbi të cilat njeriu ngel në kërkim të asaj që i pëlqen e që mund të jetë tërheqëse për lexuesit, një temë më kishte intriguar që moti, e ajo ishte kalimi i myslimanëve në Andaluzi, në kohën e komandantit të asaj ushtrie, Tarik bin Zijadit, i cili, në vitin 711 të erës sonë, në krye të një ushtrie, e kaloi ngushticën e Gjibraltarit dhe doli në tokën e Iberisë – Spanjë.

Tarik bin Zijadi iu drejtua ushtarëve me fjalët: “Para jush është armiku dhe mbrapa e keni detin”. Ai i fundosi anijet dhe të gjithë u bindën se ai e kishte me gjithë mend. Që atëherë, Andaluzia lulëzoi dhe u qeveris nga myslimanët – herë mirë e herë jo edhe aq mirë – deri në vitin 1609, kur princi Buabdilla i dha lamtumirën e fundit Andaluzisë.

Librin “Islami në Andaluzi” të autorit anglez Ahmad Thomson e botoi BIK-u, i përkthyer në vitin 2022.

Paralelisht me ndjenjën e Andaluzisë ishte edhe Vjena e Habsburgëve, të cilën e sulmoi gjenerali Osman Mustafa dhe në pushtimin e së cilës dështoi.

Në vitin 2023 e përktheva “Rrethimi i Vjenës” nga John Stoye dhe e botova privatisht. Një libër interesant dhe shumë objektiv, por i pafat.

Në vitin 2023, BIK-u gjithashtu e botoi librin për Mehmet Ali Pashën e Egjiptit, me autor historianin egjiptian Halid Fehmi. Ai shkoi në Kembrixh për të doktoruar në histori dhe universiteti i dha temën për Pashën e Egjiptit. Autori punoi për dhjetë vjet, duke shfletuar të gjitha luftërat dhe betejat e zhvilluara, derisa Mehmet Ali Pasha u bë vali i Egjiptit në kuadër të Perandorisë Osmane, por pastaj ai u mëvetësua dhe dinastia e familjes së tij vazhdoi deri te mbreti Faruk, i fundit, kur në vitin 1952 oficerët e lirë, në krye me Xhemal Abdunaserin, e përmbysën mbretërinë një herë e mirë.

Libri është voluminoz, ka 514 faqe dhe mbi 200 referenca.

Në vitin 2024, në bashkautorësi me kolegun tim, z. Resul Rexhepin, përkthyem librin e shkruar nga vetë ish-kryetari i Egjiptit, Enver el Sadat, “Në kërkim të identitetit – Rrëfimi i jetës sime”.

Tarik bin Zijadi iu drejtua ushtarëve me fjalët: “Para jush është armiku dhe mbrapa e keni detin”. Ai i fundosi anijet dhe të gjithë u bindën se ai e kishte me gjithë mend.

Libri përshkruan tërë fëmijërinë e autorit dhe historinë e Egjiptit. Theks të veçantë libri i kushton luftës së vitit 1973 për t’i rimarrë territoret e pushtuara nga Izraeli në luftën e vitit 1967.

Pastaj kemi ndaljen e luftimeve me presion ndërkombëtar dhe fillimin e bisedimeve. Ato ishin të gjata dhe të mundimshme, e që përfunduan me vizitën e Sadatit në Izrael në nëntor të vitit 1977 dhe me nënshkrimin e një marrëveshjeje paqeje.

Në vitin 2025, BIK-u e botoi librin e Ali Koses “Pse e pranova Islamit”. Ai është një shkencëtar nga Turqia, i cili i bëri studimet e doktoratës në Kembrixh të Anglisë. Ai u orientua drejt një teme shumë interesante; mori një grup të konvertuarish të rinj, të moshave dhe gjinive të ndryshme, dhe hulumtoi shkaqet e konvertimit. Edhe ky libër është shkencor, i shkruar me parametra universitarë dhe me dëshmi e fakte, me emra dhe adresa të të intervistuarve.

Libri ka një pasthënie nga dr. Pajazit Nushi, i cili, me pak fjalë, i jep librit peshën e duhur.

Së fundi, kam përkthyer dy libra nga autorë arabë për dy personalitete shumë të afërta me Muhamedin a.s.:

– “Bilali”, myezini i tij, i cili ishte me ngjyrë dhe rob, por që Muhamedi a.s. e deshi shumë, me autor Abdulhamid Essahari;

– “Fatimeja, bija e Muhamedit a.s.”, me autorë Omer ebu Nari dhe Ahmad Thomson, një grua të cilën Muhamedi a.s. e deshi shumë qysh në fëmijëri.

Marrja ime me përkthime nga gjuha arabe dhe angleze e disa titujve librash me peshë për historinë e Islamit dhe të popujve arabë, përveçse më flinte në mendje si gjini letrare, këtë “zanat” ma bëri të mundur, pa asnjë dyshim, studimi i këtyre dy gjuhëve botërore në Universitetin El Ez’her në Kajro, si dhe në Universitetin Amerikan, po në Kajro, gjë për të cilën e falënderoj Zotin e Madhërishëm, që ma bëri të mundur t’i ofroj opinionit shqiptar disa libra tejet të rëndësishëm, të përkthyer në gjuhën shqipe nga autorë me nam botëror.

Uroj që, sado pak, ta kem përmbushur një pjesë të vogël të obligimit intelektual, që lexuesi ynë në Kosovë ta ketë mundësinë t’i lexojë dhe t’i studiojë këto vepra në të ardhmen!

Mësimdhënia e hadithit në periudhën e fundit të medreseve në Perandorinë Osmane

Blerton Bahtiri

Në periudhat e fundit të Perandorisë Osmane, lëndët e metodologjisë së hadithit u përfshinë në programet e medreseve profesionale dhe të specializuara, si dhe në disa shkolla të krijuara për qëllime të ndryshme.

EVOLUCIONI HISTORIOGRAFIK I MEDRESEVE TË HADITHIT NË PERIU DHËNË OSMANE

Në Perandorinë Osmane, medresetë e hadithit treguan zhvillim të shpejtë, si në numër, ashtu edhe në cilësinë e arsimit, deri në fund të periudhës së stagnimit. Me kalimin e kohës, janë kërkuar mënyra për t'i ristrukturuar këto institucione dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit, si dhe janë përpjekur të futen zgjidhje radikale. Me këto përpjekje u hartuan projekte shumë të rrënjësura dhe të bukura, por gjendja e shtetit

nuk lejoi që të arriheshin rezultatet e pritura nga ndryshimet e bëra.

Në periudhat e fundit të Perandorisë Osmane, lëndët e metodologjisë së hadithit u përfshinë në programet e medreseve profesionale dhe të specializuara, si dhe në disa shkolla të krijuara për qëllime të ndryshme. Ashtu si në periudhën para fillimit të funksionimit të medreseve si institucione arsimore formale, mësimi i hadithit vazhdoi në xhami, si dhe në shumë medrese dhe daru'l-hadithe, në të cilat mësimi i hadithit ofrohej në Perandorinë Osmane. Megjithatë, mund të thuhet se rezultati i dëshiruar nuk u



arrit plotësisht, sepse ky aktivitet nuk u zhvillua drejtpërdrejt me synimin e rritjes së nivelit të njohurive fetare dhe kulturore të popullit, si dhe me një metodë e program të përshtatshëm për këtë qëllim.

Në Perandorinë Osmane, mësimi i hadithit vazhdoi në medrese, të cilat ishin institucione arsimore formale, si dhe në xhami, që përdorshin për arsimim joformal. Duke parë praktikën në atë periudhë, mund të argumentohet se një rëndësi e veçantë i kushtohej mësimi të hadithit. Sepse, ashtu siç jepeshin mësimet e hadithit në medrese me programe të përgjithshme, kishte edhe shkolla daru'l-hadith të themeluara vetëm për qëllimin e mësimi të hadithit. Në fakt, gjatë periudhës së zhvillimit, në mesin e institucioneve arsimore, shkolla e hadithit Sulejmanije zinte vendin e parë ndër institucionet e arsimit të lartë për nga statusi. Megjithatë, Perandoria Osmane përjetoi periudha të krijimit politik, ngritjes, stagnimit dhe rënies; është e mundur të ndiqet një kurs paralel edhe në fushën e edukimit dhe trajnimit.

Ndër arsyt e stagnimit dhe rënies së Perandorisë Osmane mund të renditen shumë faktorë, si pamjaftueshmëria e administratorëve, bllokimi i sistemit, pamundësia për të vazhduar me strukturën sociologjike dhe risitë, të cilat nuk do të detajohen këtu. Por është e pamundur të anashkalohet fakti se stanjacioni dhe regresioni në fushën e arsimit dhe formimit zënë një vend të rëndësishëm në të gjitha këto. Madje, kjo rënie e arsimit u përjetua jo vetëm në fushën e shkencës dhe shkencave shoqërore, por ndoshta edhe më shumë në fushën e shkencave fetare. Feja islame inkurajon diturinë dhe studimin dhe dënon ashpër injorancën dhe dembelizmin. Islami përpiket t'i drejtojë njerëzit dhe shoqërinë drejt shkencës si asnjë religjion apo sistem tjetër filozofik; nëse një shoqëri është në prapambetje shkencore, kjo do të thotë se njerëzit që e përbëjnë atë shoqëri kanë probleme në të mësuarit dhe në të kuptuarit e vlerave fetare që duhet t'i dinë së pari. Prandaj, nuk do të ishte gabim të thuhet se ndër arsyt e prapambetjes shkencore, para së gjithash, prapambetja në fushën e shkencave fetare është e para. Duke e kuptuar këtë fakt, disa qarqe shkencore dhe administratorë të periudhës donin t'i hapnin rrugën tejkalimit të bllokimit duke

Gjatë periudhës së zhvillimit, në mesin e institucioneve arsimore, shkolla e hadithit Sulejmanije zinte vendin e parë ndër institucionet e arsimit të lartë për nga statusi.

ristrukturuar institucionet arsimore dhe, për këtë qëllim, përgatitën dhe zbatuan programe alternative. Edhe pse me vonesë, programi që është zbatuar është një nismë vërtet e jashtëzakonshme dhe e denjë për vlerësim. Informacionet për detajet e programit mund të gjenden në botime zyrtare dhe private të asaj periudhe, si dhe në disa vepra të shkruara në fushën e historisë së arsimit. Ne do të përpiqemi të vlerësojmë mësimin e hadithit të përfshirë në këtë program.

MËSIMDHËNIA E HADITHIT NË MEDRESE

Para osmanëve, mësimi i hadithit ofrohej edhe në medrese të tjera, përveç daru'l-haditheve. Në fakt, u bë traditë krijimi i katedrave të hadithit në disa medrese. Sipas deklaratës së Nexhmudin el Gajtiti, Bejbarsit caktoi një karrige për shkencën e hadithit në medresenë që ai themeloi. Shembullin e tij e ndoqën edhe institucionet e tjera të medreseve. Kjo metodë u ndoq edhe te osmanët.¹ Në mbishkrimin e Medresesë Ahmedije të ndërtuar në Üsküdar të Stambollit më 1711/1123; "*Lexo fenë shkencore, fikh dhe faraid, Ehadiith-i Nebi Tefsir-i Kur'an*".² Sipas këtij mbishkrimi, lënda e hadithit duhet të përfshihej në planprogramin e medresesë. Për më tepër, hadithi mësohej në medresetë që u ndërtuan dhe filluan të jepnin mësim para datës së përmendur. Ibën Meleku, i cili shkroi një koment për veprën e quajtur *Meshariku'l-Envar*, me emrin *Mebariku'l-Ezhar*, e lexoi komentin e tij si libër shkollor në medresenë e rrethit të Tirit të Izmirit.³

Nga biografitë e disa dijetarëve kuptohet se mësimi i hadithit përfshihej pothuajse në çdo nivel të medreseve osmane. Në vitin 933/1527, Taşköprizâde u emërua në Medresenë Hacı Hasan⁴, një medrese me të tridhjetat, dhe i mësoi (lexoi) Mesabihun nga hadithi dy herë deri në vitin 936/1530.⁵ Në vitin 936/1530, Taşköprizâde u emërua në Medresenë Is'hak Pasha në Shkup, një medrese e kategorisë së dyzet akçeve, ku e lexoi të gjithë Mesabihun dhe Mesharikon në këtë medrese deri në vitin 1536/942. Taşköprizâde, i cili u emërua në Medresenë Kalenderhane, me gradën dyzet akçe, në Stamboll më 942/1536, mësoi hadithin dhe Mesabihun që nga fillimi në Kitabu'l-Buju derisa u emërua në Medresenë Mustafa Pasha më 944/1547. Pas kësaj, kur u emërua në Medresenë


“Koca Mustafa Pasha”, e cila kishte gradën pesëdhjetë akçe, ai lexoi Mesabihun nga Kitabu'l-Buju deri në fund.

Në vitin 945/1539, Taşköprizade, i cili u emërua në njërën nga Medresetë Üç Şerefeli të Edrenesë me gradën pesëdhjetë akçe, u ngarkua të lexonte vëllimin e parë të *Sahihut të Buhariut* nga hadithi gjatë pesë muajve që qëndroi atje. Ai u emërua në njërën nga medresetë Sahn-ı Seman në vitin 946/1539. Gjatë mandatit të tij pesëvjeçar, ai e përfundoi *Sahihun e Buhariut* nga hadithi dy herë. Ai u emërua si mësues i avancuar në vitin 951/1544 dhe dha një të tretën e *Sahihut të Buhariut* në Medresenë Sulltan Bejazid të Edrenesë, e cila kishte status gjashtëdhjetë akçe, ku shërbeu për një vit.

Pas kësaj, Taşköprizade u emërua gjykatës i Bursës në vitin 1545/952. Ai u shkarkua pasi qëndroi në këtë detyrë për dy vjet. Taşköprizade, i cili u emërua mësues i Sahn-ı Semanit për herë të dytë në vitin 954/1547, e lexoi të gjithë *Sahihun e Buhariut* nga hadithi gjatë emërimit të tij të dytë.⁶

Siç u pa më lart, shkenca e hadithit, e mësuar në të gjitha nivelet e institucioneve ekzistuese arsimore, ishte një nga lëndët kryesore në programet e medreseve. Madje, ajo u inkurajua nga shteti aq sa u dekretua që të jepej si fillim i të gjitha kurseve në medresetë Sahn-ı Seman, të cilat ishin ndër institucionet që ofronin arsim në nivelin më të lartë të periudhës. Në fakt, Fatih Sulltan Mehmeti shkroi deklaratat e mëposhtme në statutin e themelimit të Sahn-ı Semanit: “U vendos që, nëse çdo mësues citonte disa hadithe nga *Mesabihu* dhe *Meshariku*, ose nga *Buhariu* dhe *Muslimi*, dhe thoshte ‘badehu’, mësimi do të fillonte pasi të lexoheshin disa hadithe dhe të shënoheshin ato në fillim të mësimit.”⁷ Vendi i mësimeve të hadithit në kurrikulë nuk kufizohej vetëm me kaq, dhe ato mësoheshin edhe si mësim i veçantë në sahn-ı seman.

Mësimi i hadithit ofrohej edhe në medrese të tjera në Anadoll. Shihet se kurset e hadithit ishin përfshirë në programin mësimor të medreseve të tjera, veçanërisht në qytetet që nuk kishin daru'l-hadithe të pavarura. Sejjahe i njohur i udhëtimeve, Evlija Çelebi, vëren se nuk ka asnjë medrese me statusin e Daru'l-



Në shekujt e mëvonshëm, medresetë humbën funksionet e mëparshme shkencore, si në aspektin shkencor ashtu edhe në atë administrativ.

Hadithit në qendra si Kajseri,⁸ Bitlis⁹ dhe Harput,¹⁰ por mësimi i hadithit është kryer në medrese të tjera. Siç mund të kuptohet nga këto përcaktime, mësimi i hadithit dhe aktivitetet të tjera kryheshin gjatë periudhës kur arsimi vazhdonte normalisht në medresetë osmane dhe zhvilloheshin së bashku me mësimet e tjera. Për shembull, në shekullin XVIII, Dervish Ali ibën Muhamedi (v. 1135/1732), një nga dijetarët e shekullit XVIII, mësoi librin *Meshariku'l-Envar* dhe komentet e tij në Medresenë Karahisar.¹¹

Medresetë, të cilat njiheshin për ofrimin e shërbimeve të suksesshme për një periudhë të caktuar në aspektin e strukturës administrative dhe cilësisë së mësimdhënies, vazhduan të përkeqësoheshin që nga periudha e stagnimit deri në periudhat e fundit të Perandorisë Osmane. Është dëshmuar se disa njerëz, si

nga klasa e studiuesve, ashtu edhe nga burokracia shtetërore, të cilët besuan në nevojën për zgjidhjen e kësaj situatë, bënë një punë serioze për të ndaluar përkeqësimin dhe për ta kthyer atë në një gjendje më të mirë.

Në këtë kontekst, u bënë përpjekje për korrigjimin e gjendjes së dëmtuar të medreseve përmes rregulloreve reformuese të nxjerra herë pas here. Më në fund, një program i ri, i konsideruar si reforma e parë radikale në medrese, u nxor në vitin 1328/1910. Sipas këtij programi, periudha e shkollimit në medrese u përcaktua dymbëdhjetë vjet. Kursi i hadithit, në kuadër të programeve kurrikulare, fillonte në klasën e tetë.

- Viti: (Klasa), Hadithi, Usuli Hadith
VIII. Meshariku'l- Envar Usuli Hadith
IX. Meshariku'l-Envar Usuli Hadith
X. Meshariku'l-Envar Usuli Hadith
XI. Buhari apo Muslim Usuli Hadith
XII. Buhari apo Muslim Usuli Hadith

PROCEDURA E HADITHIT

Nuk thuhet se cili libër do të ndiqet në metodologjinë e hadithit, por, duke qenë se ndër librat e përpiluar janë *Meshariku'l-Envar* në hadith dhe *Elfijeja e Ibn Salahut* në metodologjinë e hadithit, mund të kuptohet se “Elfijeja” ndiqet në metodologjinë e hadithit.

Kuptohet se ky program ishte i vlefshëm deri në themelimin e sistemit të ri të medreseve në vitin 1914. Gjatë kësaj periudhe, medresetë pësuan ndryshime të mëdha për sa i përket statuteve dhe programeve.

MËSIMI I HADITHIT NË MEDRESETË DARU'L-HILAFE

Në shekujt e mëvonshëm, medresetë humbën funksionet e mëparshme shkencore, si në aspektin shkencor ashtu edhe në atë administrativ.¹² Nuk mund të thuhet se përpjekjet për reforma me kalimin e kohës i kanë sjellë medresetë në gjendjen e tyre fillestare.¹³

Duke qenë se shumë njerëz të interesuar për këtë temë menduan se kjo do të kontribuonte në reformimin e medreseve, ata

Reformat e vërteta në medrese u iniciuan në kohën e shejhlul islam Mustafa Hajri Efendiut dhe emri i institucionit arsimor të krijuar në sistemin e ri ishte Medreseja Daru'l-Khilafeti'l-Alije. Periudha e arsimit ishte dymbëdhjetëvjeçare dhe ishte planifikuar të realizohej në tri faza: 4+4+4.

ofruan sugjerime të ndryshme dhe, në bazë të tyre, u hartuan plane paraprake. Më në fund, reformat e para zyrtare në medrese u bënë më 30 janar 1910 (3 sefer 1328) dhe u vunë në fuqi me një ceremoni. Lëndët e hadithit të përfshira në kurrikulën e këtij programi u shpjeguan më lart.

Për të kryer reforma në medrese, prioriteti i parë duhet të jetë sigurimi i një niveli të mjaftueshëm shkencor të stafit mësimdhënës që do të punojë në këto institucione. Para se të hynin në fuqi medresetë Daru'l-Hilafe më 1 shtator 1914, u vendos që të hapej “Medresetu'l-Mutehassisin”, e cila do të ofronte arsimim përtej nivelit të medresesë, por ky institucion nuk mundi të fillonte veprimtarinë arsimore.

Reformat e vërteta në medrese u iniciuan në kohën e shejhlul islam Mustafa Hajri Efendiut dhe emri i institucionit arsimor të krijuar në sistemin e ri ishte Medreseja Daru'l-Khilafeti'l-Alije. Periudha e arsimit ishte dymbëdhjetëvjeçare dhe ishte planifikuar të realizohej në tri faza: 4+4+4. U vendos që të hapej një Medresetu'l-Mutehassisin në krye të këtij sistemi arsimor me tri faza dhe reforma e saj u përfshi në Rregulloren e Medarise.

1 Tayyib Okç, *Bazı hadis Mesaleleri Üzerine Tetkikler*, İstanbul 1959, f. 107.

2 Konyalı İbrahim Hakkı, *Abideleri ve Kitabeleriyle Üsküdar Tarihi*, İstanbul 1997, vëll. II, f. 287.

3 Sadık Cihan, *Osmanlı Devrinde Türk Hadiscileri Tarafından Yazılan Usulü Hadis Eserleri, Risaleleri ve Nuhbetü'l-Fiker Üzerine Yapılan Şerh ve Tercümeler*, Atatürk Üniversitesi İslami Bilimler Fakültesi Dergisi, Erzurum 1976, Sy. 1, f. 129.

4 Atai'ye göre Hüseyinzade Medresesi, Shih. Nev'izade Atallah b. Jahja Atai, *Hadikatu'l-Hakajik fi Tekmilati'sh-Shakajik*, İstanbul, 1298, f. 8.

5 Mehmed Mexhdi, *Tercemei Shakajik*, İstanbul, 1269, f. 525.

6 Ibid, f. 525-526.

7 Süheyl Ünver, *Fatih Külliyesi ve Zamanı İlim Hayatı*, İstanbul, 1946, f. 125.

8 Evlija Çelebi, *Sejehatname*, (I-X), İstanbul, 1314-1938, vëll. III, f. 179.

9 Ibid, vëll. IV, f. 91

10 Ibid, vëll. III, f. 218.

11 Sadık Cihan, *Osmanlı Devrinde Türk Hadiscileri Tarafından Yazılan Usulü Hadis Eserleri, Risaleleri ve Nuhbetü'l-Fiker Üzerine Yapılan Şerh ve Tercümeler*, f. 129.

12 Raşid Efendi, *Raşid Tarihi*, İstanbul, 1282, vëll. II, f. 361.

13 İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Devleti'nin İlmiye Teşkilatı*, T.T.K. Yay. Ankara, 1965, f. 254.

Shtypi islam shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit XX

MA. Fatlum Nika

Edhe në periudhat më të vështira politike, shtypi islam shqiptar mbeti mbrojtës i fesë, kulturës dhe identitetit kombëtar.

KONTEKSTI POLITIK DHE FETAR I SHTYPIIT ISLAM SHQIPTAR PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, situata e fesë dhe e institucioneve fetare shqiptare ndryshoi në mënyrë të ndjeshme. Në territoret e banuara nga shqiptarët, veçanërisht në Republikën Popullore të Shqipërisë dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, por edhe në zonat shqiptare të Çamërisë brenda shtetit grek, ushtrimi i besimit fetar, mirëmbajtja e institucioneve të kultit, edukimi fetar dhe botimi i literaturës fetare u përcaktuan nga

rrethanat politike dhe zhvillimet shtetërore të kohës.

Në vendet ku u vendos sistemi komunist, lufta kundër fesë mori karakter institucional dhe politik. Në Republikën Popullore të Shqipërisë, kjo politikë u zhvillua në mënyrë veçanërisht të ashpër, duke synuar fillimisht dobësimin e, më pas, eliminimin e ndikimit fetar në shoqëri. Në Jugosllavi, ndonëse ekzistonin disa hapësira më të kufizuara për ushtrimin e fesë, politika ndaj shqiptarëve lidhej edhe me proceset e kontrollit politik dhe me përpjekjet për kufizimin e identitetit të tyre kombëtar.



Në Shqipëri, lufta kundër fesë u shndërrua në një fushatë të organizuar shtetërore. Ajo arriti kulmin me mbylljen dhe shkatërrimin e shumë institucioneve fetare, përfshirë xhamitë.¹ Një pjesë e këtyre monumenteve kishin edhe vlera historike e kulturore.² Përveç dëmtimit të trashëgimisë arkitekturore, u humbën edhe shumë dokumente, dorëshkrime dhe materiale të rëndësishme historike, të cilat u vlerësuan vetëm mbi bazën e karakterit të tyre fetar. Kjo periudhë u shoqërua edhe me krijimin e institucioneve simbolike të propagandës ateiste, siç ishte Muzeu Ateist, i cili synonte zëvendësimin e besimit fetar me ideologjinë komuniste.³

Një situatë e veçantë paraqitej në Çamëri, ku popullsia shqiptare myslimane jetonte brenda kufijve të shtetit grek. Edhe pse Greqia kishte një traditë shtetërore të lidhur ngushtë me fenë ortodokse, botimet fetare islame në gjuhën shqipe praktikisht nuk kishin mundësi zhvillimi. Kjo lidhej me frikën se përdorimi i gjuhës shqipe dhe ruajtja e identitetit islam mund të forconin organizimin kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve myslimanë të kësaj zone. Si pasojë, komuniteti çam u privua nga një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë kulturore dhe fetare në gjuhën amtare.

Përballë këtyre kufizimeve, zhvillimi i shtypit islam shqiptar u bë i mundur kryesisht në diasporë dhe në disa territore të Jugosllavisë, ku jetonte një numër i madh shqiptarësh myslimanë me tradita të konsoliduara fetare. Në këto hapësira, duke shfrytëzuar mundësitë ekzistuese ligjore dhe institucionale, u krijuan disa botime periodike që shërbyen për ruajtjen e lidhjeve fetare, kulturore dhe identitare të komuniteteve shqiptare.

Fillimet e rëndësishme të shtypit islam shqiptar pas luftës lidhen me diasporën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1950, në Detroit, filloi botimin revista fetaro-kulturore “Jeta muslimane shqiptare”, e cila ishte organ i shoqërisë myslimane shqiptare dhe drejtohej nga Imam Vehbi Ismaili, një figurë e njohur në fushën e publicistikës fetare. Në drejtimin e saj morën pjesë edhe R. Xh. Gurazezi dhe Ahmet Ramo. Revista botohej tri herë në vit dhe karakterizohej nga një paraqitje teknike moderne dhe një përmbajtje e gjerë tematike.

Ajo botohej në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, duke pasqyruar nevojat e komunitetit shqiptar në shoqërinë amerikane. Përveç artikujve fetarë, revista përfshinte edhe trajtime historike dhe kulturore, gjë që i dha asaj një karakter më të gjerë shkencor. Në këtë mënyrë, “Jeta

Revistat dhe gazetat islame nuk ishin vetëm botime fetare, por edhe qendra të ruajtjes së kujtesës historike dhe të vetëdijes kombëtare shqiptare.

muslimane shqiptare” luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e identitetit fetar dhe kulturor të shqiptarëve në Amerikë.⁴ Ajo dëshmonte ekzistencën e një bashkësie islame shqiptare të organizuar dhe të aftë për t’i ruajtur traditat e saj në një mjedis shoqëror të ndryshëm nga ai shqiptar.

Diaspora islame shqiptare në ShBA e vazhdoi veprimtarinë botuese edhe në vitet pasuese. Një tjetër botim i rëndësishëm ishte revista “Përpjekja jonë”, e cila filloi të botohej në vitin 1971.⁵ Kjo revistë doli në gjuhën shqipe dhe angleze, kishte një paraqitje të pasur dhe synonte forcimin e lidhjeve kulturore dhe fetare të shqiptarëve në diasporë. Ajo botohej nga Këshilli i Qendrës Islame Shqiptaro-Amerikane dhe drejtohej nga Qamil Muja. Këto botime të diasporës përbënin një nga format kryesore të ruajtjes së traditës së shtypit islam shqiptar gjatë një periudhe kur, në trojet shqiptare, veprimtaria fetare dhe botuese ishte e kufizuar nga rrethanat politike.

ZHVILLIMI I SHTYPIT ISLAM SHQIPTAR NË KOSOVË DHE NË HAPËSIRAT JUGOSLLAVE

Pas përvojës së parë të botimeve islame shqiptare në diasporë, zhvillimi i shtypit periodik islam në gjuhën shqipe mori një rëndësi të veçantë edhe në hapësirat e ish-Jugosllavisë, veçanërisht në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Në këto territore jetonte një numër i madh shqiptarësh, shumica e të cilëve ruanin traditat fetare islame dhe kërkonin forma të organizuara për ruajtjen e identitetit të tyre fetar dhe kulturor.⁶ Në Kosovë, një nga përpjekjet e para për krijimin e një shtypi islam në gjuhën shqipe u realizua në vitet 1960 nga Shoqata e Ulemave në Prishtinë. Ky institucion botoi “Buletin informativ”, i cili doli në dy gjuhë: shqip dhe serbokroatisht. Megjithatë përmbajtja e tij ishte e kufizuar, botimi i tij kishte rëndësi të veçantë, sepse hodhi bazat për zhvillimin e mëvonshëm të periodikëve islamë shqiptarë.⁷

Ky buletin u pasua nga një seri botimesh të tjera që ndikuan në konsolidimin e shtypit islam në Kosovë. Ndër botimet më të rëndësishme që u botuan më vonë përfshihen “Takvim – Kalendar”, “Edukata Islame”, “Nur-ul-Kur’an”, “Dituria Islame”, si dhe botime të tjera të karakterit fetar dhe kulturor. Këto revista nuk kishin vetëm funksion fetar, por shërbyen edhe si hapësira për trajtimin e historisë, kulturës dhe çështjeve shoqërore shqiptare.⁸

Një nga botimet më të hershme dhe më të qëndrueshme ishte “Takvim – Kalendar”, i cili filloi të botohej në Shkup

Nga diaspora
deri në
Kosovë,
Maqedoni,
Mal të Zi e
Shqipëri,
shtypi islam
shërbeu si urë
që lidhi fenë,
kulturën dhe
kombin
shqiptar.

dhe Prishtinë. Botimi i Shkupit u realizua nga Shoqata “Ilmije” e Bashkësisë Islame të Shkupit në gjuhët turqisht dhe shqip, ndërsa ai i Prishtinës botohej në gjuhën shqipe nga Shoqata e Ulemave të Prishtinës. Edhe pse pjesa kryesore e këtij botimi përbëhej nga kalendari fetar, pjesa tjetër përmbante artikuj me karakter edukativ, fetar, historik dhe kulturor. Me kalimin e kohës, “Takvimi” mori një funksion më të gjerë, duke u shndërruar në një botim që ndikonte në ruajtjen e traditës islame dhe në ngritjen e vetëdijes kulturore të lexuesve shqiptarë. Nën drejtimin e Hajrullah Hoxhës, ky botim mori një orientim më të gjerë

kulturor. Përmes përmbajtjes së vet, “Takvimi” rikujtonte, në njëfarë mënyre, traditën e kalendareve kulturorë të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, por me një përmbajtje të ndërtuar mbi bazën e mendimit dhe kulturës islame.⁹

Gjatë viteve 1970, zhvillimi arsimor dhe kulturor në Kosovë krijoi kushte të reja për shtypin në gjuhën shqipe. Pas avancimit të arsimit laik, zhvillimit të letërsisë dhe rritjes së numrit të intelektualëve shqiptarë, u krijua nevoja që edhe shtypi islam shqiptar të merrte një formë më moderne dhe më të organizuar. Në vitin 1971 filloi të botohej revista “Edukata Islame”, organ i Këshillit të Ulemave të Prishtinës, e drejtuar nga Hajrullah Hoxha.¹⁰ Ky botim shënoi një fazë të re në historinë e shtypit islam shqiptar, sepse solli trajtime më të thelluara të çështjeve të fesë, historisë, kulturës dhe edukimit. Rritja e numrit të intelektualëve shqiptarë që kishin përfunduar studime të larta në fusha të ndryshme, përfshirë edhe studimet teologjike në qendra të ndryshme islame, ndikoi në pasurimin e këtyre botimeve. Autorë të ndryshëm filluan të trajtonin tema që lidheshin me islamistikën, historinë, kulturën dhe zhvillimet shoqërore. Në faqet e revistës “Edukata Islame” shkruan figura të njohura si Sherif Ahmeti, Nexhat Ibrahim, Bajrush Ahmeti dhe Hajrullah

Hoxha. Megjithatë, këto botime përballeshin me sfida të mëdha. Në vitin 1975 doli revista “Nur-ul-Kur’an”, organ i Shoqatës së Nxënësve të Medresesë së Prishtinës. Më vonë, ky botim mori emrin “Drita e Kur’anit”. Revista trajtonte tema nga fusha e Sheriatit, historisë islame, kulturës, letërsisë dhe edukimit. Zhvillimi i këtyre botimeve përgatiti terrenin për krijimin e një reviste më të gjerë në përmbajtje dhe më të avancuar shkencërisht. Kjo u realizua me daljen e revistës “Dituria Islame”, numri i parë i së cilës u botua në qershor të vitit 1986 nga Meshihati i Bashkësisë Islame në Prishtinë. “Dituria Islame” u shfaq si një revistë fetare, kulturore dhe shkencore.¹¹ Ajo trajtonte çështje të teologjisë islame, filozofisë, historisë dhe kulturës, duke përfshirë edhe përkthime nga literatura klasike islame. Në faqet e saj u publikuan dokumente, analiza dhe materiale historike që kishin rëndësi për studimin e pozitës së Islamit në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare. Ndërkohë, vlen të theksohet kontributi i “Diturisë Islame” gjatë periudhës së Luftës në Kosovë, ku në faqet e para pasqyrohej aktualiteti i gjendjes në Kosovë.



Një element i rëndësishëm i kësaj reviste ishte botimi i veprës së Sami Frashërit “Kamus Al-a’lam”, si dhe trajtimi i temave që lidheshin me historinë shqiptare, pozitën e gruas, kulturën dhe vetëdijen kombëtare. Artikuj të ndryshëm trajtonin edhe çështje që lidhen me identitetin shqiptar dhe marrëdhëniet ndërmjet fesë dhe kombit. Përveç Kosovës, shtypi islam në gjuhën shqipe u zhvillua edhe në Maqedoni dhe Mal të Zi, duke luajtur rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit fetar dhe kulturor të shqiptarëve. Në Maqedoni, një nga botimet më të rëndësishme ishte gazeta “El-Hilal”, e cila filloi të botohej në vitin 1987 në gjuhët shqip, turqisht dhe serbokroatisht. Ajo trajtonte tema fetare, historike dhe kulturore, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për komunitetin mysliman shqiptar. Tradita e saj u vazhduar nga gazeta “Hëna e Re”, e cila u dallua për trajtimin e çështjeve fetare, historike dhe shkencore. Përmes artikujve kushtuar historisë shqiptare, trashëgimisë islame dhe kulturës kombëtare, kjo gazetë kontribuoi në forcimin e vetëdijes kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni. Krahas saj, u botuan edhe revista “Ikre”, organ i nxënësve të Medresesë “Isa Beu”, si dhe revista kulturore islame “Nuri”, të cilat kishin për qëllim edukimin fetar dhe përhapjen e kulturës islame në gjuhën shqipe.¹²

Pas vitit 1990, edhe në Kosovë u krijuan mundësi të reja për zhvillimin e shtypit islam. Përveç revistave tashmë të njohura si “Dituria Islame”, “Edukata Islame” dhe “Takvimi”, u botuan edhe organe të tjera si “Bashkimi Paqësor”, “Drita e Kur’anit” dhe “Kompaktësia-Ittifak”. Këto botime trajtonin tema fetare, arsimore, kulturore dhe shoqërore, duke kontribuar në edukimin dhe në ndërgjegjësimin e lexuesve shqiptarë.¹³

Në Mal të Zi, zhvillimi i shtypit islam u përball me vështirësi të shumta politike dhe kulturore. Megjithatë, në fillim të viteve 1990 filloi të botohej gazeta “Elif” (Fjala), organ i Bashkësisë Islame, e cila trajtonte tema fetare, sociale dhe kulturore. Edhe pse veprimtaria e saj nuk zgjati shumë, ajo përfaqëson një përpjekje të rëndësishme për ruajtjen e traditës islame dhe identitetit kulturor të shqiptarëve në Mal të Zi. Në tërësi, shtypi islam në këto hapësira luajti rol të rëndësishëm në ruajtjen e vetëdijes fetare, kulturore dhe kombëtare shqiptare gjatë dekadave të fundit të shekullit XX.

SHTYPI ISLAM SHQIPTAR NË PERIUdhën E PAS-KOMUNIZMIT

Rënia e sistemeve komuniste në Evropën Lindore pas vitit 1990 krijoi kushte të reja për ringjalljen e jetës fetare dhe zhvillimin e shtypit islam në gjuhën shqipe. Në Shqipëri, pas dekadash kufizimesh dhe ndalimit të veprimtarisë fetare, u riorganizua Komuniteti Musliman Shqiptar, duke mundësuar rikthimin e botimeve islame.

Në këtë kontekst filloi të botohej revista “Drita Islame” (1992), e cila u bë organi kryesor informues i komunitetit mysliman shqiptar. Përmes artikujve fetarë, historikë dhe kulturorë, ajo kontribuoi në njohjen e Islamit dhe në rikthimin e trashëgimisë islame në hapësirën publike shqiptare.

Krahas saj, në Shqipëri u shfaqën edhe botime të tjera si “Shkëlqimi Islam”, “Triumfi Islam”, “Morali Islam”, “Logjika Islame” dhe “Ura e Siratit”, të cilat synonin edukimin fetar dhe kulturor të rinisë shqiptare. Zhvillimi i shtypit islam shqiptar nuk u kufizua vetëm në Shqipëri. Edhe diaspora shqiptare vazhdoi të luante rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit fetar dhe kulturor. Në këtë kuadër u botua revista “Thirrja Islame” në ShBA dhe Kanada, ndërsa revista “Vepra” u bë një burim i rëndësishëm informacioni kulturor dhe shkencor për lexuesit shqiptarë. Në Kosovë, krahas revistave ekzistuese, u botua edhe revista “Drita”, e cila trajtonte tema kulturore, artistike dhe teologjike.¹⁴

Në përgjithësi, shtypi islam shqiptar i periudhës pas-komuniste luajti një rol të rëndësishëm në edukimin fetar, ruajtjen e identitetit kulturor dhe forcimin e vetëdijes kombëtare. Përmes gazetave dhe revistave të ndryshme, ai kontribuoi në rikthimin e traditës islame në jetën publike dhe në pasurimin e kulturës shqiptare në kushtet e pluralizmit demokratik.

- 1 Roald A. Hysa, “Shkatërrimi i mendimit islam pas instalimit të regjimit komunist në vitet 1945–1967,” në *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, red. Sevba Abdula et.al., (Shkup: Balkan Studies Foundation, 2025). 29-30.
- 2 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX* (Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, 1997), 175.
- 3 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët*, 176.
- 4 Mensur Zukorlić, “Doprinos Novopazarskog zbornika (1977–1990) u afirmaciji i razvoju islamske kulture u Sandžaku,” në *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, red. Sevba Abdula et.al., (Shkup: Balkan Studies Foundation, 2025). 256.
- 5 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët*, 177.
- 6 Agon Krasniqi, “Revistat islame në kontekstin socialist (Jugosllavia dhe Shqipëria): Ndikimi dhe sfidat (1945–1990),” në *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, red. Sevba Abdula et.al., (Shkup: IDEFE Publications, 2026), 14.
- 7 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët*, 178.
- 8 Krasniqi, *Revistat islame në kontekstin socialist*, 15.
- 9 Krasniqi, *Revistat islame në kontekstin socialist*, 17.
- 10 Valmire Batatina – Krasniqi, “Roli i revistës “Edukata Islame” në komentimin dhe interpretimin e Kur’anit në Kosovë gjatë viteve 1971–1990,” në *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, red. Sevba Abdula et.al., (Shkup: IDEFE Publications, 2026), 105.
- 11 Muzaqete Kosumi, “Roli i revistës *Dituria Islame* në promovimin e rëndësishëm të fesë në jetën e njeriut (1986–1990),” në *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, red. Sevba Abdula et.al., (Shkup: IDEFE Publications, 2026), 119-120.
- 12 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët*, 179.
- 13 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët*, 180.
- 14 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët*, 182.

MYFTIU TËRNAVA U NDERUA ME MIRËNJOHJE NGA ASAMBLEJA E SHTETIT TË NJU JORKUT

Më 28 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pranuar një mirënjohje nderimi nga Asambleja e Shtetit të Nju Jorkut, më konkretisht nga Charles D. Fall, zëvendësudhëheqës i Shumicës dhe anëtar i Asamblesë së Shtetit të Nju Jorkut, i cili përfaqëson Distriktin e 61-të të Asamblesë. Kjo mirënjohje iu nda Myftiut Tërnavë për udhëheqjen e tij të jashtëzakonshme, shërbimin e shquar ndaj Republikës së Kosovës dhe komunitetit mysliman në mbarë botën, si dhe për përkushtimin e tij ndaj paqes dhe mirëkuptimit ndërfetar. Këtë mirënjohje ia dorëzoi imami, njëherësh kapelani Tahir ef. Kukaj.



Në motivacionin e kësaj mirënjohje ndër të tjera thuhet se Shkëlqesia e tij, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka shërbyer me përkushtim si Myfti i Madh i Republikës së Kosovës, duke ofruar udhëheqje të palëkundur shpirtërore për breza besimtarësh dhe duke promovuar vlerat e besimit, mëshirës, moderimit, drejtësisë dhe respektit të ndërsjellë.

Më poshtë sjellim edhe tekstin e plotë të mirënjohjes:

*Asambleja e Shtetit të Nju Jorkut
Mirënjohje (Citation)*

Në nder të Shkëlqesisë së Tij, Myftiut të Madh Naim Tërnavë

Myfti i Madh i Republikës së Kosovës

Duke pasur parasysh se, Shkëlqesia e tij, Myftiu i Madh Naim Tërnavë, ka shërbyer me përkushtim si Myfti i Madh i Republikës së Kosovës, duke ofruar udhëheqje të palëkundur shpirtërore për breza besimtarësh dhe duke promovuar vlerat e besimit, mëshirës, moderimit, drejtësisë dhe respektit të ndërsjellë; dhe

Duke pasur parasysh se, gjatë karrierës së tij të shquar, Shkëlqesia e tij i është përkushtuar forcimit të arsimit

fetar, ruajtjes së trashëgimisë së pasur shpirtërore dhe kulturore të popullit shqiptar, mbështetjes së nismave humanitare dhe nxitjes së unitetit ndërmjet komuniteteve përmes dialogut, mirëkuptimit dhe shërbimit; dhe

Duke pasur parasysh se, në shenjë vlerësimi për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në udhëheqjen fetare, studimet islame, bashkëpunimin ndërkombëtar, dialogun ndërfetar, paqen dhe shërbimin ndaj njerëzimit, Shkëlqesia e tij ka marrë shumë nderime prestigjioze mbretërore, shtetërore, presidenciale dhe institucionale, të akorduara nga mbretër, emirë, presidentë, qeveri dhe institucione të shquara në mbarë botën myslimane; dhe

Duke pasur parasysh se, përmes pjesëmarrjes së tij në forume të rëndësishme ndërkombëtare fetare, akademike, diplomatike dhe ndërfetare, Shkëlqesia e tij ka përfaqësuar me dinjitet dhe dallim Bashkësinë Islame të Kosovës, Republikën e Kosovës dhe popullin shqiptar, duke ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me udhëheqës fetarë të njohur, studiues, drejtues institucionesh mbretërore,

përfaqësues qeveritarë dhe organizata ndërkombëtare në mbarë botën; dhe

Duke pasur parasysh se, përkushtimi i tij i përjetshëm për promovimin e paqes, forcimin e komuniteteve, mbrojtjen e lirisë fetare dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet kulturave shërben si shembull frymëzues i udhëheqjes me parime dhe i shërbimit të përkushtuar ndaj publikut;

Prandaj, vendoset, që unë, Charles D. Fall, zëvendësudhëheqës i Shumicës dhe anëtar i Asamblesë së Shtetit të Nju Jorkut, që përfaqësoj Distriktin e 61-të të Asamblesë, me këtë e njoh dhe nderoj Shkëlqesinë e tij, Myftiun e Madh Naim Tërnavë, për udhëheqjen e tij të jashtëzakonshme, shërbimin e shquar ndaj Republikës së Kosovës dhe komunitetit mysliman në mbarë botën, si dhe për përkushtimin e tij ndaj paqes, mirëkuptimit ndërfetar dhe përmirësimit të njerëzimit.

Lëshuar më 15 korrik 2026.

Charles D. Fall

Zëvendësudhëheqës i Shumicës,

*Asambleja e Shtetit të Nju Jorkut,
Distrikti 61.*

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ATASHEUN PËR ÇËSHTJE FETARE TË AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Më 6 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim atasheun për Çështje Fetare të Ambasadës së Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Kadir Dinç.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë e uroi z. Dinç për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në mision e ri.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnavë e njohu atasheun me veprimtarinë, organizimin dhe angazhimet e Bashkësisë Islame të Kosovës në fushën fetare, arsimore, kulturore dhe humanitare, si dhe me projektet që BIK-u zhvillon në shërbim të besimtarëve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Ai shprehu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit të deritanishëm me institucionet përkatëse të Republikës së Turqisë, duke vlerësuar lart marrëdhëniet tradicionale të miqësisë dhe mirëkuptimit ndërmjet dy popujve.

Po ashtu, Myftiu Tërnavë, shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e



vazhdueshme që Republika e Turqisë dhe institucionet e saj u kanë dhënë Bashkësisë Islame të Kosovës ndër vite, veçanërisht në realizimin e projekteve me rëndësi për jetën fetare, arsimore dhe institucionale të BIK-ut.

Nga ana e tij, atasheu për Çështje Fetare, z. Kadir Dinç, fillimisht përcolli

selamet e kryetarit të DIJANET-it, prof. dr. Safi Arpagush, e më pas e falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen e ngrohtë dhe vlerësimin e shprehur, duke theksuar përkushtimin e tij për të vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Bashkësinë Islame të Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KMSHZ-SË, FEHIM EF. ABAZIN

Më 13 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, Fehim ef. Abazin.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë e uroi z. Abazin për marrjen e detyrës së re në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, duke i dëshiruar suksese dhe mbarësi në ushtrimin e përgjegjësisë së tij në shërbim të besimtarëve dhe të komunitetit shqiptar në Zvicër.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnavë shprehu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të thelluar dhe zgjeruar bashkëpunimin me Komunitetin Mysliman Shqiptar të Zvicrës në fusha të ndryshme me interes të përbashkët, duke theksuar rëndësinë e forcimit të lidhjeve ndërmjet institucioneve islame



shqiptare dhe koordinimit të aktiviteteve fetare, arsimore e kulturore.

Nga ana e tij, kryetari Fehim ef. Abazi falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen

dhe për urimet, duke vlerësuar rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave islame e kombëtare.

U PENSIONUA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS, AHMET EF. SADRIU

Më 1 korrik 2026, në mesin e bashkëpunëtorëve, miqve dhe familjarëve të shumtë, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame, me një ceremoni solemne u pensionua sekretari i Përgjithshëm i deritanishëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu.

Në fjalën e tij vlerësuese, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vlerësoi kontributin shumëvjeçar të sekretarit Sadriu dhënë për institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës ndër vite, fillimisht në Këshillin e BI-së së Ferizajt, e më pas edhe në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë dhe së fundmi edhe në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, fillimisht si drejtor për Botime dhe Media, e më pas edhe si sekretar i Përgjithshëm. Ai me këtë rast evokoi kujtime nga puna e përbashkët, duke vlerësuar kështu gatishmërinë, sinjeritetin dhe angazhimin e pashoq që kishte Ahmet efendiu.



Ndërkaq, ish-sekretari Sadriu, falënderoi të gjithë të pranishmit dhe bashkëpunëtorët e tij për punën dhe angazhimin e tyre përgjatë viteve të punës, duke porositur kështu gjeneratat e reja që këtë mision të shenjtë ta vazhdojnë edhe më tej me përkushtim dhe devotshmëri.

Në fund, Myftiu Tërnavë, në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, ndau një mirënjohje për ish-sekretarin Ahmet ef. Sadriu për kontributin e dhënë në udhëheqjen, ngritjen dhe avancimin e administratës së Bashkësisë Islame të Kosovës.

DEKLARATË PËR OPINIONIN E GJERË NË LIDHJE ME PUBLIKIMIN E VIDEOVE NË RRJETET SOCIALE, NË TË CILAT KEQPËRDORËT IMAZHI I MYFTIUT NAIM EF. TËRNAVA

Njoftojmë gjithë opinionin publik se videot, të cilat së fundmi po qarkullojnë në rrjetet sociale me personazhin e Myftiut Naim ef. Tërnavë, nuk pasqyrojnë realitetin dhe nuk bazohen në fakte. Këto video paraqesin pretendime të pavërteta dhe mashtruese, e si të tilla janë edhe keqpërdorim i imazhit të Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Videot në fjalë përmbajnë informacione të rreme dhe për qëllim kanë dezinformimin e publikut, prandaj u bëjmë thirrje qytetarëve dhe mediave që të mos bien pre e dezinformatave, dhe para se të shpërndajnë informacione të tilla, fillimisht t'i verifikojnë ato përmes burimeve zyrtare.

Njëkohësisht, u bëjmë thirrje mediave dhe administratorëve të platformave, në të cilat janë publikuar këto video që t'i largojnë ato menjëherë, si dhe t'i respek-



tojnë standardet profesionale të informimit.

Institucioni ynë rezervon të drejtën të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore ndaj autorëve dhe shpërndarësve të këtyre videove, në

mbrojtje të së vërtetës, integritetit institucional dhe interesit publik.

Bashkësia Islame e Kosovës

2 korrik 2026

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM LAMTUMIRËS KOORDINATOREN E TIKÀ-S NË KOSOVË, ZNJ. FULYA ASLAN

Më 6 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në një takim lamtumirës koordinatoren e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) në Kosovë, znj. Fulya Aslan, me rastin e përfundimit të mandatit të saj.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë e falënderoi znj. Aslan për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe TIKA-s gjatë periudhës së angazhimit të saj, duke vlerësuar lart kontributin e kësaj Agjencie në realizimin e projekteve me rëndësi për vendin. Në veçanti, Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që TIKA ka dhënë në restaurimin, konservimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore e fetare islame në Kosovë, duke theksuar se këto projekte kanë ndikuar në ruajtjen e identitetit historik, kulturor dhe shpirtëror të vendit, si dhe në promovimin e vlerave të përbashkëta. Ai vlerësoi gjithashtu gatishmërinë e TIKA-s për të mbështetur projekte të ndryshme në shërbim të komunitetit, duke theksuar se bashkëpunimi



ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe kësaj Agjencie ka qenë gjithmonë i bazuar në respekt të ndërsjellë, besim dhe vizion të përbashkët.

Nga ana e saj, koordinatori e TIKA-s, znj. Fulya Aslan, e falënderoi Myftiun Tërnavë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë ushtrimit të detyrës së saj në Kosovë. Ajo shprehu kënaqësinë për projektet e realizuara në partneritet me Bashkësinë Islame të

Kosovës, duke theksuar se ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare mbetet një ndër prioritetet e rëndësishme të TIKA-s.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë i uroi znj. Aslan suksese në angazhimet e saj të ardhshme profesionale, duke shprehur bindjen se marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimi ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe TIKA-s do të vazhdojnë edhe në të

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË VITISË

Më 8 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar kryeimami Vedat ef. Sahiti, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Vitisë, ku u prit nga kryetari i Këshillit, Husamedin ef. Hoxha, së bashku me administratën e këtij Këshilli.

Gjatë këtij takimi u bisedua për punën dhe aktivitetet që zhvillon Këshilli i Bashkësisë Islame i Vitisë, me theks të veçantë në organizimin e jetës fetare, si dhe zhvillimin e mësim-besimit.

Myftiu Tërnavë vlerësoi angazhimin e kryetarit, imamëve dhe administratës së Këshillit të BI-së së Vitisë, duke i inkurajuar ata që të vazhdojnë me përkushtim në shërbim të fesë dhe edukimit të brezave të rinj.



Nga ana e tij, kryetari Husamedin ef. Hoxha e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën, mbështetjen dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj Këshillit të BI-së së

Vitisë, duke e njohur më pas atë më gjerësisht me punët, projektet dhe angazhimet që po realizohen në këtë Këshill.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI OBJEKTIN E RI VAKËF TË KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME TË GJILANIT

Më 8 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga kryeimami Vedat ef. Sahiti, si dhe nga kryetari i Këshillit, Naim ef. Aliu dhe administrata e Këshillit, vizitoi objektin e ri vakëf të Këshillit të BI-së së Gjilanit, punimet e të cilit tashmë ndodhen në fazën përfundimtare.

Ky objekt është ndërtuar falë një donacioni bujar nga shteti i Katarit dhe pritet që së shpejti të funksionalizohet, duke u vënë në shërbim të nevojave fetare, arsimore dhe administrative të Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjilanit.

Gjatë vizitës, Myftiu Tërnavë u njoh nga afër me ecurinë e punimeve dhe shprehu kënaqësinë e tij për cilësinë e realizimit të projektit, duke vlerësuar se ky objekt paraqet një investim me rëndësi të veçantë për jetën institucionale dhe fetare në këtë rajon.

Në fund të vizitës, Myftiu Tërnavë uroi që punimet të përmbyllen me sukses dhe objekti të vihet sa më shpejt në funksion, në dobi të besimtarëve dhe të mbarë komunitetit. Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, pa nga afër edhe punimet në ndërtimin e Xhamisë së re në Lagjen e Spitalit.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KOMPLEKSIN “FSHATI I LUMTUR” NË GJILAN

Më 8 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga kryeimami Vedat ef. Sahiti dhe nga përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjilanit, vizitoi kompleksin “Fshati i Lumtur”, i cili së fundmi i është dhënë në shfrytëzim Bashkësisë Islame të Kosovës nga Komuna e Gjilanit, për një periudhë prej 25 vjetësh.

Gjatë vizitës, Myftiu Tërnavë u njoh nga afër me hapësirat dhe potencialin që ofron ky kompleks, duke vlerësuar rëndësinë e tij për zhvillimin e aktiviteteve edukative, fetare, kulturore dhe sociale të Bashkësisë Islame.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen e tij ndaj institucioneve



komunale të Gjilanit për besimin dhe mbështetjen e dhënë, duke theksuar se ky kompleks do të vihet në funksion të projekteve që do t'i shërbejnë interesit të përgjithshëm të qytetarëve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM IMAMIN E XHAMISË SHQIPTARE NË CYRIH, NEBIH EF. REXHEPIN

Më 17 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim imamin e Xhamisë Shqiptare në Cyrih, Nebih ef. Rexhepin, i cili ishte i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë këtij takimi u diskutua për veprimtarinë fetare e kulturore të komunitetit shqiptar në Zvicër, si dhe për rëndësinë e ruajtjes së identitetit fetar dhe kombëtar në diasporë.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë vlerësoi lart kontributin e imamëve dhe të institucioneve fetare shqiptare në mërgatë, duke theksuar rolin e tyre në forcimin e lidhjeve ndërmjet bashkatdhetarëve dhe atdheut. Ai shprehu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për thellimin e



mëtejme të bashkëpunimit me komunitetin islam shqiptar në diasporë.

Nga ana e tij, Nebih ef. Rexhepi e falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen e ngrohtë dhe shprehu përkushtimin për vazhdimin e bashkëpunimit të

ndërsjellë në projekte dhe aktivitete me interes të përbashkët, në shërbim të besimtarëve shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 20 korrik 2026, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Gjatë kësaj mbledhjeje me theks të veçantë u diskutua për parapërgatitjet për haxhin 2027, si dhe u diskutuan edhe pika të tjera të rëndësishme në bazë të kompetencave të Kryesisë së BIK-ut.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI PUNIMET NË RESTAURIMIN E RESTORANTIT TË MEDRESESË

Më 21 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi objektin e Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë, ku nga afër u njoh me ecurinë e fillimit të punimeve për restaurimin e restorantit të kësaj shkolle.

Gjatë vizitës, Myftiu Tërnavë u interesua për cilësinë dhe dinamikën



e punimeve, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projekti për përmirësimin e kushteve dhe krijimin e një ambienti sa më të përshtatshëm për nxënësit e Medresesë.

Restaurimi i restorantit paraqet një hap të mbarë në vazhden e përpjekjeve për avancimin e infrastrukturës së këtij institucioni arsimor, duke dëshmuar përkushtimin dhe gatishmërinë për të vazhduar përmirësimin e kushteve të qëndrimit, ushqimit dhe mirëqenies së nxënësve.

Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar në mbështetjen dhe zhvillimin e institucioneve të saj arsimore, me qëllim që nxënësve t'u ofrohet një mjedis sa më cilësor për edukim dhe formim.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I DEÇANIT, Z. BASHKIM RAMOSAJ

Më 22 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij është pritur në takim nga kryetari i Deçanit, z. Bashkim Ramosaj.

Gjatë këtij takimi u diskutua për çështje që e preokupojnë shoqërinë tonë, duke vlerësuar kështu përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në ruajtjen dhe kultivimin e harmonisë ndërfetare, si dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm në shërbim të qytetarëve të vendit.



Njëkohësisht, të dyja palët shprehëm qytetarëve dhe të vlerave që na bashkojnë. gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin e ndërsjellë në të mirë të

MYFTIU TËRNAVA VLERËSOI KONTRIBUTIN E AUTORIT DR. ZENEL EF. HAJDINI NË LITERATURËN EDUKATIVE FETARE PËR FËMIJË DHE TË RINJ

Më 30 korrik 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim imamin e xhamisë së Lagjes së Pajtimit në Shtime, dr. Zenel ef. Hajdini. Krahës shërbimit si imam, hatib dhe mualim, ai është dalluar si autor i suksesshëm në hartimin e teksteve edukative dhe fetare për fëmijë dhe të rinj. Gjatë dy viteve të fundit, në kuadër të Shtëpisë Botuese "Dituria Islame", ai ka botuar tri vepra: "Rruga e mirësisë", "Etika e besimtarit të ri" dhe "Ja Resulallah!". Imami Zenel ef. Hajdini e falënderoi Myftiun Tërnavë për mbështetjen e vazhdueshme dhe për besimin që veprat e tij të botoheshin nga kjo shtëpi botuese, duke theksuar se kjo përkrahje ka qenë një shtysë e rëndësishme për të vazhduar punën. Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë e vlerësoi lart angazhimin e imamit, duke theksuar se puna e tij ka plotësuar një boshllëk të rëndësishëm në fondin botues të BIK-ut. "Me këto vepra keni përmbushur një nevojë që



ka ekzistuar prej kohësh për libra edukativë të dedikuar posaçërisht fëmijëve dhe të rinjve. Vlera e tyre është edhe më e madhe sepse janë fryt i punës së një imami që është çdo ditë në kontakt me xhematin. Kjo u jep botimeve autenticitet dhe dimension praktik. Ju përgëzoj dhe ju siguroj për mbështetjen tonë të mëtejshme", tha Myftiu Tërnavë. Në shenjë respekti, imami Zenel ef. Hajdini ia dhuroi Myftiut Tërnavë tri veprat e tij me

autograf. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë i ndau atij një mirënjohje me motivacionin: "Për kontribut të veçantë në hartimin e teksteve edukative fetare për fëmijë dhe të rinj, si dhe për përkushtimin në edukimin e brezave të rinj mbi vlerat islame." Në takim ishin të pranishëm edhe drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, si dhe redaktori i Shtëpisë Botuese "Dituria Islame", Bashkim Mehani.

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS ORGANIZOI TAKIMIN E PËRVITSHËM ME BASHKATDHTARË

Më 30 korrik 2026, organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, në ambientet e Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë u mbajt takimi i përvitshëm me bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në diasporë. Përfaqësues nga xhamitë, qendrat dhe unionet e ndryshme gjithandej Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u mblodhën së bashku për të bashkëbiseduar dhe për të ndarë mes vete përvojat dhe sfidat e tyre në menaxhimin dhe udhëheqjen e qendrave dhe unioneve në diasporë. Në këtë takim, përveç mysafirëve nga diaspora, i pranishëm qe edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë dhe ministri në detyrë për Punë të Jashtme dhe Diasporë, z. Glauk Konjufca.

Në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar të pranishmëve, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, iu shprehu mirëseardhje bashkatdhetarëve tanë, duke iu dëshiruar pushime të mbara në vendlindje. Ai shprehu falënderimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm të xhamive, qendrave dhe unioneve me Drejtorinë e Diasporës, duke shprehur kështu gatishmërinë për një bashkëpunim të tillë edhe në të ardhmen.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në fjalën përshëndetëse çmoi lart kontributin e bashkatdhetarëve tanë dhënë përgjatë viteve qoftë për Kosovën në përgjithësi, por edhe për Bashkësinë Islame në veçanti. Ai tha se kur Kosova kishte nevojë për ju, ju ishit aty ku kërkonte nevoja, por edhe kur kishim nevojë për donacionet tuaja, ju prapë u gjendet aty ku kërkohej. Myftiu Tërnavë ndër të tjera përmendi edhe kontributin e bashkatdhetarëve tanë dhënë për Shoqatën Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, duke përmendur kështu edhe ndihmat e ofruar gjatë vitit të kaluar dhënë për familjet nevojtare gjithandej Kosovës. Në fund të fjalës së tij, Myftiu Tërnavë tha se historia shqiptare nuk mund të shkruhet e plotë pa mërgatën shqiptare, njashtu siç nuk mund të shkruhet e plotë pa përmendur kontributin e Bashkësisë Islame të



Kosovës, e në veçanti të Medresesë për çlirimin e vendit.

Kryediplomati i Kosovës, z. Glauk Konjufca tha se ndihet tejet i nderuar që sot gjendet në mesin e bashkatdhetarëve tanë në Medresenë “Alauddin”, duke vlerësuar kështu rolin dhe kontributin e këtij institucioni arsimor në periudha të ndryshme kohore, e me theks të veçantë gjatë viteve të luftës.

Në emër të bashkësive islame shqiptare në diasporë folën Tahir Kukaj nga ShBA-ja, Besnik Kadriolli nga Gjermania, Vahidin Behluli nga

Austria, Nuhi Shaqiri nga Belgjika dhe dr. Mexhit Osmani nga Zvicra, të cilët vlerësuan lart bashkëpunimin me institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Krejt në fund të takimit, Myftiu Tërnavë ndau nga një mirënjohje për përfaqësuesit e këtyre xhamive për kontributin e tyre në forcimin e jetës fetare, ruajtjen e identitetit kombëtar dhe bashkëpunimin me Bashkësinë Islame të Kosovës.

FSHATI SHIROKË I SUHAREKËS U BË ME XHAMI TË RE

Më 31 korrik 2026, në Shirokë të Suharekës, me një ceremoni solemne, të shoqëruar me këndimin e tekbirove dhe salavateve, u bë përrurimi i xhamisë së re.

Në ceremoninë e inaugurimit, përveç banorëve të shumtë të fshatit, të pranishëm qenë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, kryetari i Suharekës, z. Bali Muharremaj, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Suharekës, Haki ef. Hoxha, përfaqësues të institucioneve lokale, si dhe mysafirë të tjerë të shumtë.

Fjalën përshëndetëse në këtë ceremoni e mbajti kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Suharekës, Haki ef. Hoxha, i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit, e më pas falënderoi donatorët për ndërtimin e kësaj xhamie, për të cilën tha se ishte një nevojë e kamotshme e banorëve të këtij fshati. Ai falënderoi në mënyrë të veçantë donatorin, z. Sadri Buzhala, duke lutur Zotin e Madhëruar që ta shpërblejë atë me të mira në këtë botë dhe në botën tjetër.

Në fjalën e tij, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, tha se kjo xhami, të cilën po e përurojnë sot, ia shton edhe më shumë hijeshinë fshatit Shirokë. Ai vuri në pah rolin e xhamive në jetën fetare dhe shoqërore, duke theksuar se ato janë vende ku forcohet besimi, kultivohen vlerat dhe edukohet njeriu.

Myftiu Tërnavë kujtoi ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit a.s., të cilat flasin për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përkujdesjen ndaj xhamive. Ai veçoi hadithin e Pejgamberit a.s., sipas të cilit, kush ndërton një xhami për hir të Zotit të Madhëruar, Allahu do t'i ndërtojë një shtëpi në Xhenet.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë falënderoi donatorin kryesor, Sadri Buzhalën, për këtë vepër bamirëse, si



dhe të gjithë ata që, në çfarëdo forme, kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj xhamie.

Një pjesë e fjalës së tij iu kushtua edhe kontributit të Bashkësisë Islame të Kosovës në periudha të ndryshme, me ç'rast falënderoi të gjithë ata që kanë dhënë kontribut, si gjatë periudhës së luftës, ashtu edhe pas saj, veçanërisht përmes Shoqatës Humanitare Bamirëse "Bereqeti". Gjithashtu, ai vlerësoi bashkëpunimin e mirë me Komunën e Suharekës, duke falënderuar kryetarin Bali Muharremaj për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.

Në fjalën e tij, kryetari i Suharekës, z. Bali Muharremaj, përgëzoi banorët e Shirokës për ndërtimin e kësaj xhamie dhe shprehu gatishmërinë që bashkëpunimi ndërmjet Komunës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame të Suharekës të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai tha se investimet në shkollë, ambulancë, çerdhe dhe xhami

janë investime që u shërbejnë qytetarëve dhe theksoi se kjo xhami nuk do të jetë vetëm vend për faljen e namazit, por edhe qendër për edukimin e brezave të rinj.

Njëri nga donatorët kryesorë të ndërtimit të xhamisë, Sadri Buzhala, e cilësoi inaugurimin si një ditë të veçantë për banorët e Shirokës, duke shprehur besimin se ky objekt do të jetë gjithmonë në shërbim të së mirës dhe të komunitetit.

Pas ceremonisë së inaugurimit, Myftiu Naim ef. Tërnavë mbajti hytben e parë në xhaminë e sapopërruar, ndërsa namazin e xhumasë e udhëhoqi hafëz Mustafë ef. Dallku.

Xhamia e re në Shirokë pritet të shërbejë si qendër e jetës fetare, arsimore dhe edukative për banorët e këtij fshati, duke ofruar një hapësirë për adhurim, mësim dhe aktivitete në shërbim të komunitetit.

DELEGACIONI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS U NËNSHKRUA NË LIBRIN E ZISË NË AMBASADËN E KATARIT NË TIRANË

Më 15 korrik 2026, një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), i kryesuar nga sekretari Fatmir ef. Iljazi dhe shefi i kabinetit Besim ef. Mehmeti, vizitoi Ambasadën e Katarit në Tiranë. Delegacioni u nënshkrua në Librin e Zisë, të hapur për ndarjen nga jeta të ish-emirit të Katarit, sheikh Hamad bin Khalifa al Thani. Në emër të Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe BIK-ut, delegacioni shprehu ngushëllimet më të sinqerta për udhëheqjen, familjen dhe popullin e Katarit, duke u lutur për mëshirën e të ndjerit dhe durimin e familjes. Delegacioni u prit nga e ngarkuara me punë e Ambasadës, znj. Vesam al Jefairi. Ajo shprehu mirë-



njohjen e saj për këtë gjest solidariteti dhe respekti nga Bashkësia Islame e Kosovës. BIK-u vlerëson lart marrëdhëniet e shkëlqyera të miqësisë dhe bashkëpunimit me shtetin e Katarit.

Këto marrëdhënie janë forcuar ndër vite përmes projekteve të shumta humanitare, arsimore dhe fetare në Kosovë.


KOSOVA FITOI GARAT NDËRKOMBËTARE TË MEMORIZIMIT TË KURANIT NË SHKUP

Përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës shkëlqyen në edicionin e katërt të Garave Ndërkombëtare të Memorizimit të Kuranit, të mbajtura në Shkup nga 26 deri më 29 korrik 2026. Ata fituan plot dhjetë nga tridhjetë vendet e mundshme, në konkurrencë me rreth 300 garues nga 29 shtete. Suksesi më i madh u arrit në kategorinë kryesore, atë të hifzit të tërë Kuranit, ku vendin e parë e fitoi hafëzi nga Gjakova, Alban Doli. Në kategorinë e dytë (dhjetë xhuza), Semra Bashani zuri vendin e dytë të vajzat, ndërsa Marigona Mellova dhe Hana Maloku ndanë vendin e tretë. Në kategorinë e tretë (pesë xhuza), Muhamed Morina zuri vendin e tretë të djemtë, ndërsa Daria Smajli vendin e tretë të vajzat. Edhe në kategorinë e katërt (dy xhuza), përfaqësuesit e Kosovës shënuan rezultate të shkëlqyera: Amra Shala u shpall fituese e vendit të parë të vajzat, ndërsa Adonis Xhemajli zuri vendin e dytë. Në kategorinë e pestë, atë të bukurleximit, Amar Hoxha fitoi vendin e dytë, Unejs Pajaziti vendin e tretë, ndërsa te vajzat Rejana Ajvazi zuri vendin e dytë. Kosova në këto gara u përfaqësua edhe me hafëzin Mustafë ef. Dallku si anëtar i komisionit vlerësues. Ai theksoi se komisioni u përpoq të bënte një



vlerësim korrekt, proces i cili u lehtësua nga përdorimi i aplikacioneve të reja. Të gjithë anëtarët e komisionit, në krye me dr. Sami el Avaxhi, vlerësuan se

Kosova këtë vit shënoi fitoren më të madhe, duke pasur përfaqësimin më të suksesshëm ndër të gjitha shtetet pjesëmarrëse.



Me kënaqësi ia paraqesim lexuesit këtë ribotim, i cili vjen pas interesimit të madh për botimin e parë dhe pranimit të gjerë që ai pati ndër lexuesit.

Libri është fryt i bashkëpunimit ndërmjet tri bashkësive islame shqiptare: Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut.

Në të përmbledhen, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, njohuritë themelore mbi besimin dhe adhurimet, duke trajtuar namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin sipas parimeve të medhhebit hanefi. Ky ilmihal synon t'i ndihmojë myslimanët shqipfolës ta njohin, ta kuptojnë dhe ta zbatojnë fenë në jetën e përditshme.